


Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

# SHQIPERIA DHE SHQIPTARET

NE VEPRAT E PIKTOREVE TE HUAJ

Ferid Hudhri

FERID HUDHRI



**SHQIPERIA  
DHE SHQIPTARET  
NE VERRA  
TE PIKTOREVE TE HUAJ**

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

*Shtëpia Botuese*  
8 NENTORI

Grafist  
BUJAR MARIKA

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Recensues  
Prof. ALEKS BUDA  
Prof. DHIMITËR SHUTERIQI  
Doc. KRISTAQ RAMA (Skulptor i Popullit)

---

Redaktorë  
Dr. XHEVAT LLOSHI  
FERIDE PAPLEKA

#### DY FJALE...

Ndodh nganjëherë që rastësia të bëhet shkak për të ndërmarrë një studim. Po për këtë libër nuk ndodhi kështu. Vetë detyra ime si radaktor i rubrikës së arteve figurative në gazetën «Drita» u bë, si të thuash shkak që t'i futesha hulumtimit dhe studimit të një fushe të tillë sic është kjo, pavarësisht nga vështirësitë objektive për të komunikuar me muze, galeri dhe koleksione të huaja. Nga ana tjetër, si e para vepër e këtij lloji, me synimin për të parë në mënyrë tërësore dhe, mundësisht, për ta trajtuar sistematikisht, paraqiste mjaft vështirësi.

Por në shkrimet e para me këtë temë ndjeva mirëpritjen e lexuesve, interesimin e tyre për hulumtime të mëtejshme, që më shërbyen si nxitje e madhe, duke më forcuar besimin për të punuar me ngulm.

Natyrisht, për karakterin e veprës, për mua ishte e domosdoshme një ndihmë konkrete. Dhe kjo m'u dha sidomos nga Skulptori i Popullit Odhise Paskali, Prof. Aleks Buda, Prof. Dhimitër S. Shuteriqi, Prof. Alfred Uçi, shkrimtari Anastas Kondo, Skulptori i Popullit Kristaq Rama me sugjerimet shumë të vyera, me të dhëna nga studimet e tyre si dhe me recensat e kujdesshme që më bënë.

Një vlerësim i lartë m'u bë nga shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare që me plot dëshirë shkroi parathënien duke

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

shprehur angazhumin e tij në trajtimin e kësaj teme të rëndësishme

U shpreh mirënjohjen, gjithashtu, studiusve W. B. Bland, J. Sunderland, M. Moir, K. Liley, V. Holmes, P. Doldam, F. Dearsley (Angli) A.M. Chabour, T. Burollet, R. Bacou, R. Le Bihan, A. Baisile, C. Gut, M. Serullah, I. Letourneur, A. Roquebert, B. Boy, D. Ojalvo, L. B. Maillet, M. Terris (Francë) dr. A. Delivorrias, dr. F. M. Tsigakou (Greqi); prof. E. Gaudioso, prof. E. Manzato (Itali); A. Kamber (Zvicër), për të dhënat rreth disa veprave me temë shqiptare, si dhe Witt Library (Londër), Musee du Louvre (Paris), Royal Academy of Arts (London), Service de documentation photographique de la reunion des muses nationaux (Paris), për fortografitë që më dërguan.

Si studjues i ri, nuk më mbetet vecse t'i falenderoj thellësisht për ndihmën e tyre, pa të cilën kjo vepër mund të kishte mangësi të dukshme. Falenderoj gjithashtu shokët Irakli Kocollari dhe Kristo Jovani që realizuan botimin e këtij libri.

Tiranë, shtator 1987

Ferid Hudhri

## *Parathënie nga Ismail Kadare*

Në sallonin e pritjes të njerës prej kështjellave mesjetare të Luarës në Francë, të Borgarit në Blezua, midis portreteve të njerëzve e të kapitenëve të shquar të kohës është edhe një portret i Skënderbeut. Merret me mend se një portret i vendosur në një dhomë pritjeje, në një mënyrë ose në një tjetër, tërheq vëmendjen e mysafirëve dhe zgjon bisedën për të.

Portreti dhe biseda për Gjergj Kastriotin në një dhomë kështjelle mesjetare evropiane nuk ishte asgjë e rrallë e as rastësi në shekullin e pesëmbëdhjetë e në shekujt a tjerë më pas. Shqiptarët po derdhnin gjak pikërisht në portat e Evropës. Lajmet për të dhe për dyndjen otomane, që ata e kishin frenuar bashkë me popujt e tjerë të Ballkanit, vinin të turbullta e plot ankth nga kryeqyteti në kryeqytet, nga kështjella në kështjellë. Flitej me pasion për ndihmën që duhej të jepej, për rrezikun që kërcënonte Evropën, për nevojën e organizimit të një kryqëzate të re panevropiane, në krye të së cilës mund të vihej Gjergj Kastrioti.

Kaluan kështu mjaft vjet. Bashkë me kalimin e rrezikut, kancelaritë e Evropës e harruan shumë shpejt popullin e vogël, që u gjet në qendër të ciklonit. Interesi u zbeh nga shekulli në shekull, pasionin e zëvendësoi indiferenca dhe kjo vazhdoi gjer në formulën cinike të kryeministrit anglez Chamberlen, në mëngjesin e 7 prillit 1939, në çastet kur Shqipëria u pushtua prej fashizmit: «Anglia s'ka ndonjë interes të veçantë në Shqipëri».

Por ndërsa u harrua prej shteteve e kancelerive,

Shqipëria nuk u harrua prej letërsisë dhe artit evropian. Bajroni, Vivaldi, Delakrua e dhjetëra e dhjetëra shkrimtarë, kompozitorë e piktorë të njohur vazhduan të kërkojnë e të gjejnë motive të papërsëritshme në dramën, tingujt dhe ngjyrat e këtij vendi.

Anglia e Çamberlenit mund të mos kishte interes për Shqipërinë, por Anglia e Bajronit kishte tjetër mendim. Dhe për cilindo ishte fare e qartë se ky i dyti ishte mendimi i vërtetë i një vendi e një populli.

Vice versa, populli shqiptar në këngë e balada prekëse ka folur shpesh për popujt e tjerë të kontinentit. Në këngët e tij nuk mungojnë gëzimet e hidhërimet e tyre, nuk mungojnë as Parisi e sa Vjena, as Londra, Athina e Venediku.

Libri me vlerë i Ferid Hudhrit dëshmon edhe një herë, në mënyrë bindëse, atë komunikim fisnik midis popujve të realizur nëpërmjet pikturës. Pas një punë të gjatë hulumtuese ai na dëshmon se me dhjetëra kanë qënë piktorët, që duke udhëtuar nëpër Shqipëri, kanë marrë me vete, për t'i ringjallur më pas në pëlhurë, ngjyrat dhe fytyrën komplekse të saj e të shqiptarëve. Të tjerë që, për arsye të ndryshme, nuk erdhën dot fizikisht, erdhën me mendjen dhe përfytyrimin e tyre, huajtën kostume shqiptare nga kolegët, shpejtuan në studiot e tyre dhe atje, me ndihmën e atyre ngjyrave të paharrueshme, të asaj cka kishin degjuar dhe të intuitës që kanë artistët e vërtetë, krijuan tablo të një vlere të pakontestueshme.

Nga Pallati i Dozhëve në Venedik në muzetë e Londrës, Parisit, Vjenës, Moskës, Budapestit, Hamburgut e gjer në Bruklin të Nju – Jorkut, në dhjetëra muze të tjera, në kështjella, galeri e koleksione private gjënden vepra e kryevepra piktorësh të vendeve më të

ndryshme me temën shqiptare. Paolo Veroneze ka lënë në afresk kështjellarët e së fundmes fortesë shqiptare që ra në sulmin osman, asaj të Shkodrës. Po nga ajo periudhë mendohet se Albreht Dyrer ka bërë një vizatim për Skënderbeun; "Shqiptarja" dhe "Haideja" të Kamil Korosë botohen në albumet që pëmbledhin kryeveprat e pikturës botërore. "Valltarët shqiptarë" e Aleksandër Dëkasë konsiderohet si tabloja më e bukur e muzeut të Brestit. Midis shumë tablove me temë shqiptare të Eduard Lirit, "Mali i Tomorit" është quajtur ndër dhjetë më të bukurat e të gjithë ekspozitës retrospektive prej 6000 krijimesh, hapur në Londër më 1985. E kështu me radhë, tablotë e vizatimet e Ari Sheferit, Leon Zheromit, Nikolla Pusenit, Karlo Krivelit e të tjerë, janë një dëshmi artistike komplekse e plot vlerë, një akt dashurie ndaj shqiptarëve e Shqipërisë.

Kultura shqiptare ka qënë përherë mirënjohëse ndaj ç do mesazhi miqësor që vinte nga popujt e tjerë. Mirëkuptimit ajo i është përgjigjur me mirëkuptim, miqësisë – me miqësi dhe kjo është në traditën më të mirë të mendësisë kombëtare shqiptare. Kultura e Shqipërisë së re socialiste ka të njëjtin qëndrim, të njëjtën ndjeshmëri ndaj ç do akti miqësor të artit e të kulturës përparimtare botërore, i shprehur ky në letra, muzikë apo pikturë.

Ky libër, që lexuesi ynë merrr në duar, e ridëshmon këtë.

ISMAIL KADARE

*Ismail Kadare*



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



## Sikur shohim Shqipërinë...

Sa herë ndodhesh para veprave të huaja me temë shqiptare, ndien thuajse të njëjtin gëzim që ndjeu edhe Naim Frashëri përpara armëve të Skënderbeut e që e shprehu me këto vargje: «Lum ti, moj Shqipëri, thashë/Armët e tij kur i pashë / Ndë Belvedere në Vjenë / Sikur pashë Skënderbenë». Këto vargje, vec evokimit të epokës heroike përballë pushtimit osman, shprehin edhe krenarinë e poetit tonë në muzeun e një vendi të huaj. Por ndërsa në Muzeun Historik të Vienës Naimi pa vetëm armët e Heroit, po të vizitosh Muzeun e Luvrit në Paris e muze të tjera të Francës, Muzeun Britanik e muze të tjera të Anglisë, Muzeun Benaki e muze të tjera të Greqisë, Galerinë e Artit Modern të Romës dhe muze të tjera të Italisë, muzeun e Bruklinit dhe muze të tjera të Amerikës, Galerinë Tretjakov dhe shumë e shumë muze e galeri të vendeve të tjera, si ato të Austrisë, Gjermanisë, Spanjës, Turqisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Cekoslovakisë, Polonisë, Hungarisë etj., do të shikosh qindra tablo, portrete, peizazhe, gravura, litografi dha skulptura me subjekt nga vendi ynë. Dhe, siç është e natyrshme, krenaria për Atdheun para një numri kaq të madh veprash rritet. Larg Shqipërisë, të paraqitura në sallat e muzeve, ato të zgjojnë përfytyrime për vendlindjen. Dhe po të bënim analogji me vargun e Naimit «... Sikur pashë Skënderbenë...» përpara çdo tabloje me motiv shqiptar të ekspozuar në një muze të huaj, do të thoshim: «... Sikur pamë Shqipërinë...».




Shumë nga ato vepra, piktura e skulptura do të dëshironim t'i vendosnim në muzetë tona, por edhe ashtu të shpërndara në galeri e në muze të njohura të botës, ato flasin për Shqipërinë, janë dëshmi artistike të respektit e të dashurisë së artistëve të huaj për vendin tonë dhe historinë e popullit të tij. Rëndësi të veçantë ka që të mësojmë sa vepra me motive nga vendi ynë janë krijuar, ku ndodhen ato, c'vend zënë në kulturën artistike botërore dhe në historinë tonë.

I nxitur prej vitesh nga dëshira për të bërë një studim të plotë për trajtimin e temës shqiptare në artin botëror, autori i këtyre radhëve e ndien se mbetet ende për t'u bërë shumë punë për ta dhënë tablonë të plotë. Megjithatë, me hulumtimet e studimet e deritanishme është grumbulluar material i mjaftushëm për një botim të parë, sic është ky që po i japim lexuesit.

Dëshira për t'i përmbledhur të gjitha të dhënat e reja që në botimin e parë, s'të lë të qetë edhe në çastin kur libri është përfunduar. Kjo të detyron të vendosësh disa kufij kohorë. Kështu që në këtë botim jemi kufizuar kryesisht me krijimtarinë e shekullit XIX dhe të fillimittë shekullit XX, kur lëvizjet për liri e pavarësi të shqiptarëve tërhoqën me shumë vëmendjen e Evropës dhe u përjetësuan në dhjetëra e dhjetëra vepra arti. Natyrisht që edhe për këta kufij kohorë s'ka si të pretendohet se janë bërë hulumtime shteruese. Mbeten për t'u hulumtuar sidomos krijimet e realizuara para shekullit XIX, si dhe ato pas vitit 1944, që nuk përfshihen në këtë botim e që, ndofta, janë edhe më të shumta.

Në vitet e Pasqilirit tematika pasurohet me motive të reja, me tema nga rimëkëmbja e vendit dhe ndërtimi i jetës së re. Madje me vepra me tematikë të tillë janë hapur edhe ekspozita nga autorë të huaj brenda dhe jashtë Shqipërisë, si në Itali, Greqi, Austri, Belgjikë, Suedi, Gjermani, Japoni etj. Kësisoj popujve të vendeve të ndryshme u është bërë e njohur, edhe me gjuhën e artit grafik, jeta e re që po ndërtohet në Shqipëri. Por është me vend të theksohet se në vitet e Pasqilirit të huajt e kanë parë Shqipërinë kryesisht nëpërmjet veprave të artistëve shqiptarë në ekspozita të veçanta, të organizuara nga Galeria jonë e arteve, dukuri e re kjo, që para Qilirit nuk ka qenë e





*Najt: "Male të Shqipërisë".  
Muzeu i Luvrit, Paris,  
ku ndodhen disa vepra me  
temë shqiptare.*

pranishme duke përjashtuar ndonjë autor që ka paraqitur ndonjë vepër në ekspozita nderkombëtare të pikturës. Ekspozita të tilla me vepra të autorëve shqiptarë janë hapur në Francë, Gjermani, Itali, Greqi, Turqi, Jugosllavi, Angli, Austri, Egjipt, Algjeri, Rumani, Bullgari, Poloni, Bashkimin Sovjetik, Hungari, Vietnam, Kinë, Australi etj. Në këtë mënyrë koleksionet e huaja janë pasuruar më tej edhe me krijime të piktorëve tanë. Këtu duhet theksuar se në koleksione të huaja kanë mbetur edhe shumë vepra autorësh shqiptarë të periudhës së Rilindjes dhe të Pavarësisë, të cilët, për arsye të vështirësive ekonomike e të prapambetjes kulturore të vendit në atë periudhë, jetuan dhe punuan në vende të tjera. Sidoqoftë, në këtë botim do të njihemi vetëm me punime të autorëve të huaj për Shqipërinë, në kufijtë kohorë që përmendëm. Veprat e realizuara pas 1944 ës deri në ditët tona do të jenë objekt i një botimi tjetër.

## "Bashkautorë"

Leon Zherom: "Shqiptarë duke luajtur shah".



Botime me vepra të piktorëve të huaj ka shumë në botë. Kujtime me njerëz e peizazhe në krijime të arteve figurative ruajnë shumë piktorë. Për vepra të tilla janë organizuar edhe ekspozita retrospektive me punime të një a të disa autorëve. Madje ka edhe raste që janë përgatitur ekspozita apo albume me krijime piktorësh nga vende të ndryshme, kushtuar një monumenti kulture te rëndësishëm.

Është e qartë se për botime dhe ekspozita të këtij lloji vlera nuk përcaktohet nga numri, por nga niveli i veprave të autorëve që i kanë realizuar ato; pesha e personalitetit të tyre në këtë rast është treguesi kryesor i vlerës së objektit, pasi dihet që në çdo kohë piktorët e shquar kanë qenë të ngarkuar me porosi të shumta, «kapërcimi» i të cilave dëshmon për vlerat dhe përmasat e veprës së re.

Shqipërisë dhe shqiptarëve u janë kushtuar qindra e qindra tablo, portrete, peizazhe, gravura, skulptura, relieve e vepra të gjinive të tjera, aq sa përcaktimi i numrit të tyre është i vështirë; por, nga ana tjetër, kjo begati krijimesh bën të domosdoshme veçimin e autorëve më në zë. Emrat e shquar, të cilët radhiten midis mjeshtëreve të mëdhenj të botës, i japin përmasa të reja këtij botimi. Kjo për ne shqiptarët është nderim i dyfishtë, sepse çmojmë edhe emrin e mjeshtrit, edhe krijimet me temë shqiptare. Në këtë vështrim i ndiejmë si bashkautorë dhe këtë si një antologji të krijimeve me temë shqiptare.



"Bajroni me veshje shqiptare".  
(Tablo e piktorit Th. Filips).

Por cilët janë piktorët më të shquar që kanë trajtuar temën shqiptare?


Në pjesën e dytë të këtij studimi kemi shkruar veç e veç për 120 autorë, por në fillim të përmendim disa, që i kanë kapërcyer me kohë kufijtë e vendit të tyre.

Piktori francez Ezhën Dëlakrua (Eugène Delacroix) ka realizuar mbi dhjetë tablo, akuarele e vizatime me temë shqiptare. Romantikë të tjerë, si Ari Shefer (Ary Schefer). Leon Zherom (Leon Gérôme) dhe Aleksandër Dëka (Alexandre Decamps) kanë përjetësuar pamje të jetës shqiptare në shekullin e 19<sup>-të</sup>. Një nga portretet më të bukura të piktorit Kamil Koro (Camille Corot) titullohet «Shqiptarja». Nga Xhentile Belini (Gentile Belini), Albreht Dyrer (Albrecht Dürer), Karlo Kriveli (Carlo Crivelli) dhe Paolo Veroneze (Paolo Veronese) kemi tablo e vizatime me motive nga qëndresa e epokës së Skënderbeut e më pas kemi edhe nga dy prej nxënësve të Rembrandit, J. Vliet dhe F. Bol, për të cilët është shkruar se i kanë realizuar veprat me porosi të vetë mjeshtrit të madh. Temën shqiptare e kanë trajtuar edhe Nikolla Pusen (Nicolas Poussin) e Riçard Bonigton (Richard Bonington), si dhe mjeshtrë të tjerë.

Me veprat e artit me temë shqiptare, veç piktorëve, lidhen edhe figura të shquara të letërsisë të artit botëror. Në krye qëndron poeti Xhorxh Bajron (George Byron) i cili është «pagëzuar» edhe si zbuluesi i «temës shqiptare». Shumë mjeshtrë të pikturës, për ta vlerësuar nxitjen e tij në trajtimin e temës sonë, e kanë përjetësuar në disa vepra arti të veshur me kostume kombëtare shqiptare.

Në një pikturë me subjekt nga Shqipëria është paraqitur edhe Florens Naitingejl në tablonë *Florens Naitingejl në Shkodër*, vepra më e mirë e piktorit anglez Xheri Baret (Jerry Barret), realizuar në vitin 1856. Veçtablosë, njihet edhe një ilustrim po me këtë titull, realizuar nga një autor tjetër i huaj që është botuar në një album kushtuar figurës së gruas në botë.

I nxitur nga dy peizazhe me temë nga vendi ynë, *Mure të pamatura akrokeraune* dhe *Mali i Tomorit* të Eduard Lirit, poeti i njohur anglez Alfred Tenison<sup>4</sup> ka shkruar edhe tetë vargje




Gjergj Kokalli.

për madhështinë e natyrës shqiptare<sup>5</sup>. Tablotë e piktorit Leon Zherom i kanë shtyrë shumë autorë drejt figurës së shqiptarit. Poeti dhe kritiku i njohur francez Teofil Gotié<sup>6</sup>, duke vlerësuar mjeshtërinë e piktorit që ndihmon të dallojmë vetitë, karakteristikat e një populli, thekson se "...shqiptari njihet që në vështrimin e parë"<sup>7</sup>. Ndërsa një nga përfaqësuesit kryesorë të grupit parnasion të letërisisë franceze, poeti Zhoze Maria dë Eredia<sup>8</sup>, poezi të të cilit janë përkthyer edhe në vendin tonë, e përshkruan fort krenar qëndrimin e shqiptarit përballë armikut në një nga vjershat e tij të frymëzuara nga një tablo e Zheromit.

Në trajtimin e temës shqiptare Eduard Liri qëndron në krye. Ai ka realizuar qindra vizatime, tablo me ngjyra vaji, akuarele, litografi, si dhe ka botuar librin "Ditar i një piktori peizazhist në Shqipëri". Me vendin tonë Lirin e lidh ngushtë edhe një fakt tjetër: bashkudhëtari i tij më i afërt që e shoqëroi në Lindje, Indi, Siri e deri në Ceilon, ishte shqiptari Gjergj Kokalli. Në dy botime të reja angleze thuhet se më 1856 ata u takuan në Korfuz, dhe qëndruan bashkë 26 vjet, deri më 1883, kur Gjergji vdiq<sup>9</sup>, ndërsa vetë Liri e përmend që në vitin 1848, gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri<sup>10</sup>. Ribotuesit e librit të Lirit (më 1852) e kanë quajtur Gjergjin italian, duke u nisur nga fakti se fliste italisht, ndërsa në dy botimet që përmendëm, duke u mbështetur në kujtimet dhe letrat e shumta, e përcaktojnë saktë origjinën e tij shqiptare dhe shënojnë, gjithashtu, se ai fliste shqip, italisht e greqisht. Por autorët e mësipërm ndoshta nuk i kanë përcaktuar saktë vitin dhe vendin e takimit. Pas vdekjes së Gjergjit, në një letër drejtuar Emili Tenisonit, gruas së poetit të njohur, Liri ka shkruar: "Do të doja të mendoja se a kisha merituar një mik të tillë"<sup>11</sup>. Bashkëpunimin me Gjergjin Liri e ka përjetësuar edhe në një grafikë, ku e paraqet duke mbajtur fletët e vizatimit hipur në elefant (gjatë udhëtimit në Indi): në mes një indian u bën hije me ombrellë dhe përpara shihet vetë Liri duke vizatuar. Kur u kthye nga Cejloni, Gjergjit i kishin vdekur nëna, gruaja dhe vëllezërit, kështu që edhe vitet e fundit të jetës i kaloi me Lirin, duke kujtuar udhëtimet e tyre në Lindje<sup>12</sup>. Varri i tij është në San – Remo të Italisë, pranë atij të E. Lirit, madje me një ndërtim krejt të njëjlojtë dhe me

Eduard Liri dhe Gjergj  
Kokalli në Indi. (Vizatim  
nga E. Lir.).



mbishkrim që flet për bashkëpunimin e tyre. Gjergji i ka pozuar Lirit (veshur me kostumet kombëtare që morën nga Shqipëria) për tablotë me ngjyra vaji, si *Mali i Tomorit, Shqipëri* etj<sup>13</sup>. Nga ky bashkëpunim i ngushtë me Lirin, edhe Gjergj i ynë duket një emër i denjë për faqet e këtij libri.

"Bashkautorë" të tjerë të rëndësishëm, ndoshta jo aq të njohur sa të parët, mund të quajmë edhe piktorët e litografët e hershëm Xh. Kartrait, O.M. Stakelberg, C. Kokrell, H. Kuk; grafistët J. Aman, Xh. Breu; piktorët K. Udvil, H. Urban, D. Mago, T. Alinji, L. Dypre, K. Hag, Zh. Hile, T. Filipi, E. Durham etj., etj. Por më e rëndësishme është të shohim ç' përfaqësojnë veprat e artit me temë shqiptare.



- 1) Florens Naintingajl (Florence Nightingale, 1820 – 1910). Infermiere e njohur angleze. Më 1853 themeloi në Londër një spital për gratë invalide. Ka organizuar edhe spitale në vende të tjera, për t'u ardhur në ndihmë të plagosurve. Gjatë një ekspedite të tillë ka kaluar edhe në vendin tonë, gjë që është përjetësuar edhe në tablonë e piktorit Xh. Baret.
- 2) Graham Reynolds «Victorian Painting», London 1966.
- 3) «La victoire de la femme», Paris 1964, f. 157.
- 4) Alfred Tenison (Alfred Tennyson, 1809 – 1892). Poet dhe dramaturg anglez. Me E. Lirin u miqësuan pas botimit të librit "Ditari i një piktori peizazhist në Shqipëri" (Londër, 1851).
- 5) "Eduard Lear, 1812 – 1888" . London, 1985; John Lehman, "Eduard Lear and his world", London, 1977.
- 6) Teofil Gotié (Theophile Gautier, 1811 – 1872). Poet, romancier, kritik arti francez. T. Gotié ka shkruar shumë herë për pikturën, sidomos për Sallonet e Parisit, ku u ekspozuan edhe disa vepra me temë shqiptare.
- 7) "Gerome", New – York, 1881, f.6.
- 8) Zhoze Maria de Erediá (Jose Maria de Heredia, 1842 – 1905). Poet francez. Ka qenë mik me piktorin Leon Zherom, autor i disa tablove me temë shqiptare.
- 9) Shih librat e cituar në shënimin nr 7.
- 10) "Journals of a landscape painter in Albania", London, 1851.
- 11) Emily Tennyson, 18.7.83 MS; Tennyson Research Centre, London. Cituar nga libri "Edward Lear, 1812 – 1888", London, 1985. F. 161.
- 12) Lehman, "Edward Lear and his world", London, 1977.
- 13) "Edward Lear, 1812 – 1888", London, 1985, f. 201.


## Vepra të hershme

Jeta shqiptare është përjetësuar në shumë vepra arti, që në kohë të lashta, kur në këto troje banonin ilirët, paraardhësit tanë më të afërt, e deri në ditët tona. Por veç skulptorëve e piktorëve vendës, shumë vepra krijuan edhe artistë grekë e romakë, apo edhe artistë të tjerë nga popujt fqinjë, po aq të lashtësa edhe ilirët tanë. Deri tani nuk janë bërë kërkime të veçanta për këtë periudhë, ndaj në këto shënime nuk pretendojmë të japim të dhëna të plota, por do të përmendim vetëm disa vepra të veçanta, për të krijuar idenë e vazhdimësisë së krijimtarisë përpara periudhës në të cilën janë përqendruar hulumtimet dhe studimi për këtë botim.

Nëpërmjet një skalitjeje në miniaturë, që ç'mohet ndër të rrallat në botë në gjininë e vet, është përjetësuar jehona e kryengritjes më të madhe ilire, e asaj të viteve 6 – 9 të erës sonë, nën udhëheqjen e Batos<sup>1</sup>. Siç e kanë vlerësuar historianët e lashtësisë, kjo kryengritje *"më e tmerrshme dhe më e rënda për romakët pas luftërave me Kartagjenën"*<sup>2</sup>, ka qënë më madhështorja në krejt historinë e popujve të lashtë evropianë kundër Perandorisë Romake<sup>3</sup>. Pushtuesit dërguan forca të mëdha nga frika se *"kryengritësit do të vinin në portat e Romës"*, siç deklaroi perandori Oktavian August në Senat, dhe pas luftimesh të ashpra ajo u shtyp. Ky moment është skalitur edhe në veprën e artit që pëmendëm, në gemën që ruhet në Vjenë<sup>4</sup>. Megjithatë, në një artikull të veçantë për këtë krijim me vlerë

është thënë se në të fiksohet një motiv i madh i historisë së ilirëve e që, ndonëse flet për disfatën, në të mund të lexojmë diçka nga eposi i pavdekshëm i Batos dhe i Ilirisë, i stërgjyshërve tanë<sup>5</sup>. Në të janë paraqitur katër figura ilirësh. Njëri prej tyre, me duar të lidhura (ndoshta është figura e Batos udhëheqës), me pamje shprehëse, me flokët dhe mjekrën të shpupuritur, të ngjall idenë e simbolit të qëndresës.

Piktori i shquar francez Nikolla Pusein (1594 – 1665) ka realizuar tablonë kushtuar luftimeve të Pirros së Epirit me titull *Pirroja i shpëtuar* (Pyrrhus sauve). Vepra të shumta për të ishin realizuar që kur ai ishte gjallë. Portreti i tij është gdhendur edhe në monedha të kohës. Një bashkëkohës i Puseinit, piktori holandez Ferdinand Bol (1616 – 1660), ka realizuar një portret të Pirros me ngjyra vaji, një riprodhim i të cilit ndodhet në Bibliotekën Kombëtare të Parisit<sup>7</sup>. F. Boli, një nga nxënësit më të talentuar të Rembrandit, ashtu si edhe N. Puseini, e ka pikturuar Pirron në shekullin XVII, pikërisht në atë kohë kur kryengritjet shqiptare kundër pushtuesve osmanë hynë në një fazë të re. Përkujtimi nga të huajt i Pirros, i Skënderbeut dhe i figurave të tjera shqiptare në ato vite sikur u thoshte shqiptarëve të qëndronin me po aq burrëri edhe ndaj pushtuesve të kohës. Të njëjtën ide shprehnin shkrimtarët e humanistët shqiptarë M. Barleti me "Historinë e Skënderbeut", P. Budi, P. Bogdani, F. Bardhi.



*Kryengritësit ilirë.  
(Fragment nga gema që  
ndodhet në Vjenë).*

Qëndresa heroike në Kalanë e Shkodrës pas vdekjes së Skënderbeut, që bëri jehonë edhe jashtë kufijve, thuhet se u festua edhe në qytetin e Venedikut, ku kishin mërguar shumë shqiptarë. Thuhet edhe se, i nxitur nga kjo jehonë, si dhe nga manifestimi që u bë në Venedik, një nga mjeshtrit e Rilindjes italiane, Paolo Veroneze, pikturoi tablonë *Rrethimi i Shkodrës*<sup>8</sup>. Mbi pikturë autori ka bërë këtë shënim: *Scodra, Bellico omni apparata diu vehementerque a Turco oppugnata, accerima propugnatio ne retiehtur (Shkodra, e sulmuar me tërë mjetet e luftës prej turqve, për një kohë të gjatë dhe me fuqi u bëri ballë duke qendruar rreptë)*. Si një mbishkrim për tablonë Veronezes shërbejnë edhe fjalët e historianit Hamer Purgshtal, i cili, duke shkruar për inkursionet osmane, që po atë vit kur



Monedhë me fytyrën e Pirros.

Pallati i dozheve në Venedik, ku janë veprat me temë shqiptare.



sulmuan Shkodrën (1474) arritën deri në Austri, nënvizonte: "Qëndresë trimash, siç nuk gjetën ushtritë grabitqare osmane në Kroaci, Karnie, Karinti, Stiri dhe Slavoni, ato e gjetën në Shqipëri, përpara mureve të Shkodrës"<sup>9</sup>.

Nëpërmjet linjave diagonale të figurave në tablonë e Veronezes vështrimi shkon drejt pëndrës, në pjesën e sipërme të tablosë, ku është pikturuar Kështjella e Shkodrës me shqiptarët që i bëjnë ballë sulmit të osmanëve. Ndonëse figurat e shqiptarëve janë vendosur në largësi, vendosja e kështjellës në pikën më të lartë të horizontit, ku vështrimi shkon menjëherë jo vetëm nëpërmjet rakurseve të figurave, por edhe perspektivës së Veronezes, që edhe këtë tablo, si shumë të tjera, e ndërton "nga poshtë lart", e bën kalanë të duket madhështore, të pamposhtur. Kjo tablo ndodhet në Pallatin e Dozhëve në Venedik qysh në shekullin XVII, kur u pikturua.

Portreti i një luftëtari të shquar shqiptar që iku pas vdekjes së Skënderbeut në Fermo (Itali) dhe u kthye përsëri në At-dhe, ku ra në luftë me pushtuesit osmanë, është vepër e piktorit të njohur italian të shekullit XV Karlo Kriveli (1430 – 1493). Luftëtari Giorgio di Prenta, i mbiquajtur Gjergj Shqiptari (Giorgio Albanese), në shtëpinë e tij në Fermo mbante emblemën me shqiponjën shqiptare. Mjeshtri venecian K. Kriveli, piktori më i shquar që punonte në atë kohë në Italinë e Jugut, në tablonë *Shëngjergji që vret kucedrën* (1470) e ka pikturuar Gjergj Shqiptarin sipas vizatimeve që i kishte bërë nga natyra<sup>10</sup>. Heroi është shaluar mbi kalë të bardhë me frena të kuq, i veshur me rroba të kuqe nën armaturë. Në sfond shihen kështjella dhe rruga me pisha që të çonte nga Portoja në Fermo. Vepra gjendet në muzeun "Isabel Kartner" të Bostonit.

Peizazhe të disa qendrave të njohura shqiptare, si Elbasani, Voskopoja, Berati etj., janë fiksuar edhe në pikturën bizantine nga ikonografi Zhefar. Ato janë riprodhuar në disa botime dhe kanë vlerë historike, pasi paraqesin pamje të hershme, që tani kanë ndryshuar. Në ikonografinë bizantine është përjetësuar edhe kompozitori i njohur shqiptar Jan Kukuzeli.

Në të njëjtin kufi kohor me veprat e mësipërme, autorët e huaj kanë realizuar edhe qindra gravura, tablo, skulptura, medaljone dhe punime të tjera artistike kushtuar Skënderbeut.

Muzeu Britanik, Londër,  
ku ndodhen disa vepra me  
temë shqiptare.

Gjergj Shqiptari në  
tablonë e K. Krivelit.




- 1) Kjo skalitje është bërë në një gemë në përmasat 18,7 × 22,5 cm. Ndodhet në Muzeun Kombëtar të Historisë së Artit në Vjenë.
- 2) Svetoni, libri III. Tiberius, 1617.
- 3) "Les Iliriens", Tiranë, 1985.
- 4) R. Bandinell, "L' art romain des origines à la fin du deuxième siècle", Paris, 1969, f. 95, 96.
- 5) "Drita". M. Zeqo, "Batoja dhe eposi i kryengritjeve ilire", 25 maj, Tiranë, 1986, f. 12.
- 6) Sipas hulumtimeve të Dh. Pilikës, në atë tablo paraqitet një aspekt në afërsi të lumit Vjosë (Aoos).
- 7) "Rilindja", 3 mars, Prishtinë, 1971.
- 8) "Skanderbegu mbas gojëdhanash" Shkodër, 1926, f. 102.
- 9) Cituar sipas prof. Aleks Budës, "Shkrime historike", vol. 1, Tiranë, 1987, f. 346.
- 10) "Nuova Albania". G. Lussu, "Un patriota albanese in Fermo", nr 6, Tiranë, 1974.

## Skënderbeu në muze dhe në kështjella evropiane

Pamje nga qëndresa heroike e Skënderbeut, veç Muzeut Kombëtar në Krujë, ku ndodhet një pinakotekë me vepra origjinale e riprodhime, si dhe muzeve të tjera në të gjithë Shqipërinë, janë fiksuar edhe në shumë muze e kështjella të Evropës. Betejat shqiptare që udhëhoqi ai, Karl Marksi i ka cilësuar jo vetëm si luftime për mbrojtjen e Shqipërisë, por edhe si *"një goditje kundër të vetmit shtet me të vërtetë ushtarak të mesjetës, i cili u kundërvijë zhvillimit historik që po lindte dhe përparimit botëror"*.

Në një kështjellë të shekujve XVI – XVII në Borgar (Beau-



Kështjella Borgar në Francë, ku ndodhet portreti i Skënderbeut.

Afresku me figurën e Skënderbeut. (Kështjella Bytca, Çekosllovakia).



regard) të Francës, që sot vizitohet dendur edhe për koleksionin e pikturave e të objekteve muzeore, gjendet një portret i Skënderbeut. Galeria ku janë vendosur edhe 362 portrete të tjera të njerëzve më të shquar të Francës dhe të të gjithë botës gjatë shekujve, është dekoruar nga Pol Ardie (Paul Ardier), por autorët e portreteve nuk dihen<sup>1</sup>.

Nga hulumtimet që janë bërë deri tani rreth portretit të Skënderbeut, mendohet, se si modele bazë mund të kenë shërbyer portreti që ruante P. Jovi, gravura e A. Kapriolës, piktura në Galerinë Ufici, tabloja e koleksionit të Ferdinandit të Tirolit<sup>2</sup>.

E veçantë për nga trajtimi artistik, teknika e pikturimit dhe përmasat është paraqitja e Skënderbeut në kështjellën Bytca, afër qytetit Zhilina të Çekosllovakisë. Figura e heroit është në përmasa më të mëdha se natyrorja dhe e gjithë tabloja, ku ravigjehen edhe figura të tjera, zë sipërfaqen e një muri të tërë, pra ka përpjesëtimet më të mëdha që njihen deri sot për veprat me temë shqiptare. Pikturimi është bërë në murin e kështjellës, me ngjyra të posaçme për teknikën "a secco". Po në atë sallë janë pikturuar edhe figura të disa udhëheqësve më të shquar ushtarakë të botës, që nga Akili e Aleksandri i Madh e deri te Huniadi e Skënderbeu. Anash figurës së heroit tonë është shkruar: *Georgius Castriotus Epirotarum, du Turcis Scanderbegus dictus* (Gjergj Kastrioti, prijësi i epirotëve, i quajtur Skënderbej prej turqve). Ende nuk janë bërë hulumtime të sakta për kohën kur është pikturuar dhe për autorin e saj, por njihet një restaurim i bërë më 1920 nga piktori çek Stanislav Barosh<sup>3</sup>.

Në kështjellën gjermane pranë qytetit Valdburg ruhet një portret origjinal me ngjyra vaji për Skënderbeun; në Gdansk të Polonisë është skalitur një relief në gur; mbi portën e shtëpisë ku bujti Skënderbeu në Romë, ndodhet një portret me kornizë në formën e një rrethi; dy muze të njohura, Ufici në Firence dhe ai i Historisë së Artit në Vjenë, kanë të ekspozuara dy portrete të hershme me ngjyra vaji. Edhe në institucione të tjera gjenden punime me vlera: një pikturë (e stilit të shkollës veneçiane) e viteve 1500 ndodhet në kolegjin italo-shqiptar të Kozencës dhe një tjetër në sallën e përfaqësisë së bashkisë në Fermo



Portret që ndodhet në kështjellën gjermane pranë qytetit Valburg.



Shtëpi ku ka banuar Skënderbeu në Romë, mbi portën e së cilës është pikturuar portreti.

(Itali), e shekullit XVIII. Portrete dhe tablo ruhen edhe në disa koleksione private. Në një familje në Paris gjendet një portret i shekullit XV ose XVI me veshje si të princave evropiane, i punuar me ngjyra vaji; në dorë mban një libër, ndërsa poshtë lexohet frengjisht: *Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbej, princ i Epirit dhe i Shqipërisë, sundoi në vitet e zotit 1437 dhe ndërroi jetë në vitin 1467. Trupi i tij pushon në qytetin e Lezhës në Shqipëri*. Siç vihet re, datat nuk janë të sakta, pasi Skënderbeu lindi më 1405, dhe u vu në krye të qëndresës antiosmane qysh nga viti 1443 e derisa vdiq, më 16 janar 1468. Vepra është punuar me mjeshtëri dhe autori mund të jetë një nga më të njohurit e kohës së tij<sup>4</sup>. Në familjen arbëreshe Skiro në Sicili ndodhet një nga tablotë më të rralla: *Dasma e Skënderbeut*. Midis qindra krijimeve në të cilat paraqitet heroit, kjo tablo na jep një pamje lirike, ndoshta e vetmja me një motiv të tillë. Ndërsa vitet e fundit në Shkodër u zbulua një portret i hershëm me ngjyra vaji, që mendohet të jetë i shekullit XV ose XVI<sup>5</sup>.

Mund të vazhdohet më gjatë për vepra që ndodhen në kështjella, muze e koleksione vetjake, por cili prej tyre është portreti autentik i heroit?

Prej kohësh shqiptarët kanë qenë të interesuar të dinë a është bërë ndonjë portret i Skënderbeut në gjallje të tij. Autori më i shquar në trajtimin e figurës së Skënderbeut, Odhise Paskali, pohonte se *në atë kohë Shqipërisë i mungonte artisti që, paralel me historinë monumentale të Barletit, të na kishte lënë në trashëgim të çmuar veprën e artit, që të na jepte idenë e Skënderbeut të vërtetë... Vend i artistit shqiptar ishte fusha e betejës. Kurrkush nuk la shpatën as për të gdhendur në shkëmb qoftë edhe vetëm një nga këto purpurate të mrekullueshme, as syrin – shqiponjë, as krahun – çelik të heroit vigan kurdoherë fitimtar<sup>6</sup>.*

Historiani francez Lavarden dëshmon për një portret të Skënderbeut që ndodhet në Paris e që, sipas tij, është marrë nga Shqipëria qysh para vitit 1576. Në të katër botimet e librit të tij thuhet se është sjellë nga Butrinti, qytet i Shqipërisë (apporté de Bouthete, ville d'Albanie)<sup>7</sup>. Në ato vite Butrinti ishte nën sundimin e venecianëve.



Muzeu Ufici i Firences,  
ku ndodhen vepra me temë  
shqiptare.



Një nga gravurat e  
Skënderbeut.

Në trajtimet rreth kësaj figure në artin botëtor është shprehur prej kohësh mendimi se kur Skënderbeu shkoi në Itali, në ndihmë të Ferdinandit të Napolit, i është bërë një vizatim nga piktori i njohur italian Xhentile Belini<sup>8</sup>. Thuhet, gjithashtu, se origjinali i vizatimit ka humbur, por një nga portretet që ndodhej në koleksionin e kështjellës Ambras në Tirol, krijuar prej arkidukës Ferdinand (1529 – 1595), ka qenë kopje e tij. Që para vitit 1898 ky portret u vendos në Muzeun e Historisë së Artit në Vjenë, ku ndodhet edhe sot<sup>9</sup>.

Një variant i mbështetur në vizatimin origjinal të Belinit supozohet të jetë edhe piktura në Galerinë Ufici të Firences, por autori i saj mbetet ende i panjohur. Një mendim tjetër më i vonshëm, sugjeron se kjo pikturë është bërë nga Kristofano del' Altissimo (Cristofano dell' Altissimo), me porosinë e dukës së madh Kozimo i Mediceve, sipas origjinalit, që dikur ka qenë pronë e historianit dhe humanistit Paolo Jovi<sup>10</sup>. Ndërsa në një letër me datë 2.8.1981 që kemi marrë nga Galeria Ufici, autori quhet ende i panjohur, por vlerësohet si një mjeshtër me forcë të madhe interpretuese. Pohohet, gjithashtu, se vepra është trajtuar me skrupulozitet deri në hollësi. Për të vënë në dukje këtë



Portreti i Skënderbeut që ruhet në një familje në Paris.

me pendë më 1500, e paraqit heroin të veshur me parzmore metalike duke mbajtur duart të bashkuare përpara me shpatën dhe skeptrin nën krah; është ravijëzuar me mjekër e flokë të gjatë dhe me një kësulë ndryshe nga ajo e shumë punimeve të tjera. Duke u vlerësuar si vizatim i Dyrerit, ky punim është riprodhuar në Vjenë nga studioja e njohur Charl Skolik (Charles Scolik)<sup>11</sup> edhe në dy pllakate të mëdha.

Një nga portretet më të hershme është punuar më 1515 në një pjatë prej biluri nga Nikolla Pelipari në Kastel – Durante, dukat i Urbinit të Italisë. Veç rëndësisë historike, vepra ka edhe vlera artistike. Dukati i Urbinit në atë kohë ishte i përmendur për cilësinë e lartë në punimin e qeramikës artistike. Portreti i Skënderbeut është paraqitur në të krejt ndryshe nga ato që përmendëm deri tani: më i ri, pa mustaqe e mjekër, me fytyrë të shëndetshme. Edhe helmata pas figurës është vizatuar me një kordele, ku është shënuar emri *Scanderbech*. Kjo vepër ka qenë në muzeun e Munihut, ndërsa më 1939 bënte pjesë në koleksionin Pringsheim të Parisit, ku u zhduk gjatë Luftës së Dytë Botërore<sup>12</sup>.

Edhe një nxënës i Rembrandit, J.G.V. Vliet, ka realizuar një portret të Skënderbeut. Pra, dy piktorë të dalë nga studioja e mjeshtrit të madh, në të njëjtën kohë, përjetësuan në vepër artistike dy figura të shquara të historisë sonë. Vepra origjinale e J. Vlietit, që ndodhet në muzeun e qytetit Bukën të RF Gjermane, u popullarizua me rastin e 300 – vjetorit të themeluesit



Piktura "Dasma e Skënderbeut", që ruhet në familjen Skiroi, Sicili.

Muzeu i Historisë së Artit  
në Vienë, ku ruhen vepra  
me temë shqiptare.



Skënderbeu i pikturuar  
në pjatë biluri  
nga N. Palipano.

mënyrë punimi përmendet paraqitja e shenjës së një plage mbi ballin e heroit, gjë që shihet qartë edhe në një riprodhim në përmasat e origjinalit, që ndodhet në vendin tonë. Në këtë letër tabloja vlerësohet si kopje e parë e portretit të heroit, ndërsa për përshkrimin e paraqitjes së plagës pretendohet se është bërë sipas një vizatimi nga natyra. Fakti që një hollësi të tillë nuk e gjejmë në asnjë nga portretet që njohim deri tani, na bën të mendojmë se autori është mbështetur në modelin e gjallë dhe jo të fantazuar.

Dy portretet që përmendëm mbahen si kopjet më të hershme, madje të punuara sipas vizatimit origjinal. Ndonëse nuk është vërtetuar saktësia e mendimeve të shprehura për to, duhet të pranojmë se në bazë të tyre janë bërë me dhjetëra e qindra vizatime, gravura e tablo.

Ka autorë të tjerë të hershëm që nuk kanë krijuar sipas modeleve që përmendëm. Thuhet se një ndër ta është edhe piktori e grafisti më i shquar gjerman A. Dyrer, i cili, në një vizatim të muzeut, Gotfrid Nusel, në ekspozitën *Rembrandti, koha e tij dhe rrethi i tij* (*Rembrandt, sein Kreis und sein Zeit*) me shënimin: *Portreti i mbretit të Shqipërisë, Skënderbeu*. Mendohet se këtë portret Vlieti e punoi nën mbikëqyrjen e mjeshtrit të



Një nga gravurat me temën e qëndresës shqiptare të J. Amanit.

Gravura të Domeniko Kustos.



madh Rembrandt<sup>13</sup>. Edhe në këtë portret hero i ynë është paraqitur ndryshe nga dy punimet më të hershme. Gjithashtu shumë vepra autorësh të tjerë që ndodhen nëpër muze e koleksione të huaja, ndryshojnë në paraqitjen e figurës së Skënderbeut.

Po për Skënderbeun ka edhe një sërë punimesh në grafikë: seria e ilustrimeve të riprodhuara në librat e shumtë, që nga botimet e para të shekullit XV e deri në ditët tona. Shquhen në këtë gjini grafisti i njohur gjerman Jost Aman, i cilësuar si "artisti më i frytshëm i të gjitha kohëve", që veç portretit ka bërë edhe dhjetëra gravura me pamje nga beteja e qëndresa në kështjella; Jorg Breu, që gdhendi dhjetëra gravura me motive nga qëndresa ndaj pushtuesve osmanë; autorët anglezë Vogan dhe L. Xhonsen; piktori Tobias Stimer, portreti i të cilit, sic ka vërejtur prof. A. Buda, ka rëndësi, sepse, "me sa dime, jep për herë të parë përkrenaren dhe shpatën e heroit"<sup>14</sup>; grafistët e njohur italianë Françesko Zuki, Domeniko Kustos, Andrea Bianki, si dhe autorët N. Auronks, Blanshet, I. B. Skotin, Vajetit, A. Ostroviki etj. Gravura që u vendos në librin e Marin Barletit u "zgjodh" pikërisht nga këto riprodhime nëpër libra, si model bazë për shumë krijime të mëvonshme dhe u popullarizua bashkë me ribotimet e historisë së tij për Skënderbeun. Për gravura të tjera jep të dhëna Petroviçi në bibliografinë e vet të vitit 1884, ribotuar më 1967 nga Franc Babingeri<sup>15</sup>. Studiuesi Johanes Irmsher ka bërë edhe hulumtime rreth disa gravurave nga autorë gjermanë<sup>16</sup>, ndërsa të dhëna më të plota do të merren nga shfletimi i të gjitha botimeve që janë bërë deri tani për Skënderbeun, punë që, krahas bibliografisë më të plotë që po përgatitet nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë, pritet të ndërmerret nga studiuesit tanë.

Në "galerinë" e gravurave, veç atyre që u përdorën si ilustrime për librat, bëjnë pjesë edhe punime të tjera, që u gdhendën si vepra më vete. Disa prej tyre u riprodhuan në librat për Skënderbeun, ndërsa pjesa tjetër, pasi u ekspozua në mjedise të ndryshme të kohës kur u krijuan, tani kanë përfunduar nëpër muze e galeri të artit. Ashtu si dhe pjesa më e madhe e gravurave, ato qëndrojnë të mbyllura në fonde, gjë që e vështirëson mundësinë e njohjes. Dy gravura që ruhen në koleksionin e kështjellës




Portreti që u vendos në  
"Historinë e Skënderbeut"  
të M. Barletit.



Një nga gravurat e  
Skënderbeut.

Veste në Kobur të Gjermanisë, një në muzeun a Hamburgut dhe një tjetër në Bioliotekën Kombëtare të Parisit, paraqesin interpretime të ndryshme të portretit të heroit e nuk ngjasojnë thujse me asnjë nga ilustrimet e riprodhuara nëpër libra.



Gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, veç gravurave, me figurën e Skënderbeut janë realizuar shumë tablo, skulptura, medalione etj. Një pjesë e tyre janë botuar në libra, ose edhe për të shoqëruar artikuj të vecantë për Skënderbeun dhe Shqipërinë, ndërsa vepra të tjera ende nuk janë popullarizuar sa duhet. Tabloja e S. Polarolit, në të cilën heroit paraqitet në këmbë me shpatën e mburojën para trupit, dhe boceti në bronz i Skënderbeut mbi kalë i Euxhenio Baronit (Eugenio Baroni) janë dy punime në të cilat përkrenarja dhe shpata janë dhënë me pamjen më të saktë, sipas origjinalit që ndodhet në muzeun e Vjenës. Në këtë periudhë thujse në të gjitha krijimet e reja ndiqet i vetmi model, me pamje në profilin e djathtë, me përkrenaren origjinale, duke shmangur interpretimet e ndryshme të shekujve të mëparshëm me lloj – lloj kapelesh e veshjesh, që nuk u afroreshin atyre origjinale.

Interpretime krejt të ndryshme, madje më me fantazi, vihen re në dhjetëra akuarele, vizatime e gravura që u krijuan për të ilustruar botimet letrare kushtuar Skënderbeut. Në libra të tillë



Tabloja e S. Polarolit.

janë riprodhuar edhe krijime grafike që pasqyrojnë anë të tjera nga jeta shoqërore në vendin tonë, për të krijuar edhe figurativisht pamjen e plotë të Shqipërisë në shekullin XV. Krijimet grafike në këto raste i janë përshtatur edhe llojit letrar që ilustronjë, si romane, drama, poema, etj. Akuarelet më të bukura janë krijuar për një poemë të gjatë botuar në Itali në vitin 1868. Krijimet letrare, vetëkuptohet, filluan pas botimit të librave historikë e vazhdojnë deri në ditët tona, kanë gjuhë letrare të kohës. Ato shoqërohen edhe me ilustrime grafike, gjithashtu të stilit bashkëkohor, siç shihet në një roman që u botua kohët e fundit në Kanada.

Krijimet që u përmendën kanë qenë spontane, me dëshirën e vetë krijuesve, me përjashtim të pak rasteve që janë bërë me porosi të veçantë për ndonjë koleksion a muze, ose ilustrim botimesh. Por në vitet e Rilindjes Kombëtare krijimi i veprave të tilla u nxit nga atdhetarët shqiptarë, të cilët, duke dashur ta përdornin figurën e heroit si simbol të bashkimit të të gjithë shqiptarëve, kërkonin më shumë vepra për të. Nga shqiptarët u porosi skulptori H. Kauts (H. Kautsch), që realizoi një medaljon në metal e që më vonë u përdor edhe si medalje për cmimin "Skënderbej"<sup>17</sup>, si dhe në gravura me temë për bashkimin e popullit në luftë për liri. Në ato vite, sidomos në kolonitë shqiptare jashtë Atdheut, në çdo kumtim, mbledhje, ose edhe shfaqje artistike, vendosej portreti i Skënderbeut. Në shtypin e Rilindjes lexohen edhe njoftime se kur shfaqeshin drama "Të burgosurit" dhe komedia "Rrogat e nëpunësve", skena zbukurohej me ngjyrat e flamurit dhe me portretin e Skënderbeut<sup>18</sup>. Gjithashtu, në çdo qendër ku mblidheshin shqiptarë kishte portret të Skënderbeut. Në vitin 1889, baronesha Xhusepina Knor (Giusepina Cnor) i dërgoi redaksisë së revistës "La Nazione Albanese" në Itali një riprodhim të portretit që ndodhej në muzeun e Vjenës. Pas botimit në kopertinë për disa numra rresht, redaksia bëri riprodhime të veçanta në disa kopje dhe, siç njoftohet në një nga numrat e saj, ato i shpërndanë kudo<sup>19</sup>.

Por gjatë viteve të Rilindjes shqiptarët nuk kënaqeshin vetëm me gravura a riprodhime pikturash për Skënderbeun, ata kërkonin edhe ngritjen e një monumenti. Për këtë mblidhnin



Skulptura e E. Baronit.

herë pas here ndihma dhe u drejtoheshin skulptorëve të huaj, meqë ende nuk njihej ndonjë skulptor shqiptar që mund të realizonte një vepër të tillë. Në vazhdim të përpjekjeve të tyre, më 1937 u organizua në Tiranë konkursi për ngritjen e monumentit të Skënderbeut, në të cilin morën pjesë edhe pak autorë shqiptarë, ndër ta edhe Odhise Paskali, që ndonëse ishte në fillimet e krijimtarisë, me bocetin që paraqiti u dallua ndër shumë autorë të huaj. Në konkurs paraqitën bocete skulptorë nga Austria, Franca, Bullgaria, Hungaria, Jugosllavia, Italia etj. Si më i arritur u vlerësua boceti i skulptorit kroat Augustinçiq, ndërsa e drejta e ekzekutimit iu dha skulptorit italian R. Romaneli, që e realizoi pak vjet më vonë në Romë. Në këtë konkurs morën pjesë me një bocet të përbashkët edhe skulptori Pejev me piktorin Popov. Njëri prej boceteve të konkursit për monumentin e Skënderbeut është ekspozuar në pinakotekën e muzeut kombëtar "Skënderbeu" në Krujë.

Pjesa më e madhe e të gjithë krijimtarisë së autorëve të huaj përbëhet nga portrete, më pak janë kompozime, në të cilat heroi është vendosur midis luftëtarëve të tjerë shqiptarë, ose në betejë, në kuvende etj. Në një ksilografi të vitit 1537 paraqitet kaluar duke mbajtur fjalim para popullit, kurse në disa gravura në botime gjermane dhe në tablo autorësh më të vonshëm paraqiten motive nga luftërat për liri. Megjithatë, vetë kërkesat e kohës, në portretizimin e Skënderbeut dhe në specifikën e artit figurativ krijuesit e huaj nuk arritën atë që kërkohet sot nga historiografia shqiptare: "...një vlerësim i drejtë i kësaj figure të shquar të historisë sonë kombëtare, një kuptim më i thellë e i gjithanshëm i asaj dukurie të jashtëzakonshme që mund të përfshihet me binomin: *Skënderbeu dhe lufta e madhe popullore kundër pushtimit osman në Shqipëri në shekullin XV, mund të arrihet vetëm duke e parë heroin tonë në lidhje ndërvarësie me masat popullore, në gjirin e të cilave ai jetoj e luftoi*"<sup>22</sup>.

Në ikonografinë skënderbejane duhen përfshirë edhe dekorat, kostumet, medaljonet dhe zbukurimoret e shumta që u krijuan për vënien në skenë të pjesëve muzikore kushtuar atij. Dhe ashtu si në letërsi, pikturë e arte të tjera, edhe me krijime muzikore për figurën e heroit tonë janë marrë personalitete të shqua-



Ilustrim i përdorur në librat letrarë për Skënderbeun.

Medaljon nga skulptori H. Kauts. Copertina e revistës "La Nazione Albanese" me portretin e Skënderbeut.




ra, si Antonio Vivaldi (1677 – 1741), F. Franker (1698 – 1787), F. Rabel (1701 – 1779), si dhe shumë autorë më pak të njohur<sup>23</sup>.

Megjithëse krijimet që përmendëm përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të veprave të autorëve të huaj, ato janë një dëshmi e madhe e nderimit që ka gëzuar në botë hero i ynë. U ndalëm pak sa për të krijuar një ide të përgjithshme edhe për ikonografi në skënderbejane, e cila meriton hulumtime, kërkime e studime të veçanta, madje edhe një album të posacëm. Që nga fundi i shekullit të kaluar, një dijetar i huaj njoftonte se për një studim të tillë kishte mbledhur materiale rreth krijimit të portreteve në gravura e piktura<sup>24</sup>. Por, me sa duket, ai punim me shumë interes nuk e pa dritën e botimit. Ndoshta ka mbetur vetëm në dorëshkrim e ruhet në ndonjë arkiv, ndoshta edhe mund të jetë







*Muzeu i Skënderbeut  
në Krujë.*

zhdukur. Materialet, gravurat, shënimet e dokumentet për një studim të tillë janë të shumta. Mjafton të pëmendim se, me rastin e 500 – vjetorit të vdekjes së Heroit, vetëm në arkivin e shoqërisë "Vatra" të shqiptarëve të Amerikës u mbledhën 150 foto nga gravurat, pikturat dhe skulpturat e realizuara nga autorë të huaj.

- 1) "Le chateau de Beauregard en Blesois". Paris, 1976, f. 6.
- 2) Sipas hulumtimeve të bëra në Francë nga R. Përnaska.
- 3) "Zëri i rinisë", Dh. Pilika, Skënderbeu në botën e jashtme: Një portret i tij i panjohur, 28 nëntor 1962; "Ylli" Duke kërkuar "Albanica" ndër arkiva dhe biblioteka të jashtme, nr 11, Tiranë, 1962.
- 4) "Ylli". Ll. Mitrush, *Një portret i panjohur i Skënderbeut*, Tiranë, 1966.
- 5) Shih: "Drita". A. Kondo, *Një portret i panjohur i Skënderbeut*, 21.11.-1982. Ky portret është ekspozuar në muzeun "G. J. Skënderbeu" në Krujë.
- 6) "Konferenca e dytë e studimeve albanologjike", I. f. 550, Tiranë, 1969, O. Paskali, *Mendime rreth figurës së Skënderbeut në artin figurativ botëror*.
- 7) I. Lavardin, "Histoire de Georges Castriot...", Paris, 1593.
- 8) "Albania", *Exist – il un portrait authentique de Skanderbeg?*, 1901, f. 58.
- 9) "La Nazione Albanese", nr. 3, Catanzaro, 1898.
- 10) "Ylli". R. Sokoli, *Portreti i Skënderbeut*, nr. 6, f. 30, Tiranë, 1978; "Scanderbeg", Paris, 1983 (Ky i fundit pa autor).
- 11) "Djalëria", nr. 18 – 19, Vjenë, 1922. Në këtë revistë është botuar edhe vizatimi i Skënderbeut me shënimin "Skënderbeu sipas origjinalit".
- 12) R. Sokoli, art. cit.
- 13) "Rilindja". I. Bytyci, *Edhe një portret i rrallë i Skënderbeut*, Prishtinë, 1982; "Drita". V. Bala, *Një portret i Skënderbeut*, 26 mars, Tiranë, 1982.
- 14) Aleks Buda, "Shkrime historike", vëll. I, f. 307, Tiranë, 1987.
- 15) Georges T. Petrovich, "Scanderbeg", *Essai de bibliographie raisonnée*, Paris, 1881, Ribotuar nga F. Babinger, München, 1967.
- 16) "Konferenca e dytë e studimeve albanologjike". Johanesh Irmsher, *Skënderbeu dhe Gjermania*, Tiranë, 1969, f. 551.
- 17) Çmimi "Skënderbej" u përdor nga shoqëritë shqiptare jashtë Atdheut pas vitit 1900 dhe u jepej shkrimtarëve e artistëve të Rilindjes që trajtonin tema atdhetare. Ai shoqërohej edhe me një pllakë druri me medaljon të Skënderbeut realizuar sipas vizatimit të piktorit Theochar Gjini. Më 1902 çmimi iu dha Jeronim de Radës dhe më 1906 piktorit Th. Gjini, për ekspozitën që hapi në Paris, ku u paraqitën disa tablo për Skënderbeun dhe motive të tjera me temë atdhetare.
- 18) "Koha", *Theatro në Jamestown*, Jamestown, 2.2.1916.
- 19) "La Nazione Albanese", nr. 3, 1898.
- 22) "Konferenca e dytë e studimeve albanologjike". Aleks Buda, *Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe epoka e tij*, Tiranë, 1969, f. 20.
- 23) Shih: R. Sokoli, "Figura e Skënderbeut në muzikë" Tiranë, 1978.
- 24) Dh. Pilika, art. cit.

## Figura të tjera të shquara

Dëshmi e nderimit të shqiptarëve nga bota janë edhe shumë krijime të tjera, që përjetesojnë disa nga figurat më të shquara të historisë sonë. Njihen, p.sh., vizatime dhe gravura për bashkëluftëtarë të Skënderbeut, si për Gjergj Golemin (Aranitin), Lekë Dukagjinin, Tanush Topinë, të realizuara sipas traditës së kohës, të kornizuar nga një linjë në formë vezake, me shënime anash për emrin e autorit, ofiqin dhe kombësinë. Me të njëjtin trajtim është fiksuar edhe Donika Kastrioti. Autorët janë anonimë, ashtu si ata të pjesës më të madhe të gravurave për heroin kombëtar. Sa për autenticitetin e tyre, ky është po aq i diskutueshëm sa edhe për veprat për Skënderbeun.



*Donika Kastrioti.  
Tanush Topia.*

Piktori gjerman Hans fon Ahen (Hans von Achen) ka realizuar një portret të bukur të shqiptarit të famshëm Gjergj Basta, i cili udhëhoqi ushtritë e bashkuara evropiane kundër pushtuesve osmanë dhe hartoi traktate për artin ushtarak, në të cilat përgjithësoi përvojën e kalorësisë së lehtë shqiptare të kohës. Fama e tij u përhap në shumë vende të botës, por gëzimin më të madh ua ngjallte bashkatdhetarëve të tij, të cilët mburreshin me figurën e tij të shquar. Në një letër të vitit 1759, himarjotët kreshnikë, fill pasi krenohen për trimëritë e stërgjyshërve të tyre, "mbretit të lavdishëm" Pirro dhe Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, përmendin me kryelartësi edhe emrin e gjeneralit Gjergj Basta. Edhe në thirrjen që i drejtojnë punëtorët shqiptarë të Amerikës Konferencës së Hagës (15 qershor – 19 tetor 1907), kumbojnë këto fjale: "Pas 27 vjetësh lufte të paprerë nën sovranin tonë të fundit Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, afro njëqind mijë bashkatdhetarë tanët u detyruan të largoheshin prej truallit atëror; disa prej këtyre shqiptarëve të mërguar dhe prej pasardhësve të tyre fituan nam. Të tillë qenë Tomeu, njëri ndër humanistët më të shquar të Rilindjes...; gjeneralisimi parandorak Gjergj Basta". Me Gj. Bastën krenohen edhe autorë arbëreshë, si V. Dorsa (1847), P. Kiara (1869) e të tjerë<sup>1</sup>. Portreti i realizuar nga Hans Aheni është trajtuar me frymën e gravurave të kohës dhe dallohet për natyrshmëri e gjallëri të figurës, duke krijuar përfytyrimin e pikturimit drejtpërdrejt nga natyra. Edhe në gravura e oliografi të tjera për Gj. Bastën shihet ngjashmëria me punimin e Ahenit, gjë që na bind se është pikturuar drejtpërdrejt nga natyra.

Një cikël i madh me portrete, gravura, litografi, akuarele e tablo i kushtohet Ali Pashë Tepelenës. Në krye të pashallëkut të madh të jugut të Shqipërisë, Aliu tërhoqi vëmendjen e të huajve, sepse, duke u përpjekur që "Shqipëria të ishte më vete e shkëputur nga turqit"<sup>2</sup>, siç ka theksuar shoku Enver Hoxha, atij iu desh të përballonte jo vetëm Portën e Lartë, por edhe synimet e Fuqive të Mëdha, të Francës, Anglisë dhe Rusisë, të cilat, gjatë lëngimeve të të sëmurit të Bosforit, u përpoqën të hidhnin kthetrat edhe mbi Shqipërinë. Qëndrimi i tij përballë lakmitarëve dhe fuqive kaq të mëdha, natyrisht, kërkonte edhe

Moisi Golemi.





Gjergj Basta vizatuar nga H. Ashen.

një diplomaci të hollë, për të cilën Aliu u shqua. Jehona e qëndresës së Aliut të Tepelenës, siç ka shkruar prof. Dh. S. Shuteriqi, qe e madhe në botën e kohës dhe veprimtaria e tij ndikoi për të shpejtuar rrokullisjen e Perandorisë Osmane. Ajo i dha dorë lëvizjes së çlirimit të popujve të ndryshën të Ballkanit, veç anërisht shpërthimit të revolucionit të popullit grek më 1821 dhe çlirimit të Greqisë<sup>3</sup>. Por mendojmë se trajtimi i gjerë në vepra arti u nxit edhe nga fakti se pashai i Janinës u tregua shumë dashamirës ndaj zhvillimit të artit, kulturës e shkencës. Në oborrin e tij diskutohej lirshëm për probleme artistike, historike, letrare e shkencore. Në vitin 1814 ai lejoi edhe shfaqje teatrore, duke e bërë pashallëkun e tij të parin vend që gëzoi të drejtën në këtë lloj arti ndër të gjitha vendet që sundoheshin nga Perandoria Osmane. Ndërsa për ndërtimet e shumta me vlera arkitektonike, ndaj të cilave tregoi pasion të veçantë, ftoi arkitektë nga Franca, Italia e Austria<sup>5</sup>, duke krijuar mundësi për formime personalitetesh në arkitekturën shqiptare, siç është rasti i Petro Korçarit, të cilin e emëroi edhe kryearkitekt të pashallëkut.

Gjatë viteve të sundimit të tij, në pashallëkun e madh të Jugut erdhën edhe shumë piktorë e arkitektë që, veç pamjeve nga natyra shqiptare dhe vizatimit të skenave nga jeta e përditshme, realizuan edhe portrete të Aliut. Në vitin 1813 anglezi Carl Kokrell (Charles Cockerell) i bëri vizatim brenda në sarajin e tij, duke e paraqitur me pamje autoritare dhe me qëndrimin imponant. Në plan të dytë ka edhe figura të tjera. Mjedisi i brendshëm i sarajit është dhënë me kujdes, për të paraqitur luksin që, siç ka vërejtur Pukëvili, *s'mund të krahasohej veç se me ndikimin që ushtronte ai në të gjithë Turqinë*. Kjo gravurë, veç botimit të parë në librin e Hjuzit, është riprodhuar edhe në shumë libra që u shkruan për Ali Pashën nga autorë të huaj.

Nga punimet më të bukura njëkohësisht më të njohura janë edhe dy krijimet e piktorit francez Lyi Dypré (Lui Dupré). Thuhet se Aliu nuk pranoi t'i pozonte (pak kontradiktore kjo me dashamirësinë e njohur të pashait ndaj arteve dhe artistëve) dhe Dypré ruajti rastin për ta vërejtur kur ai shëtiste në liqenin e Butrintit me varkë dhe realizoi tablonë *Ali Tepelena në liqenin*



Ali Tepelena.

e *Butrintit*. Në këtë tablo paraqiten edhe disa figura të tjera shqiptarësh. Nga kjo vepër artisti francez "shkëputi" portretin e Aliut dhe e bëri vepër më vete. Ky portret është përdorur edhe në botime të tjera për Ali Pashë Tepelenën, si në librin e Pukëvilit etj. Dypre e botoi edhe në albumin e tij me grafika me pamje nga Shqipëria, Greqia dhe Turqia.

Në një litografi me ngjyra Ali Pashën e ka pikturuar edhe anglezi Xhozef Kartrait (Joseph Cartwright), i cili botoi në albumin me titull "Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia" (Londër, 1822). Por kujdesi i tepruar për veshjen, zbu-kurime e ngjyra ka bërë që portreti i Aliut të mos jetë në lartësinë e dy punimeve që përmendëm.

"Cikli" i veprave të tilla është i madh edhe nga autorë vendesh të ndryshme. Gjashtë tablo me ngjyra, që paraqesin pamje nga jeta dhe veprimtaria e Aliut, janë riprodhuar në një botim të vitit 1823. Në të parin ai është paraqitur mbi kalë, pranë tij janë e shoqja në një kalë tjetër dhe rreth e qark kalorës të tjerë. Që në faqen e titullit është shënuar se litografitë janë vizatuar nga V. Devenporti, kurse gravura është realizuar nga G. Hunti. Secila tablo është shoqëruar me shënime të gjata nga botuesi<sup>6</sup>.

Kur erdhi për të pikturuar në Shqipërinë e Jugut piktori anglez P. Beresford, trupi i Ali Pashait pushonte në dy varre. Ai nuk arriti dot ta vizatonte ashtu si kolegët e tij dhe në albumin që botoi më 1853, në një litografi me ngjyra, na ka paraqitur brendinë e sarajit të Pashait. Në Këtë tablo ai jep një mjedis



Tabloja e piktorit L. Dypre.

shumë të zbukuruar, që mund ta bënte realitet vetëm një njeri me pasion për ndërtimet dhe artet e bukura. Por punimet me figurën e Aliut janë të shumta dhe një pjesë e tyre është realizuar nga autorë të njohur. Figura e tij u bë, gjithashtu, objekt për vepra letrare e gjinish të tjera artistike. Viktor Hygoi, p.sh., ka shkruar një poezi, ndërsa nga vepra kompozitorësh të njohur janë vënë në skenë opera, balete a pjesë të tjera muzikore që paraqesin interes të vecantë edhe për krijimin e mjediseve shqiptare të shekullit XIX.

Ndoshta më pak se për Ali Pashë Tepelën, janë krijuar gravura dhe punime të tjera artistike edhe për Bushatllinjtë e Shkodrës, udhëheqës të një pashallëku tjetër të madh shqiptar në Veri.

Shumë vepra janë krijuar edhe për trimin suliot Marko Boçari. Dy portrete dolën prej dorës së kreut të pikturës romantike Ezhën Delakrua, ndërsa një statujë e realizoi skulptori i njohur David d'Anzher. Po kështu, dhjetëra e dhjetëra portrete e tablo u realizuan nga autorë më pak të njohur, të cilët përjetësuan edhe figura të tjera shqiptarësh që morën pjesë në

*Bubulina.*

*Litografia e P. Beresfordit, që paraqet sallën e pritjes të Ali Tepelenës.*





Një nga vizatimet e E. Orlikut për Aleksandër Moisiun.



Dora d' Istria.

Revolucionin grek të vitit 1821, si Bubulina, Karaiskaqi etj.

Për Dora D' Istrian më i njohur është një vizatim në profil (autori ende anonim), që e paraqet tërheqëse dhe autoritare. Për të janë realizuar edhe portrete, tablo e buste në gjallje dhe pas vdekjes. Disa nga autorët janë: venecianët Felice Skiavoni e Adolfo Salmoni dhe piktori rumun Peter Matesku, vepra e të cilit ruhet në Galerinë Kombëtare të Bukureshtit<sup>7</sup>.

Për Aleksandër Moisiun ka një koleksion të veçantë. Artistë të shumtë kanë fiksuar portretin e tij si në çaste intime ashtu edhe gjatë interpretimeve të kryeveprave të dramaturgjisë botërore. Piktori Emil Orlik ka realizuar disa vizatime dhe tablo me ngjyra vaji. Piktorë, skulptorë dhe grafistë, si Henrik Lundi, Lehmen Steglitz, A. Stringern, Ferdinand Midin, Rudolf Berlin, Kaparik janë autorë veprash të tjera që ruhen në Muzeun e Teatrit të Vjenës, ku luajti aktori ynë i madh, dhe në koleksione private në Gjermani e në Austri<sup>8</sup>. R. Sokoli dëshmon se gjatë Luftës së Dytë Botërore një ushtar gjerman la në Shkodër një bust në bronz të A. Moisiut që e kishte marrë në Greqi. Vepra është e një autori austriak. Tani ajo mund të ruhet në ndonjë familje shkodrane.

Figura të tjera të shquara të historisë sonë u përjetësuan në vepra arti nga autorë të huaj me nxitje të vetë shqiptarëve. Sidomos atdhetarë të shoqërive shqiptare jashtë atdheut, për të ilustruar shkrimet përkujtimore, ose për ngjarje me rëndësi, porositnin piktorë për të bërë gravura e vizatime për heronjtë tanë. Nga porosi të tilla të "Albania" që botohej në Bruksel u stampuan gravura, në të cilat ravijëzohen çastet e fundit nga qëndresa e Oso Kukës, të "Yll' i mengjesit" është portreti i Isa Boletinit, në organe të tjera – gravura për atdhetarë të tjerë të shquar. Ismail Qemali, vec portreteve të veçanta, është përjetësuar edhe në një vizatim të bukur, në përmasa të mëdha (30 × 26), që u botua në gazetën "Albania" të Nju – Jorkut. Në të paraqitet çasti i ngritjes së Flamurit të Pavarësisë në Vlorë: Ismail Qemali në ballkon valëvit flamurin, ndërsa poshtë shihet populli i grumbulluar për të festuar ditën e shumëpritur. Autori i kësaj gravure (deri tani anonim) mund të ketë qenë mbështetur edhe në kujtimet e vetë Ismail Qemalit. Për të fiksuar mendimin





Gravura për shpalljen e Pavarësisë.

e I. Qemalit se në çastin kur ngriti flamurin iu kujtua dita kur ai u valëvit në kështjellën e Krujës, pranë flamurit piktori ka vizatuar një imazh të figurës së Skënderbeut mbi kalë. Për këtë vizatim ai është mbështetur në krijimin e një autori shqiptar, dhe pikërisht në skulpturën e Thimi Hondros, që e kishte punuar një vit më parë po në Amerikë, ku u botua edhe kjo grafikë. Njihet edhe një vepër në pikturë që pasqyron ditën e Shpalljes së Pavarësisë, riprodhuar në gazetën "Liri e Shqipërisë" (Sofie, 1913. Bullgari).

Me porosi nga atdhetarët shqiptarë, një autor i huaj realizoi edhe karikaturën e njohur "Copëtimi i Shqipërisë", që u riprodhua edhe në revistën "Opinga" (botues Nikolla Lako, në Francë). Me anë të saj demaskohen qëllimet grabitqare të shteteve shoviniste, që iu vërsulën vendit tonë pas Shpalljes së

Grafika "Të bashkohemi si në kohën e Skënderbeut."



Karikatura "Copëtimi i Shqipërisë".



Pavarësisë. Disa vepra të piktorëve të huaj u shfrytëzuan edhe nga autorët tanë të Rilindjes dhe të periudhës së Pavarësisë, si bazë për krijime të reja. Në gravurën *Të bashkohemi si në kohën e Skënderbeut* medaljoni i Skënderbeut, vepër e skulptorit H. Kouts është vendosur si një figurë simbolike që lidh dy luftëtarët dhe shpreh domosdoshmërinë e bashkimit të shqiptarëve.

Me Shpalljen e Pavarësisë nuk morën fund lakmitë ndaj Shqipërisë. Lëvizja e madhe popullore nxori figura të tjera të shquara, që sakrifikuuan edhe jetën për lirinë e përparimin e At-dheut. Edhe heronjtë e rinj, që vazhduan të ruanin të gjallë krenarinë shqiptare, u fiksuan në vepra të shumta arti.

- 1) "Ylli". Dh. Pilika, *Një shkrimtar dhe teoricien, shqiptari i shquar në artin ushtarak botëror: Gjenerali Gjergj Basta*, Tiranë, 1966, nr 7.
- 2) Enver Hoxha, "Vepra", vëll. 23, 1977, f. 349 – 350.
- 3) Dh. S. Shuteriqi, "Petro Korçari...", *Ali Pashë Tepelena. Koha e tij*, Tiranë, 1978, f. 8.
- 4) I. Ushtelenca, "Diplomacia e Ali Pashë Tepelenës", Tiranë, 1983, f. 23.
- 5) Dh. S. Shuteriqi, "Petro Korçari, kryearkitekt i Ali Pashë Tepelenës", Tiranë, 1978, f. 10.
- 6) "Historical portraiture... Ali Pasha, vezir of Epir", London, 1823.
- 7) "The National Gallery of Romanian painting", fig. 83, Bucharesti, 1984.
- 8) H. Blohm, "Moissi, der Mensch und der Kunstler" Vjenë, 1930.

## Shqiptarë në mërgim dhe ndihmesa e tyre në artin botëror

Që nga shekulli XIV, shqiptarë të mërguar u gjendën sidomos në Greqi, në Itali e, më vonë, në Rumani, Bullgari, Turqi, Egjipt, SHBA e deri në Australi etj. Piktoret e huaj që kishin përjetësuar qëndresën heroike të kohës së Skënderbeut, pasqyruan në veprat e tyre edhe këtë fakt të hidhur. *Shqiptarë e Athinës*, *Shqiptarë të Moresë* dhe *Dy arbëreshë* janë tri nga gravurat më të njohura për shqiptarë të mërguar. Në qëndrimin e figurave ndihet nostalgjia për vendlindjen e largët. Kështu, gravura e tablo të shumta tregojnë se për vite e shekuj shqiptarët nuk e harruan atdheun e të parëve: ruajtën gjuhën, zakonet dhe veshjet kombëtare. Lidhur me sa u përmend Dora d' Istria do të shkruante: "Dukej sikur arbëreshët e ngulur shumë kohë më parë në brigjet perëndimore të Adriatikut nuk i kishin ruajtur veçse shumë zbehtë në kujtesën e tyre trimëritë e heroit të Krujës. Por kjo nuk është e vërtetë... Në qoftë se sundimi i huaj nuk lejon t'i ngrihen monumente Kastriotit të madh në vendlin-

*Shqiptarë e Athinës.*  
(Gravurë e Shek. XIX.).



djen e tij..., emri i heroit do të përmendet me nderim dhe kujtimi i tij do të lartësohet sa kohë që një zemër shqiptari do të rrahë në të dy gadishujt...". Piktorët e huaj, nëpërmjet tablove dhe gravurave, kanë pohuar se emri i Shqipërisë dhe i Skënderbeut përmendet me nderim edhe nga shqiptarë që banojnë në vende të tjera. Në tablotë e Zheromit, Dëkasë, Glerit etj. janë pasqyruar shqiptarë me banim në Egjipt, në Turqi e në Greqi të veshur me kostume kombëtare, njëjloj sikur të ishin në Shqipëri. Për shqiptarët e Greqisë janë krijuar më shumë vepra arti, madje shpesh piktorët e huaj kanë ngatërruar disa motive shqiptare me ato të fqinjëve grekë, jo vetëm se në atë kohë kufijtë midis dy shteteve nuk kanë qenë të përcaktuar qartë, por edhe për disa karakteristika të përbashkëta që bartnin këta dy popuj më të lashtë të Ballkanit. Në kapituj të tjerë do të ndalemi më gjatë në këtë anë.

*Dy arbëreshe.  
Shqiptare të Moresë.  
(Gravurë e shek. XVII.)*



Për arbëreshët e Italisë ka, gjithashtu, dhjetëra vepra të veçanta. Piktori francez Zhan Huel (Jean Houel) gjatë viteve 1782 – 1787 udhëtoi edhe përmes fshatrave arbëreshe dhe me akuarelet që realizoi në to dhe në zona të tjera të Italisë e të Maltës, u bë më i njohur. Pas jehonës që iu bë nga botimi në albumin "Udhëtim piktoresk në ishujt e Sicilisë, Maltës dhe Liparit, 1782 – 1787" (Voyage pittoresque des îles de la Sicilie,



*Gravurë që pasqyron simbolikisht largimin e shqiptarëve.*

de Malte et de Lipari, 1782 – 1787), disa prej tyre u blenë nga Katerina II e Rusisë. Në punimet me pamje nga fshatrat arbëreshe Hueli ka pikturuar me imtësi kostumet tradicionale të grave. Kostume të arbëreshëve janë fiksuar edhe në krijime të piktorit B. Pineli (B. Pinelli), një prej të cilave ruhet në Galerinë Kombëtare të Artit Modern dhe Bashkëkohor në Romë, si dhe në shumë vepra të autorëve të tjerë italianë.

Nga shqiptarët e mërguar dolën edhe piktorë e skulptorë të shquar, që dhanë kontribut të ndjeshëm jo vetëm në vendet ku zhvilluan veprimtarinë e tyre, por edhe në artin botëror. Dëshmi për veprimtari më të hershme në këtë fushë, që kanë më shumë interes për shkencat albanologjike, janë zbulimet e disa gravurave në muret e kështjellës Roveria në Itali, në të cilën prej vitit 1875 ekziston Muzeu Arkeologjik i Grata – ferratës<sup>1</sup>. Në gravurën më të madhe, që mendohet se është e shekullit XV, figuron një portret ushtari me përkrenaren si ajo e Skënderbeut. Supozohet që këto gravura të jenë bërë nga ushtarë shqiptarë në shërbim të mbretit të Napolit, të cilët në çaste të lira vizatonin në mure motive nga atdheu i vet. Rëndësia e tyre, sic thamë, qëndron në përcaktimin e disa veprave të hershme të autorëve shqiptarë.

Në historinë e artit italian, madje edhe në atë të atij botëror, përfshihet edhe krijimtaria e albanezëve të Vincencës, e sidomos e Gjonit (1573 – 1639) dhe e Jerenimit (? – 1660). Për vlerat që



*Zhan Huel: "Arbëreshe të Kalabrisë".*

*Kisha Duomo e Milanos,  
ku është altari i gdhendur nga  
skulptori Aleks Taketa.*



këta aritën në arkitekturë e në skulpturë, mjafton të përmendim epitafin që u gdhend në banesën e tyre, ku i krahasojnë me dy nga skulptorët më të mëdhenj të Greqisë së lashtë. "Ille alter Phidias/hic Policletur erat" (Ai ishte një tjetër Fidias, ky ishte një tjetër Poliklet). Më 1480, Aleks Tarketa, gjithashtu me origjinë shqiptare, gdhendi në mermer altarin madhështor të katedrales Duomo të Milanos.

Shumë artistë shqiptarë u shquan edhe në Venedik, ku ka patur një komunitet më të madh, por që ishte i shpërndarë në lagje të vecanta. Madje edhe në ditët e sotme ruhen pllaka rrugësh të emërtuara "Calle degli Albanesi", sheshe të vogla: "Campiello Albania" dhe ura: "Ponte degli Albanesi". Ata kanë qenë të organizuar në një shoqëri të veçantë, të quajtur "Shkolla e shqiptarëve" (Scuola degli albanesi), e cila kishte për qëllim të ruante traditat kulturore dhe liridashëse në dobi të Atdheut. Nga ky komunitet dolën edhe dy piktorët e shquar Mark Bazaiti dhe Viktor Karpaci. Për herë të parë kombësinë shqiptare të Bazaitit e ka vënë në dukje dietari gjerman Franc Babinger në

*Pllaka e një rruge shqiptare në Venedik.*

*Shkolla e shqiptarëve në Venedik, ku është vendosur relievi për qëndresën e Shkodrës.*



vitin 1962. Me origjinë shqiptare mendohet të jetë edhe piktori Francesk Albani (1578–1660), i mbiquajtur "Anakreonti i pikturës".

Veprat e këtyre autorëve, veç Italisë, ku u krijuan, kanë përfunduar edhe në muze të tjera të botës: koleksionistë nga vende të ndryshme, krahas krijimeve autorësh të tjerë të shquar të Rilindjes, i mblodhën edhe ato. Por rrethanat e atëhershme historike bënë që vendi ynë të mbetej pa kryevepra të tilla, madje as prej autorëve që dolën nga trualli i tij, siç janë ata që përmendëm. Sa për periudhën pesëshekullore të pushtimit otoman, nuk mund të bëhej fjalë as për muze, as për koleksionistë veprash arti, por megjithatë shqiptarë që e çmonin pikturën dhe skulpturën ishin bërë të njohur në botë qysh në ato kohë, madje edhe si koleksionistë me famë botërore. Emrat e tyre shënohen edhe sot në histori dhe enciklopedi të ndryshme në zërat që bëjnë fjalë për artin botëror. Më e shquara është familja Albani, që banonte në Romë. Ajo kishte shkuar në Itali nga Dukagjini në shekullin XIV dhe mbante mbiemrin Lazaj. Pastaj e ndërroi mbiemrin në Albani. Në fillim ajo u vendos në Urbino. Emër bëri sidomos Aleksandri me koleksionin e veprave të artit që grumbulloi e që ka lidhje me një nga figurat më në zë të kulturës botërore, me Johan Vinkelmanin (Johann Winckelman, 1717 – 1768), arkeolog dhe estet iluminist gjerman, autor i "Historisë së artit botëror të lashtësisë". Midis viteve 1758 – 1760 Albani ndërtoi në Romë një vilë, për të grumbulluar në të koleksionin



Fragment nga një afresk  
i piktorit Rafael Mengs,  
pikturuar në Vila Albani  
të Romës.



Stambolli, ku janë  
realizuar disa vepra  
arkitekture nga artistë  
me origjinë shqiptare.



me veprat e artit antik dhe bashkëkohor. Po në ato vite forcoi edhe bashkëpunimin me Vinkelmanin. Mbrojtja prej Albanit e koleksionit të artit antik që studionte esteti gjerman, është vënë në dukje edhe në studimet e botimet që janë shkruar për këtë të fundit.

Duke pasur parasysh se Gëteja, kur vajti në Romë, e takonte e bashkëbisedonte shpesh me Vinkelmanin, është e natyrshe të mendohet se edhe Albani ynë ka pasur kontakt me poetin e madh. Vila ku ruante koleksionet A. Albani vlerësohet si një shembull tipik i vilës – muze për atë kohë. Ajo u dekorua nga piktori A. Rafael Mengs (Anton Raphael Mengs, 1728 – 1779), edhe ky një tjetër figurë e shquar e artit botëror.

Siç u përmend, pushtimi otoman pengoi zhvillimin e artit në vendin tonë, por megjithatë me origjinë shqiptare ishin disa arkitektë të shquar, si Sadefqar Mehmeti, Kristo Dulla, Sinan Atiku etj., që zbukuruan Stambollin dhe qendra të tjera të Perandorisë me vepra arkitekture. Vepra të bukura bënë edhe në Dalmaci artistë shqiptarë, si Andrea Aleksi, Miho Tivarasi, Gjon Durrësaku etj. Kështu, historiani dalmat Gelçiç (G. Gelcich) ka shkruar se "vetëm nga një krahinë e Shqipërisë së Veriut dolën



dyzet e ca piktorë e skulptorë të shquar". Kjo të bën të pohosh vetiu se kushedi sa vepra që mbahen për dalmate janë krijuar nga mjeshtër shqiptarë. Piktorët tanë më të njohur të mesjetës, si Onufri, Nikolla, Selenicasi, Shpataraku, Zografët etj., veç kishave në Shqipëri, kanë pikturuar edhe në vende të tjera fqinje, deri edhe në manastiret në malin Athos në Greqi. Këtu nga veprat më të bukura të këtij "koleksioni" është edhe një afresk i David Selenicasit, që është vlerësuar shumë edhe nga specialistë të huaj. Në këtë afresk vihet re një trajtim me vlera të mëdha artistike dhe me trajtim jetësor të figurave, duke "shkelur" skema të diktuar nga kanonet bizantine<sup>2</sup>.

Edhe në kohët më të reja kanë dalë artistë të shquar me origjinë shqiptare. Një nga piktorët më të njohur rumunë, Theodor Amani (1831 – 1891), thuhet se është me origjinë shqiptare<sup>3</sup>, ndërsa autori i librit "Arvanites" (Athinë, 1983) supozon (f. 123) se piktori më i madh i Greqisë së re, Nikolla Ozgjisiz, duhet ta këtë prejardhjen nga fisi shqiptar i Gjizajve dhe (f. 303) se një piktor i madh tjetër me origjinë po shqiptare është N. Vocos. Shumë piktorë arvanitas janë përfshirë edhe në enciklopedinë e pikturës greke (Oi Elines Zografoi, Athinë, 1976), ndërsa në vitin 1986 u botua në Athinë një kalendar me 12 vepra autorësh arvanitas, shoqëruar me një parathënie e me shënime biografike të veçanta. Në veprat e tyre pasqyrohen motive nga jeta e përditshme e njerëzve të thjeshtë. Në disa nga tablotë, gravurat e skulpturat e autorëve të mësipërm trajtohen edhe



Afresk i D. Selenicasit në një nga kishat e Malit Athos.

"Qytetarë të Kalesë së Rodenit"  
një nga kryeveprat  
e artit botëror,  
fotografuar nga Gjon Milli.



"Djaloshi me lepupj".  
(Tablo e piktorit arvanitas).

motive shqiptare, por në to zënë vend më të madh kryesisht pamje nga jeta e vendeve ku jetojnë e krijojnë. Duke e parë këtë përshtje nga një këndvështrim i këtij botimi, mund ta quajmë veprimtarinë e tyre si një aspekt të marrëdhënieve të ndërsjella kulturore: artistë shqiptarë kanë përjetësuar motive të shumta shqiptare.

Artistë me origjinë shqiptare vazhdojnë të shquhen edhe sot në botën artistike. Gjon Mili, të cilin shtypi i huaj e ka quajtur "gjeni shqiptar", është një nga personalitetet më të njohura të fotografisë artistike në botë. Madje ai është vlerësuar edhe si një nga mjeshtrit më të mëdhenj në fotografimin e kryeveprave të artit botëror. Midis piktorëve dhe skulptorëve në Siri shquhet Abdylkadar Arnauti, në Turqi – Sabi Fetahu, në Argjentinë – Salvador Kasem, në Itali – Ibrahim Kodra etj.

- 1) Zbulimi i gravurave u bë nga dr. Ëngjëll Sedaj, i cili botoi edhe shkrimin: "Një zbulim me interes për shkencat albanologjike", "Rilindja", 20 korrik, Prishtinë, 1985.
- 2) Shih: "Drita". Dh. S. Shuteriqi, "Një vepër e panjohur e David Selenicasit", 1982.
- 3) Shih: V. Bala, "Jeta e E. Gjikës", 1967, f. 24.

## "Krenar si një shqiptar"

Shprehjen "krenar si një shqiptar" (fier comme un albanais) e kanë përdorur francezët që në mesjetë, por jehona e kësaj krenarie ka qenë përhapur më parë. Në fillimet e shekullit të kaluar ky tipar ishte bërë aq i njohur sa të huajt figurën dinjitoze të shqiptarit e kanë përshkruar kurdoherë me termat e merituar. Në poemën romantike "Cajld Harold", p.sh., Bajroni ka shkruar:

.... këtu shqiptari ecën krenar... (Here the Albanian proudly treads the ground)<sup>1</sup>. Ndërsa të tjerë e paraqesin figurën e shqiptarit si zot në trojet e tij. "Disa herë, – është shkruar në një botim anglez të vitit 1869, – edhe mënyra se si shqiptari e mban pushkën ashtu sup më sup, një dorë te gryka e tjetrën te qyta, ia shton hijen e rëndë<sup>2</sup>. Nga ky përshkrim na kujtohet menjëherë gravura *Shqiptari* e piktorit vjenez Ludvig Hesaimer (Ludvig Hesseimer), në të cilën shqiptari pasqyrohet me po atë pamje që përshkruan udhëtari anglez: hijerëndë, me pushkën hedhur mbi sup. Në sfond, ku duken male të larta, ka vizatuar një shqiponjë që fluturon e lirë. Duket sikur paraqitet e njëjta pamje që përshkruhet nga udhëtari anglez, por nuk është ashtu. Siç nuk mund ta quajmë vargun e Bajronit një "transkriptim" në poezi të shprehjes franceze, ose siç nuk mund të thuhet se përshkrimi i shqiptarit hijerëndë në botimin anglez përsërit dy të parat, po ashtu edhe gravura e piktorit vjenez nuk është një ilustrim i përshkrimit të fundit. Të gjitha këto përshtypje janë



"Masakra e kios"

përfutur si shprehje në forma të ndryshme së njëjtës pamje reale në Shqipëri, të qëndrimit krenar të shqiptarit në trojet e tij të lashta.

Por si është pasqyruar kjo në veprat e piktorëve dhe grafistëve të huaj?

Një autor anglez ka shkruar se kur i vinte radha shqiptarit që të pozonte për t'u pikturuar, merrte në një dorë shpatën dhe në dorën tjetër një libër<sup>3</sup>. Sipas vëzhgimit të tij, janë bërë disa piktura të tilla me pozim. Dhe kjo është më se e natyrshme, pasi dëshirën për dije shqiptari e ka pasur po aq të shenjtë sa edhe idealin e lirisë së Atdheut. Por kohët e liga, siç shpreheshin rilindësit tanë për të kaluarën e mëmëdheut, nuk u dhanë shumë mundësi shqiptatëve për të pozuar me libër në dorë. Tablotë, gravurat dhe veprat e tjera artistike u mbushën kryesisht me figura luftëtarësh, me pamje nga betejat për liri, pasi në këtë mënyrë pasqyrohej më saktë realiteti i asaj kohe. Kështu, qëndresa për mbrojtjen e trojeve u bë motivi i përhershëm në veprat e autorëve të huaj.

Por për këto tablo shqiptarët nuk pozuan. Piktorë të huaj i panë vetë ata në luftë, ndërsa për vepra të tjera si "model për

të pozuar" shërbeu jehona e qëndresës. Aq shumë u bënë për-shtypje të huajve burrëria dhe krenaria e shqiptarëve, sa edhe në krijime në të cilin paraqiteshin pamje të tjera të jetës, ata e vinin në dukje këtë. Tabloja *Valltarët shqiptarë* e piktorit francez A. G. Dëka, p.sh., është vlerësuar për pasqyrimin e dinamizmit të valltarëve. Temperamenti i figurave të pasqyruara në të është sa madhështor aq edhe magjepsës, gjë që ka ndikuar edhe në stilin e autorit. Studiues të huaj kanë pohuar se piktori A. Dëka, i njohur më parë për një stil me të cilin figurat jepen të qeta e pikturohen me penelata të shtrira e të lëmuara, në tablonë *Valltarët shqiptarë* paraqitet më i zhdërvjellët e më shprehës. Edhe teknika e përdorur në këtë vepër, ndryshon nga ajo e gjithë krijimtarisë së tij<sup>4</sup>.

Pra, dinamizmi i valltarëve shqiptarë, i pasqyruar në këtë tablo, është shprehje e asaj qëndrese burrërore e krenarie në betejat me armikun.

Në vepërën e A. Dëkasë figura e valltarit është shumë jetësore. Një autor tjetër, anglezi Th. Hjuze, vallen e punuar nga Dëka, e quan *Valle kombëtare të shqiptarëve*. Ja si e përshkruan ai: "Vallëzimet dhe figurat e kësaj valle shërbejnë për të treguar gjallërinë mahnitëse dhe forcën muskulore të këtyre malësorëve të kalitur, të cilët zihen përdore, lëvizin ca kohë ngadalë, para e prapa, e pastaj vijnë rrotull vetvetes dhe në rreth, me lëvizje të shpejta, sipas ekzekutimit të muzikës dhe të zërit të tyre me forcë të plotë. Në të njëjtën kohë, korifeu, ose ai që heq vallen, i cili ndërrohet kohë pas kohe, bënte kërcime të çuditshme dhe përkulej nga prapa derisa i takonte koka në tokë, pastaj vërvitej lart në ajër me elasticitetin e një suste çeliku dhe flokët e shpupuritur i derdheshin tufa – tufa mbi sup"<sup>5</sup>.

Krenaria e shqiptarit ndihet me forcë edhe në tablotë, vizatimet dhe akuarelet e piktorit Ëzhen Delakrua. Në fillim mjeshtri francez u tërhoq nga kostumet e bukura që i mori hua mikut të tij, koleksionistit dhe piktorit Robert Ogyst (Robert August), nga litografite e piktorit anglez Xhozef Kartrait dhe nga albumi i kolegut të tij Lui Dypré me pamje nga Greqia e Shqipëria. Nga krijimtaria e Bajronit ai kishte mësuar edhe për trimërinë e "...bijve të shqipes, të cilëve armiku nuk ua pa kurrë

"Shqiptari", nga L. Heshaimer.



Fragment nga tabloja  
"Valltarë shqiptarë" e  
A. Deka.



shpinën...". Mbresa të pashlyeshme i kishin lënë vargjet: "E kush është aq trim sa sulioti zeshkan/ me fustanellë të bardhë e të zi tallagan?/ Ja lë tufën shqiponjës e bishës e zbret/ poshtë fushës me sulm si rrëkeja në det"<sup>6</sup>.

I nxitur nga përshkrime të tilla, kostumet e bukura shqiptare Delakrua i pikturoi të veshura në figura burrërore. Kjo vihet re edhe në ato krijime që, siç është vëzhguar nga një studiuese e huaj, Delakrua i ka bërë duke u mbështetur në litografitë e Xhozef Kartraitit<sup>7</sup>. Por ndërsa në punimet e piktorit anglez vihet re interesi në paraqitjen e kostumeve, në akuarelet e Delakruasë vërehet edhe prirja për të pikturuar tipa që, në saje të stilit aq të shkathët e shprehës të mjeshtrit të madh, bëhen shumë tërheqës. Trajtimi me këtë pikësynim i figurës së shqiptarit, tek i cili, veç pasurisë dhe bukurisë së kostumit, paraqiten edhe trimëria e forca e karakterit siç e përshkruan Bajroni, nga i cili është nxitur edhe Delakrua, çoi në realizimin e veprave si *Etyd për Boçarin*<sup>8</sup>, që nuk dimë përse nuk e realizoi në tablo, apo në kompozimin aq dinamik dhe sugjestiv *Kampi i Marko Boçarit*, tablo që u krijua disa vjet pas veprave për luftërat e popullit grek për liri, madje nga vitet e fundit të jetës së tij. Meqenëse u realizua në një periudhë kur motive të tilla ishin të rralla për mjeshtrin e moshuar, kjo tablo zë vend nderi në krijimtarinë



E. Delakrua: Figura e suliotit në tablonë "Masakrat në Kios"

e tij. Një studiues nënvizon se me atë vepër Delakrua "donte të ruante vitalitetin e tij krijues, që e kishte rrëmbyer më shumë se çdo gjë tjetër gjatë gjithë jetës"<sup>9</sup>. Kjo vepër, në të cilën pasqyrohet një çast nga luftimet e heroit shqiptar me suljotët për çlirimin e Greqisë, është realizuar rreth vitit 1862, dy vjet pasi Garibaldi pati deklaruar se "... shqiptarët janë heronj që janë dalluar në të gjitha luftërat për qytetërim". Dhe tablotë e Delakruasë janë një dëshmi tjetër që mbështetin thënien e Heroit të Njëmijëve.

Simpatia për figurën e shqiptarit mbase është një nga arsyet që në një tablo më të njohur kushtuar luftërave të popullit grek për liri *Masakrat në Hios*, E. Delakrua ka pikturuar edhe figurën e një suljoti me veshje kombëtare. Studiuesja N. A. Kallmyer pikturimin e suljotit në atë tablo e argumenton si rezultat të studimeve të shumta me atë motiv që bëri Delakrua. "Kostumi i tij, fytyra e hequr dhe e zeshkët nga dielli, balli i qarkuar nga tufa të gjata flokësh dhe festja e purpurt, — shkruan ajo, — identifikojnë atë si suljot"<sup>10</sup>. Sipas saj, futja e shqiptarit nga malet e larta të Sulit, në veri të Greqisë, midis banorëve të mjeruar të ishullit të Hios në Egjeun lindor, që në pamjen e parë mund të duket e pajustificuar e pa vend, shpjegohet me prirjen e romantikëve për të forcuar përshtypjen e autenticitetit e të ekzotikës (me anë të kostumeve) dhe si një luhatje imagjinare e një francezi mbi tragjedinë në Hios<sup>11</sup>.

*Etyd për Boçarin* veçohet nga akuarelet dhe vizatimet e tjera të Delakruasë. Në këtë punim, në të cilin bie më tepër në sy temperamentin e mjeshtrit, është dhënë me dinamizëm një përleshje e Boçarit me armiqtë. Vizatimit i janë lënë pjesë të papërfunduara, të cilat nxjerrin më shumë në dukje figurën e trimit shqiptar në një lëvizje të fuqishme dhe mbizotëruese. Nga ana kompozicionale vepra është ndërtuar në formën e piramidave që formojnë germën M, formë të cilën e gjejmë edhe në pikturat e njohura *Masakrat në Hios* (E. Delakrua) dhe *Trapi i Meduzës* (T. Zheriko), ku në majat më të larta të piramidave janë vendosur figurat kryesore të tablove. Në majën më të lartë të këtij vizatimi është paraqitur figura e Marko Boçarit duke goditur me forcë kundërshtarin.



T. Zheriko: "Trapi i Meduzës".

Etyd për Boçarin.



Nga Kamil Koro, tjetër autor francez po aq i madh se edhe E. Delakrua, është pikturuar figura e shqiptares, e cila njihet thujse në të gjitha vendet si pjesë e fondit të veprave më të bukura të pikturës botërore. Tabloja *Shqiptarja* përshkohet nga një atmosferë fërgëlluese ashtu si edhe peizazhet dhe çmohet ndër portretet më të realizuara të piktorit. Koro ka pikturuar,



gjithashtu portretin *Haideja*, vajzë e imagjinuar e Ali Pashë Tepelenës. Përkushtimi i figurës së gruas shqiptare nga një mjeshër i madh si Koro, veç të tjerash, shpreh jehonën që ngjallte zëri i Shqipërisë në Evropë; te tabloja a parë (jo vetëm duke u nisur nga titulli) mund të themi se simbolikisht paraqitet Shqipëria.

Duke u ngjitur njëri pas tjetrit, me pushkët mbi supe, shqiptarët janë paraqitur po aq krenarë edhe burrëtorë dhe të vendosur në tablonë *Trimat shqiptarë në ndjekje të armikut*, vepër e piktorit dhe arkitektit të njohur anglez Carl Kokrell. Tabloja është vizatuar në një këndvështrim të atillë që të jep idenë e figurave që ngjiten pambarim. Ritmi i tyre është në rritje dhe krijon dinamizëm e atmosferë epike, ndërsa peizazhi me male të larta krijon një pamje madhështore. Kjo vepër është një nga krijimet më të bukura e më përfaqësuese për Shqipërinë në vitet e luftërave për liri. Pas riprodhimit të parë më 1820 në librin e Hjuzit<sup>12</sup>, vepra është riprodhuar disa herë në botime të ndryshme për Shqipërinë, si edhe në libra të tjerë për Ballkanin, sic është një botim i viteve të fundit, në të cilën kjo vepër, e gravuruar nga një autor tjetër, është vendosur në kopertinë<sup>13</sup>.

Në tablonë e piktorit francez Leon Zherom shqiptarët paraqiten duke kënduar ose duke luajtur shah në kohë të lirë, si dhe në çaste të tjera të jetës së përditshme. Me kostume kombëtare, figurat janë paraqitur të hijshme dhe tërheqëse. Në harmoni me veshjen dhe me ornamentikën e mjedisit, Zheromi ka pikturuar edhe portretet e shqiptarëve, të cilët të tërheqin me pamjen fizike dhe qëndrimin imponant, madje edhe të parë në çaste më intime, si tablotë *Shqiptarë që këndojnë*, *Shqiptarë duke luajtur shah*, *Shqiptar i ulur me fustanellë* etj. Vepra të tilla ia rritin vlerën krijimtarisë së piktorit, pasi e largojnë menjëherë përshtypjen si tablo me karakter etnografik që mund të krijohej në pamjen e parë. Ato shquhen edhe për kujdesin që tregohet në paraqitjen e kostumeve dhe të gjithë ornamentikës karakteristike popullore. Zheromi ka pikturuar dhe shqiptarë që ka takuar në vende të tjera, si në Egjipt (tablotë *Shqiptar nga Kajro*, *Pas betejës*, *I burgosuri* etj.).

Ndërsa nga litografitë e Stakelbergut, që kanë vërtet

L. Zherom: "Shqiptarë".



Pallati i Luksemburgut,  
Paris, ku u vendos tabloja  
"Gratë suliote".



karakter etnografik, mund të veçohet vepra *Jeniçeri shqiptar në Janinë*, ku bie në sy edhe portreti burror i një luftëtari. Edhe litografitë e tjera të Stakelbergut janë punuar në mënyrë më artistike në krahasim me ato të autorëve të tjerë, që kanë paraqitur kostume kombëtare, si të Filipo Delpinos, apo edhe të Xhozef Kartrait, ku interesi përqendrohet në veshjet kombëtare e më pak në vizatimin e figurave që i mbajnë ato. Nga krijimet që njohim deri tani prej të tre autorëve që u përmendën (të cilët kanë paraqitur në albume të vaçanta figura me kostume kombëtare shqiptare etj.), *Jeniçeri nga Janina* i Stakelbergut është ndër krijimet më të bukura me temë shqiptare. Virtytet e shqiptarëve artistët e huaj i kanë vënë re e i kanë përjetësuar në ato vite kur ata, ndonëse luftonin duke u bërë ballë pushtuesve, nuk kishin një udhëheqës të shquar si dikur Skënderbeun. Lidhur me këtë tipike është gravura e piktorit francez Zhan Hile (Jean Hilaire), i cili na jep katër figura luftëtarësh shqiptarë të ulur pranë njëri – tjetrit, të veshur me kostume kombëtare dhe të armatosur. Ndoshta janë pikturuar në një çast pushimi pas betejës me armikun, apo qëndrojnë në rojë të trojeve të tyre, por këtu ka rëndësi të theksohet vizatimi i hollësishëm i portreteve. Domethënës është edhe shënimi pranë gravurës: "Këta shqiptarë krenarë mund të ishin përsëri heronj po të kishin një Skënderbej në krye të tyre" (Ces fiers Albanais seroient encore des heros s'ils avaient un Scanderbeg à leur tête)<sup>14</sup>.

Soloturni, ku ndodhen  
vepra me temë shqiptare.



Krijimtaria me motive të qëndresës gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare u popullarizua edhe më shpejt se veprat e mëparshme, aq sa në një revistë të huaj të asaj kohe u vu në dukje se "shumë është folur e shumë është shkruar për shpirtin e gjallë dhe kryengritës të shqiptarëve"<sup>15</sup>. Edhe vetë të huajt e quanin të natyrshme të flitej aq shumë për një popull ku edhe gratë tregoheshin po aq heroina sa edhe burrat. Tabloja patetike *Gratë suljote*, e piktorit Ari Shefer, realizuar më 1827, e ka përjetësuar këtë fakt. Madje vetë piktori, veç jehonës së heroizmit të grave suljote, për të realizuar tablonë u nxit edhe nga krijime të tjera artistike. Pukëvili ka shkruar se te shqiptarët "fryma patriotike është aq luftarake sa që edhe vetë gratë, ditën e rrezikut, ndajnë entuziazmin e përgjithshëm duke luftuar shpeshherë përkrah burrave, vëllezërve dhe djemve të tyre"<sup>16</sup>. Ndërsa në një këngë popullore botuar në Francë thuhet se te "...Suli i dëgjuar, Suli i famshëm, shikojmë të luftojnë fëmijët e vegjël, gratë dhe vajzat. Gruaja e Foto Xhavellës lufton me shpatë në dorë, me foshnjën në njërin krah e me armën në tjetrin dhe përparësen e ka plot me fishekë"<sup>17</sup>. Duke ditur se Ari Sheferi e pëlqente poezinë gjermane, mendojmë se për tablonë *Gratë suljote* do

të jetë ndikuar edhe nga vjersha *Suljotja* e poetit romantik gjerman V. Myler<sup>18</sup>, në të cilën lexohet: "Dhe tani po mpreh shpatën, për vete e dua,/ Thesari im, shpirti im, merrmë dhe mua/... Me ty, atje, dua vendin tim të kem,/ atje krah teje, i dashur, e lumtur do të jem"<sup>19</sup>. Tabloja e A. Sheferit u ble menjëherë për Pallatin e Luksemburgut në Paris.

Në vijën e parë të frontit, përkrah burrave, janë pikturuar edhe gratë shqiptare në tablonë e piktorit italian A. Biankini (A. Bianchini).

Në tablotë e shumta me motive shqiptare që ka krijuar piktori Pajo Jovanović, nuk pasqyrohet ndonjë pamje e drejtpërdrejtë nga luftërat për liri, por në to ndihet jehona e tyre. Tablotë *Vallja e shpatave*, *Mësimi i shpatës* apo *Këngë për Skënderbeun* të kujtojnë qendresën. Megjithatë, edhe në tablotë me motive të tjera, si *Vajza që i bie çiftelisë*, *Tregim nga Kosova*, *Përgatitja e nuses shqiptare*, ai i paraqet me dinjitet figurat e shqiptarëve, sidomos malësorët. P. Jovanović, kur bëri kontratën me galeristin e njohur anglez Vallis, u porosit për tablo me motive nga Ballkani, ose kryesisht nga Mali i Zi dhe Shqipëria, për të pasqyruar veçoritë karakteristike të këtyre popujve. E ai erdhi në Shqipëri, ku jetoi për një kohë, gjatë së cilës punoi tablo që u pëlqyen.

Por ndërsa në tablotë e Jovanovićit disa figura duket sikur pozojnë për t'u pikturuar, figura e malësorit nga Jugu në tablonë *Shqiptari në vrojtim*, e piktorit zviceran Frank Bukser (Frank Buchser), është krejt e natyrshme. Vepra është e viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur shqiptarë të armatosur e në vrojtim të armikut hasje në çdo krahinë të vendit. Në një shkrim që ilustron krijimet e Ketën Udvil (Ceton Woodville), autori i gravurave më të bukura për Lidhjen e Prizrenit, dëshmohet se piktori me autorin e artikullit panë që "çdo njeri mbi shkëmbinjtë, çdo bujk pranë parmendës, çdo bari tek ruante tufën dhe çdo qiraxhi që ngiste karvanin e kuajve, mbante në krah një pushkë"<sup>20</sup>.

Nën ndriçimin e qartë të diellit, në tablonë *Shqiptari në vrojtim* është dhënë me kolorit të pasur edhe peizazhi përreth. Mes barit të njomë shpërthejnë ngjyra të kuqe e të bardha të



Gravurë nga K. Udvil.

Gravurë nga K. Udvil.



luleve, sipër hapet horizonti blu deri thellë në malet e zbardhura nga bora. Në muzeun e Soloturnit të Zvicrës F. Bukseri ka ekspozuar edhe tablonë *Vajza shqiptare*.

Veç veprave të veçanta (që tani janë pronë e muzeve të artit) me motive nga qëndresa shqiptare, janë realizuar edhe dhjetëra krijime në grafikë, të cilat u stampuan në botime të ndryshme, si në gazeta, në revista, në albume, në kartolina etj.

Midis viteve 1815 – 1876, vetëm në katër revista të ilustruara "La guerra d' Oriente" (Milano, 1876 – 1878), "Tour du monde" (Paris, 1880), "Scribner's Monthly" (Nju – Jork, 1881), "Le Petit Journal" (Paris, 1908 – 1915) – u botuan rreth 100 gravura, vizatime dhe akuarele.

Pikënisja e tyre ishte ngjarja më e rëndësishme e kohës: qëndresa në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. "Një ditë bota do të dëgjojë për veprimtarinë e kësaj Lidhjeje Shqiptare", shkruhej atëherë pranë gravurave, ndërsa tani këto krijime me të vërtetë na japin mundësinë të mësojmë për veprimtarinë e Lidhjes. Gravurat janë artistikisht të bukura e të singerta, pasi u vizatuan nën krismat e pushkëve, pranë zjarrit të luftës. Vetë piktorët, siç thuhet në një nga shkrimet që ilustron me grafika të kësaj kohe, në udhëtimet që bënë mësuan më shumë gjëra mbi forcën e Lidhjes sa mund të kishin mësuar në një muaj të tërë anketimi në Shkodër<sup>21</sup>.

Herë pas here në faqet e revistave është vënë në dukje se vizatimet për gravurat janë bërë drejtpërdrejt nga natyra (d' après nature)<sup>22</sup>. Në ato vite, kur shumë nga krijimet që botoheshin në shtyp bëheshin në bazë të fotografive, shënimi "d' après nature" na bën të veçojmë nga këto revista vepra të tjera me temë shqiptare ku paraqiten besnikërisht tipa e mjedise, që janë dëshmi figurative për kulturën e historinë e vendit tonë. Në ato grafika janë fiksuar luftëtarë që morën pjesë në betejat, roja kufitare, rapsodë që u kënduan heronjve. Për pasqyrimin me besnikëri të realitetit, veç shënimit të mësipërm – "d' après nature" – bindemi edhe nga trajtimi artistik, ku nëpërmjet linjave e njollave grafike shqetësimi për fatet e Atdheut jepet edhe në monumentalitetin e figurave, në të cilat ndihet fryma heroike e kohës.

Në vitet kur u krijuan, gravurat shërbyen si ilustrime të shkrimeve për Shqipërinë. Më vonë ato u përdorën edhe nga vetë shqiptarët për të zgjuar ndjenjat patriotike të bashkatdhetarëve. Për riprodhime në gazetatat dhe revistat shqiptare u zgjodhën gravurat që flisnin me gjuhën e kohës. Më të mirat janë botuar më vonë edhe në libra albume të tjera për Shqipërinë. "Ribotime", kanë bërë edhe vetë autorët. Në bazë të skicave që bënë për njerëzit dhe natyrën në Shqipëri, ata realizuan edhe tablo me ngjyra vaji, duke e kaluar kështu temën shqiptare nga fletët e revistave në stendat e galerive e të muzeve të artit.

Piktori Ketën Udvil në fillim botoi vetëm dhjetë gravura me motive nga vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, po kur u kthye në studion e tij në Dyseldorf (Gjermani), veç gravurave në dru, realizoi edhe disa tablo me ngjyra vaji. Në vizatimet që bëri drejtpërdrejt nga natyra në Shqipëri, ai fiksoi karaktere e tipa shqiptarësh, të cilët më vonë i "qëndisi" në tablo me ngjyra vaji. Në gravurat dhe tablotë e Udvilit shqiptarët janë paraqitur sa madhështorë e stoikë, aq edhe njerëzorë e të lidhur me njëri-tjetrin.

Tablo në ngjyra vaji sipas grafikave dhe vizatimeve drejtpërdrejt nga natyra në Shqipëri, kanë bërë edhe piktori francez Teodor Valerio e piktorë të tjerë, të cilët botuan gravura në revistat që përmendëm. Për disa nga autorët e tjerë, si Fritel, Robida, Veber, Bonamore, Sarzhen, Mejer, Knajt etj., nuk kemi të dhëna për veprimtari aq të shquar sa ajo e Udvilit dhe e Valerios, ndërsa në revistën "Tour du Monde" është nënvizuar se ata kanë qenë nga piktorët më të njohur të kohës. Nëse më vonë ata nuk mbetën po aq të shquar, për ne kanë rëndësi, pasi fiksuan motive shqiptare në vitet kur luftohej për liri e pavarësi e kur veprat e autorëve tanë janë tepër të pakta.

Gravurat dhe vizatimet që ata botuan në shtypin e kohës, u bënë nxitje edhe për autorë të tjerë që nuk kishin ardhur në vendin tonë. Besnikëria në paraqitjen e tipave, të kostumeve e të mjedisit karakteristik, i ndihmoi ata që të jenë po aq të saktë në vizatimin e veprave sa edhe autorët që qenë vetë në Shqipëri.

Një pjesë e madhe e gravurave që u botuan në revistat e huaja, janë ende të panjohura, pasi koleksionet e plota të tyre

ruhen në biblioteka e muze. Studiuesja franceze Anjez Gyt (Agnese Gut) ka shkruar se vetëm në koleksionet e revistës "Le Petit Journal", disa herë edhe në kopertinë, janë botuar krijime me interes për njohjen e shqiptarëve. Këtij koleksioni, vazhdon A. Gyt, i përket edhe tabloja *Zhan d' Arka shqiptare*<sup>23</sup>, botuar në kopertinë si "një ilustrim i mahnitshëm"<sup>24</sup>.

- 1) Byron, "Childe Harold's Pilgrimage", London, 1812; Bajron, "Cajld Harold", Tiranë, 1956.
- 2) H. F. Tozen, "Researches in the Highlands of Turkey", Vol. I, f. 207.
- 3) S. C. Hobhause, "A journey through Albania", London, 1813, f. 144.
- 4) Revue du Louvre, nr 4-5, 1964, f. 285-286.
- 5) Th. Hughes, "Voyage à Janina en Albanie", vol. 2, Paris, 1828, f. 29.
- 6) Bajron, "Cajld Haroldi", Tiranë, 1956.
- 7) N. A. Kallmyer, "Of suliots, Arnauts, Albanians and Eugene Delacrois", The Burlington Magazine, London, 1983, f. 488.
- 8) Ndodhet në kabinetin e vizatimeve të Muzeut të Luvrit në Paris me shifrën RF 10035. Është botuar në librin "Journal du romantisme", f. 143, Paris, 1981.
- 9) Rene Hyghe, "Delacroix ou le combat solitaire", Paris, 1961.
- 10) N. A. Kallmyer, art. cit., f. 477.
- 11) Po aty, f. 479.
- 12) Th. S. Hughes, "Travels in Greece and Albania", London, 1920.
- 13) F. J. Philipps, "Fragmente aus dem Orient", München, 1963.
- 14) "Voyage pittoresque de la Grèce", tome premier, Paris, 1832.
- 15) Scriben's Monthly, vol. XXI, New York, 1881.
- 16) F.C.H.L. Pouqueville "Voyage en Morée, Constandinople, en Albanie et dans plusieurs autres parties de l' Empire Ottoman pendant les années 1798-1801", Paris, 1805.
- 17) Cituar nga artikulli *Gratë suliote dhe Myleri*, botuar në revistën "Shqiptarja e re", nr 10, Tiranë, 1981.
- 18) Wilhelm Müller (1794-1827). Shkrimtar dhe poet gjerman, autor i disa poezive kushtuar kryengritjes greke për çlirimin nga pushtimi osman. Në këtë cikël bën pjesë edhe vjersha *Suliotja*. Myleri u bë më i njohur nga dy melodi të bukura që krijoi kompozitori Shubert mbi tekste të poezive të tij.
- 19) Shqipëruar nga Xh. Beqaraj.
- 20) A. Methius, vep. cit.
- 21) Atol Methius, vep. cit.
- 22) "Tour du Monde", f. 344, 404, 411, etj. Paris, 1880.
- 23) Në shtypin tonë është shkruar se "Zhan d' Arka shqiptare" është vepër e piktorit shqiptar të Rilindjes Ndoc Martini. (Anastas Kondo: *Zhan d' Arka shqiptare* - vepër e panjohur e Ndoc Martinit, "Ylli", nr I, Tiranë, 1981, f. 19-20.
- 24) Anges Gut, "Les Albanais vues par les lecteurs du Petit Journal". Në librin "La crise Balcanique de 1908-1912 et l' indépendance d' Albanie", Paris, 1982, f. 63.

## Bajroni, piktorët dhe Shqipëria

Kostumi shqiptar që përdori Bajroni, vendosur në Muzeun e Veshjeve, Londër.



Poeti Bairon

Në vitin 1809, poeti i shquar anglez Xhorxh Bajron i shkruante nënës së tij se shqiptarët i bënë përshtypje të jashtëzakonshme. "Veshja shqiptare, – thoshte poeti në letër, – është më madhështorja në botë. Ajo përbëhet nga një fustanelle e bardhë dhe e gjatë si dhe nga një gunë e praruar, jelek e xhaketë kadifeje me ngjyrë të purpurt, të dyja të qëndisura në ar, koburet e kama me doreza argjendi"<sup>1</sup>. Në fund e njof-tonte se kishte marrë disa kostume të tilla, që do t'i sillte në Angli si gjërat më të shtrenjta nga Shqipëria. Një kostum ia kishte dhuruar Ali Pasha ditën që e pati mysafir në sarajet e tij në Tepelenë. Në Londër ato u vlerësuan vërtet si gjëra të çmueshme, aq sa një komplet nga ato u vendos në Muzeun Kombëtar të Veshjeve, ku gjendet edhe sot<sup>2</sup>.

Në këtë mënyrë kostumet shqiptare dhe përshtypjet e Poetit për këtë veshje arritën deri në Londër. Por mrekullimin që pati Bajroni nga ato e pasqyroi në poemën romantike "Djaloshi Harold". I befasuar, ai pa "të rreptin shqiptar me fustanellë/ E rrobat e qëndisura me ar/ Armët e lara me flori, sa bukur!"<sup>3</sup>.

Ndërsa përshtypjet për veshjen shqiptare nëpërmjet letrës i mësoi vetëm nëna e Bajronit, ose edhe të afërm të tjerë, me anë të "Çajld Haroldit" i mësuuan mijëra anglezë dhe më vonë francezë, gjermanë e popuj të tjerë të Evropës, ku veprat e Bajronit u bënë shumë shpejt të njohura. Por veç bukurisë së kostumit, lexuesit e shumtë të "Çajld Haroldit" mësonin edhe



Th. Filips: "Bajroni me kostum shqiptar".  
 Bajroni me kostum shqiptar duke u betuar mbi varrin e Marko Bocarit. (Tablo e Ludviko Liparinit).



për trimërinë, basnikërinë e virtytet e larta të shqiptarit: "Shqipëri, lejomë të kthej sytë e mi mbi ty, o nënë burrash të rreptë!.../ Armiku ua pa kurrizin ndonjëherë?/ Kush e duron si ata mundimin e luftës?/ Shkëmbinjtë e tyre s' janë më të patundur/ Nga vetë ata në çast rreziku o nevoje./ Ç' armiq për vdekje, po sa miq besnikë!/ Kur besa e nderi i thërret të derdhin gjakun,/ Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre....".

Nga vargje të tilla, të shkruara me frymëzim, nuk kish sesi piktorë dhe artistë të tjerë të mos nxiteshin për të krijuar vepra arti mbi Shqipërinë. Portretisti anglez Tomas Filips (Thomas Philips) realizoi një punim simbolik *Bajroni i veshur me kostum*



*Bajroni me veshje shqiptare gjatë shtegtimit në Greqi.*

*shqiptar*. Tabloja u vendos në Galerinë Kombëtare të Portreteve në Londër dhe vlerësohet edhe sot si një nga portretet më të bukura të Poetit. Kjo vepër është riprodhuar në shumë libra e në botime të tjera enciklopedike në vende të ndryshme të botës gjithnjë me të njëjtin titull: *Bajroni i veshur me kostum shqiptar*. Popullarizimi i këtij portreti është kuptimplotë, sepse në të është përjetësuar ai që ka frymëzuar e frymëzon shumë piktorë për trajtimin e temës shqiptare. Edhe T. Filipi bëri tri variante të portretit, dy prej të cilave ndodhen në Londër, tjetra në Athinë. Rreth vitit 1840, italianin Ludoviko Liparini pikturoi tablonë *Betimi i Bajronit mbi varrin e Marko Boçarit* (Museo Civico, Treviso, Itali). Midis grupit të figurave (rreth pesëdhjetë), që mbushin tablonë me përmasa 260 × 340 cm, spikat figura e Bajronit, që ndrit nga ngjyrat dhe qëndisjet në ar të kostumit shqiptar.

Në vepra të tjera Bajroni është paraqitur me kostumin shqiptar në mjedise të ndryshme të Greqisë, si të tabloja që ndodhet në Muzeun Benaki të Athinës, duke pohuar në mënyrë figurative faktin që Poeti e mbajti veshur kostumin shqiptar gjatë gjithë shtegtimit të tij. Në tablonë *Ëndrra e Bajronit* të piktorit anglez Carl L. Istlejk (C. L. Eastlake), veç Bajronit, ka edhe figura të tjera me veshje shqiptare, që autori i pikturoi sipas modeleve që bëri me kostume shqiptare gjatë vitit 1819, kur udhëtoi në Greqi. Disa nga akuarelet me kostume shqiptare e greke të këtij piktori ruhen edhe sot në një koleksion privat në Londër<sup>4</sup>.

Janë realizuar edhe vepra të tjera të figurës së Bajronit me veshje shqiptare. Disa prej tyre u paraqitën edhe në ekspozitën "Ringjallja greke dhe miqtë italianë të Greqisë" (Risorgimento greco e filellenismo italiano), që u hap në Romë në vitin 1968.

Por një nga vlerat e mëdha të krijimtarisë së Bajronit lidhur me vendin tonë qëndron në faktin që theksuam, se ai u bë nxitje për shumë piktorë në trajtimin e pamjeve nga jeta shqiptare. Lidhur me këtë, në jetëshkrimet e shumë autorëve, si dhe në shënimet që shoqërojnë veprat e tyre, është theksuar se Bajroni ka ndikuar në trajtimin e temës shqiptare. Në shënimet pranë disa e grafikave dhe tablove herë pas here janë cituar vargje



H. Uiliams: "Burrë me kostum shqiptar".

të Bajront. Pranë gravurave të Ketën Udvilit, p.sh., ku paraqiten me vërtetësi tipa shqiptarësh me kostume, me ornamentikën tonë të pasur popullore, shkruhet se piktori është nxitur edhe nga përshtypja e Bajronit për "kostumin e mrekullueshëm shqiptar, me fustanellë e me rrobat e qëndisura me ar dhe armët e lara me flori". "Përshkrimi i Bajronit, – thuhet aty, – sjell të gjallë përpara mendjes së njeriut që nuk ka shëtitur këtu, kostumin e mrekullueshëm shqiptar. I zbukuruar me këtë madhështi të bardhë, të kuqe dhe të artë, shqiptari të kënaq syrin, njëlloj si në fillim të shekullit kur Bajroni e pa në jug të vendit"<sup>5</sup>.

Gravurat e piktorit tjetër anglez H.U. Uiliams (H.U. Williams) me motive nga bregdeti shqiptar, të botuara në albumin me pamje të zgjedhura nga Greqia, janë shoqëruar me vargje të shkëputura nga "Çajld Haroldi", duke ua përshtatur pamjet figurative përshkrimeve poetike të Bajronit. Gravura e parë me temë nga vendi ynë shoqërohet me vargjet: "O Shqipëri ku lindi Iskanderi,/ Këngë e rinisë, fanar i të urtëve/... lejomë të kthej sytë e mi/ Mbi ty, o nënë burrash të rreptë". Katër gravurat e tjera kanë strofa që përshkruajnë peizazhin e pikturuar. Uiliamsi ka vizatuar edhe figura me kostum shqiptar.

Nga fillimi i shekullit të kaluar, shumë piktorë anglezë, francezë, gjermanë e të tjerë ndërmorën udhëtime në disa shtete të Lindjes, për të përjetësuar në art pamje karakteristike të natyrës, kostumeve dhe ornamentikës popullore të atyre vendeve. Veprat e shumta të realizuara gjatë këtyre udhëtimeve u përmbledhën në albume të veçanta. Rrugën drejt Shqipërisë disa piktorë anglezë, autorë të albumeve që përmendëm, ua "mësoi" Bajroni nëpërmjet "Çajld Haroldit". Në albumet "Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia" (1822), "Pamje të zgjedhura në Greqi" (1829), "Skena në Shqipërinë e Jugut" (1855), "Ishujt Jonianë dhe Greqia e Kostandinopoli", ku janë botuar dhjetëra litografi e gravura me pamje nga vendi ynë prej autorëve Xh. Kartrait, H. Uiliams, H. Kuk (H. Coock), P. Beresford, citohen vargje të Bajronit për Shqipërinë, ose përmendet emri i tij për përshkrimet që u ka bërë Shqipërisë dhe shqiptarëve.



L. Zherom: "Shqiptare".

Bajroni përmendet edhe në shumë libra të tjerë, ku janë botuar gravura, litografi e vizatime autorësh anglezë, si Ç. Kokrell, E. Lir, E. Durham, K. Gordon, E. Knajt etj.

Bashkë me "Çajld Haroldin", kufijtë e Anglisë i kapërceu edhe frymëzimi bajronian. Piktori francez Ëzhen Delakrua, në kohën kur krijonte tablotë me temë nga Shqipëria e Greqia, në ditarin e tij të datës 11 maj 1824 shkruante: "Për t'u ndezur i tëri, kujtoj vargje të Bajronit"<sup>6</sup>. Pohime të tilla me shkrim nuk kemi nga piktorë të tjerë romantikë francezë, si A. Deka, A. Shefer, L. Zherom etj., por vetë krijimtaria e tyre e pohoi këtë.

Disa vepra u realizuan edhe nga ilustrimet në gravura ose akuarele që krijuan piktorë të njohur mbi "Çajld Haroldin". Kështu, piktori francez Aleksandër Kolé ka ekspozuar disa litografi me subjekte nga poema e Bajronit<sup>7</sup>, në të cilat janë vizatuar edhe figura shqiptarësh me veshje kombëtare. A. Kolé ka realizuar edhe një tablo ku paraqet një djalosh të veshur me të njëjtin kostum si ai që mori Bajroni nga Shqipëria. Mbase ka marrë si model atë që u vendos në Muzeun e Veshjeve në Londër, sepse ai nuk ka qenë as në Shqipëri as në Greqi.

- 1) "Correspondence de Lord Byron", Paris, 1825, f. 118.
- 2) Antonia Guzzeta, "Byron in Albania", f. 20. Palermo, 1978.
- 3) Bajron "Çajld Haroldi", shqipëruar nge Skënder Luarasi. Tiranë, 1973, f. 79.
- 4) David Robertson, "Sir Charles Lock Eastlake and the Victorian Art World", Princeton, N.J., 1977.
- 5) Athol Mayhew, "In Albania with the Ghegs", Scriben's Monthly, vol. XXI. New York, 1881.
- 6) Cituar prej artikullit "Quella Grecia dentro di noi", "Corriere della sera", 22.4.1986.
- 7) "Historical illustration of Lord Byrons works in a series of Etching by Reveil from original Paintings", by A. Colin, London, 1833.

## Kostume madhështore, ornamentikë e pasur



G. Skotin: "Ushtar shqiptar".

Kostumeve dhe ornamentikës sonë popullore u është bërë jehonë nëpërmjet vizatimesh, grafikash, tablosh apo albumesh të veçanta me karakter etnografik, si dhe nëpërmjet shumë veprave me motive të tjera. Por vlerësimi i Bajronit për kostumin shqiptar si *kostumi më madhështor në botë* duket sikur është lajtmotivi kryesor që i ka frymëzuar autorët në krijimet e tyre me temë shqiptare. Në botimin tonë, për lehtësi studimi, do t'i veçojmë krijimet për kostumet nga ato për mjediset tona karakteristike.

Punime më pamje të tilla janë të hershme dhe janë riprodhuar në botime të ndryshme. Për shembull, gravurat e piktorit G. Skotin *Ushtar shqiptar* dhe *Fshatar shqiptar* u botuan më 1715 në pëmbledhjen me 100 gravura që paraqesin kostume të kombeve të ndryshme të Evropës<sup>1</sup>. Por gravura, madje edhe tablo me figura shqiptarësh me veshje kombëtare, janë realizuar edhe më parë. Jehona që në mesjetë e bukurisë së kostumeve tona kombëtare në disa vende të Evropës bëri që jo vetëm të përdoren si veshje në ceremoni festive, por edhe të pikturohen në tablo me ngjyra vaji. Dëshmi për këtë është kompozimi i bukur *Festë në Venedik* i piktorit M.I. Skoti (M.I. Scotti), në të cilin e vetmja figurë e plotë në plan të parë midis atyre që vallëzojnë, është një burrë me veshje kombëtare shqiptare. Fustanella e bardhë dhe pjesë të veshjeve me ngjyra më të çelura spikatin midis gjithë kostumeve të tjera. Vepra u riprodhua me

ngjyra dhe në kartolina, që vazhdojnë të qarkullojnë deri në ditët tona<sup>2</sup>.

Si punime më serioze me litografi e gravura ku paraqiten kostumet shqiptare, janë disa albume të përgatitura në fillim të shekullit XIX. Më 1822 piktori anglez Xhozef Kartrait botoi në Londër dhjetëra litografi me ngjyra të përmbledhura nën titullin «Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia» (Selection of the Costumes of Albania and Greece). Në fletë të veçantë ai pikturoi figura në pamje dhe në pozicione të ndryshme, për të dhënë larminë e kostumeve tona kombëtare. Albumi me veprat e riprodhuara u përhap në disa vende të Evropës, ndërsa disa nga origjinalet ruhen në Muzeun Benaki të Athinës dhe në koleksione të tjera në Angli e në Greqi. Kartraiti paraqiti figura të shqiptarëve dhe peizazhe të natyrës sonë edhe në një album tjetër me litografi që kishte botuar, përsëri në Londër, një vit para albumit me kostume<sup>3</sup>. Të përdorura në disa libra, ato janë vlerësuar si punimet më të sakta që pasqyrojnë veshjet kombëtare shqiptare e greke. Edhe në botimet e ditëve tona krijimet e këtij autori riprodhohen në disa vende për të ilustruar artikuj mbi veshje dhe punime të artizanatit shqiptar<sup>4</sup>. Litografitë e albumit të Xh. Kartraitit shërbyen edhe si mbështetje për vepra me figura të shqiptarëve prej piktorësh të tjerë të mëvonshëm. Njihen, p.sh., dy akuarele dhe një vizatim i Delakruasë, që janë bërë sipas katër prej këtyre litografive. Mjeshtri francez i ka përdorur ato për studimet në pikturimin e figurave të shqiptarëve. I ka vizatuar në të njëjtën siluetë e me të njëjtat lëvizje, veçse me një trajtim më shprehës e më të vrullshëm, si gjithë krijimet e tjera të tij. Delakrua u ka qëndruar besnik litografive të Kartraitit, pasi i ka vlerësuar si burime të sakta për autenticitetin e shqiptarëve dhe të kostumeve të tyre. Siç është vënë në dukje edhe nga studiuesja N. Kallaimer, këto litografi përbënin edhe ikonografinë shqiptare për Delakruanë<sup>5</sup>.

Shumë figura me kostume kombëtare u paraqitën në albumin me veshje të disa popujve të Ballkanit, realizuar nga Filipo Delpino në fillim të shekullit XIX. Punimet janë me ngjyra, në përmasa të mëdha dhe me shënime përkatëse, në



*Shqiptari në Venedik.  
(Tablo nga I. Skoti).*



Muzeu Benaki, Athinë,  
ku ka disa vepra me temë  
shqiptare.

të cilat lexohen titujt: *Shqiptarë, Ushtar shqiptar, Gjuetar shqiptar, Grua shqiptare* etj. Ngjyrosjet janë bërë pa shumë mjeshtëri, por vlera e tyre qëndron në paraqitjen e saktë të veshjeve, që artisti i ka parë gjatë një udhëtimi të tij në Shqipëri. Albumi i Delpinos ka qenë me tirazh të vogël, pasi për specifikën e teknikës ai nuk mund të riprodhohej në shumë kopje. Një kopje e këtij albumi ndodhet në fondin albanologjik të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë<sup>6</sup>.

Me vlera artistike janë edhe figurat me kostume kombëtare të piktorit Oto Mas Stakelberg, i cili u kushton rëndësi kostumeve, duke i ndërtuar me vlera plastike figurat me pamje e pozicione të ndryshme dhe duke realizuar portrete me gjendje të veçantë psikologjike. Nga 50 litografi që ka përmbledhur në album, disa paraqesin figura shqiptarësh. Më të bukurat janë *Jeniceri* dhe *Oficeri shqiptar*. Litografitë e Stakelbergut u ribotuan edhe në libra të tjerë, por riprodhimet më të mira u bënë në albumin e përgatitur nga vetë autori<sup>7</sup>.

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κωνσταντίας

E. Delakrua:  
"Luftëtar shqiptar".

Xh. Kartrait:  
"Kufitar shqiptar".





Xh. Kartrait: "Grua shqiptare".



E. Delakrua: "Shqiptar me veshje kombëtare".



Xh. Kartrait: "Shqiptar me veshje kombëtare".



E. Delakrua: "Një luftëtar dhe një grua shqiptare".

Figura shqiptarësh me veshje kombëtare që udhëtojnë, pushojnë apo soditin natyrën, janë pikturuar në albumin e autorit anglez Poer Beresford. Në litografinë me përmasa të mëdha të këtij albumi janë paraqitur edhe ndërtime e mjedise karakteristike nga jugu i Shqipërisë. Në veprën *Skena në Shqipërinë e Jugut* (Scenes in Southern Albania) piktori ka paraqitur shqiptarë me banim në Artë, në Prevezë, në Filat etj. Albume të tilla u bënë nxitje edhe për realizimin e tablove me ngjyra vaji.

Përveç albumeve, për pikturimin me saktësi të kostumeve shqiptare shërbyen veshje e objekte të karakterit etnografik, që morën nga Shqipëria koleksionistë të ndryshëm nga Evropa. Një nga më të njohurit e nga i cili u ndikuan piktorët romantikë, ka qenë piktori dhe koleksionisti francez Robert Ogyst. Sa herë është shkruar për pikturën romantike në Francë emri i Ogystit përmendet si një figurë e rëndësishme, që ndikoi edhe te piktorë të tjerë. Ka qenë mik me Delakruanë, Zherikonë, Ari Sheferin, A. Dekanë etj. Në fillim të viteve 20-të të shekullit të kaluar ai erdhi në vendin tonë dhe, pasi punoi disa tablo me pastel,



DEDICATED TO THE LADY EMILY COZZIRIS.

Twelve Sketches in double-tinted Lithography.

OF  
**SCENES**

IX  
**SOUTHERN ALBANIA.**

BY  
CAPTAIN G. DE LA POER BERESFORD.

LONDON:  
PUBLISHED MAY 1, 1855, BY DAY AND SON,  
Lithographers to the Queen,  
GATE STREET, LINCOLN'S INN FIELDS.

Frontespici i albumit  
të P. Beresfordit.


që tani ruhen në Muzeun e Orleanit (Francë), mori me vete kostume, armë të stolisura me argjend dhe objekte të tjera të kulturës sonë popullore<sup>8</sup>. Në fillim ia dha mikut të tij të ngushtë Delakrua, të cilit, siç është shkruar në disa botime, këto objekte i zgjuan kureshtjen për Lindjen<sup>9</sup>. Delakrua ka bërë disa vizatime, akuarele dhe etyde. Më të njohurat janë *Dy etyde me kostum suljot* me ngjyra vaji (Muzeu i Luvrit), *Dy shqiptarë në akuarel* (koleksion privat, Athinë), *Burrë dhe grua shqiptare* (Kabineti i vizatimeve në Muzeun e Luvrit). Lidhur me këtë, studiuesja N. Kallaimer ka vërejtur se "entuziazmi i Delakruasë për bukurinë dhe pasurinë e kostumit shqiptar mund të krahasohet me entuziazmin e Bajronit, poetit të tij të preferuar të kohës".

Por ndërsa Bajroni e ndjeu kënaqësinë duke i parë shqiptarët të veshur me këto "kostume mahnitëse", madje i veshi edhe vetë gjatë shtegtimeve të tij, Delakrua u mjaftua duke i marrë hua nga "Monsieur Auguste" ose duke i parë në litografitë me ngjyra të Xh. Kartraitit.

Në analizën që i bën akuarelit *Dy shqiptarë* N. Kallaimerit shkruan: "Ngjyrat janë me një shkëlqim mahnitës. Bluja dhe karminia e ndritshme, portokallia e sinqertë dhe e bardha e pastër vlerësojnë njëra-tjetrën. Qëndisjet janë bërë me fije arî. Detajet janë trajtuar si modele të sheshta, ndërsa format e tjera janë modeluar me nuanca delikate si në miniaturë. Ngjyrat e ndritshme, theksimet e arta, penelatat e qarta, të gjitha kontribuojnë për vlerat të këtij punimi"<sup>10</sup>. Studiuesja A.M. Shabur (A.M. Chabour) në letrën shoqëruese për fotografinë e tablove me ngjyrë vaji *Dy etyde me kostum suljot* shkruan se nëpërmjet penelatave të shkathëta të Delakruasë ndrit kostumi i bukur shqiptar. Nga krijime të tilla me frymëzim studiuesi anglez L.E. Xhanson arrin në përfundimin se me vëmendjen që tregon për kostumet shqiptare, Delakrua, zbulon interesin e tij për miniaturat persiane të vitit 1820<sup>11</sup>.


Me interes është edhe një shënim me dorën e Delakruasë në vizatimin *Një ushtar dhe një grua shqiptare*. "Ata kanë kësulë të stoftë... sandale shajaku... Kostume të mirditorëve, rãçe shqiptare. Gjirokastritët, veshjet e të cilëve janë të bardha si

Kështjella në Fontenblo,  
ku u krijuan disa vepra  
me temë shqiptare.



dëbora”. (Ils ont une callot de feutre... cothurne de bure... Costumes des Mirdites, race albanaise. Les argirò Castro (sic), dont les habits égalent la neige en blancheur). Ky shënim tregon se mjeshtri është interesuar edhe për kostume të zonave të tjera shqiptare. Për këtë shënim studiuësja N. Kallaimer është e mendimit se Delakrua ndoshta është nisur edhe nga përshkrimet që i kanë bërë kostumit shqiptar udhëtarët A.L. Kastelan<sup>13</sup> apo E.D. Doduell. Disa mbajnë feste të vogël, disa çallma. Shqiptarët i pëlqejnë jashtëzakonisht zbukurimet prej ari dhe argjendi në rrobat e tyre... Shqiptarët më të pasur mbajnë jelek kedifeje dhe ari, me zbukurime elegante...<sup>12</sup>.

Në vitet '30-'40 të të shekullit të kaluar. R. Ogysti me të gjitha kostumet dhe objektet e tjera që solli nga Shqipëria, u vendos në Fontenblo, ku punonin mjeshtrë të pikturës franceze, si K. Koro, A. Deka, A. Shefer, Gjatë atyre viteve u realizuan *Valltarët shqiptarë*, *Grua shqiptare me fëmijë*, *Fshatar shqiptar*, *Dyluftim shqiptar*, *Kapedan shqiptar*, nga A. Deka, *Gratë suljote*, nga A. Shefer, *Shqiptarja dhe Haideja*, nga K. Koro etj. Kështu, nëse me vendosjen e skulpturave antike që u morën nga Italia në shekullin XVII Fontenbloja u quajt “Roma e vogël”, në vitet '30-'40 -të shekullit XIX mund të themi se me kostumet, armët dhe objekte të tjera karakteristike që sollën Robert Ogysti dhe koleksionistë në tjerë, u krijua një muze i vogël i kulturës popullore shqiptare. Ka mundësi që në këtë atmosferë të ketë ndier frymëzimet e para edhe piktori Leon Zherom. Më vonë ai udhëtoi edhe vetë në vende të Lindjes dhe,



Kopertina e albumit të Xh. Kartrait.

ashtu si dikur Bajroni, edhe ai i pa shqiptarët e i përjetësoi në disa tablo. Figurat në tablotë e tij përgjithësisht janë pikturuar pa shumë lëvizje, më shpesh edhe në gjendje statike për të realizuar sa më mirë pikturimin e veshjeve. Nga ky këndvështrim tablotë e L. Zheromit përqasen deri diku me ato të piktorit Pajo Jovanoviç. Thuhet se është i njëjti pikësnyim nga të dy autorët. Sidoqoftë, të njëjtat motive janë paraqitur ndryshe në tablotë e tyre. Zheromi, i shquar në punimet e tij për harmoni të ngjyrave, edhe kostumet e figurat e vizatuara i realizon në përshtatje me gjendjen e tyre psikologjike dhe mjedisin. Tablotë e Jovanoviçit janë më piktorike, kanë më shumë vibrime ngjyrash, që i përshtaten edhe një gjendjeje dinamike të figurave. Shpesh ato japin edhe tensionin e brendshëm si të *Vallja me jataganë*, *Lufta e gjelave*, *Mësimi i shpatës* etj.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë Jovanoviç i u njoh edhe me pasurinë e kulturës sonë popullore. Në fletoren e tij të shënimeve ruhen 70 fletë plot skica me studime të kokave, duarve, lëvizjeve të malësorëve, të arkitekturës e të kostumeve popullore shqiptare. “Që atëherë kur kishte vizatuar kostumet me armët, ai kishte shënuar edhe fjalët më të domosdoshme shqipe”, shkruan studiuesja O. Bozhiskoviç<sup>13</sup>. Gjatë qëndrimit në Shkodër ai u miqësua edhe me piktorin tonë të shquar rilindës Kolë Idromeno. Thuhet edhe me kërkesën e vetë Jovanoviçit, në një nga tablotë e tij edhe Idromenoja e ka pikturuar figurën e një shqiptari me veshje kombëtare.

Por me gjithë këto, mendimi i etnografëve tanë është se në shumë vepra të autorëve të huaj nuk ka aq saktësi në paraqitjen e kostumeve kombëtare, gjë që për disa krijime mund të jetë e vërtetë, sidomos për tablotë që u krijuan larg vendit tonë. Në këto raste piktorët kanë përdorur kostumet e koleksionistëve të huaj, që nuk kanë qenë gjithnjë të plota, pasi ndodhte që jashtë shiteshin pjesë veshjesh dhe jo kostumi i plotë. Por kjo do t’ua ulte vlerën atyre tablove nëse ne do t’i përdorim thjesht si ilustrim ose si dokumente për kostumet kombëtare. Këtu është me vend të theksohet se qëllimi i autorëve të tyre ka qenë të jepnin pamje nga jeta shqiptare. Shpesh, për të rritur vlerat piktorike të tablove, kanë bërë edhe ndonjë



E. Delakrua: "Burrë me kostum suliot".

ndryshim, por që nuk cënon vlerat e kulturës sonë, apo nuk krijon paqartësi në trajtimin e temës shqiptare; ndërsa autorët që kanë qenë në vendin tonë, në veprat a tyre i kanë realizuar ato me saktësi. Madje duke vizatuar drejtpërdrejt nga natyra, ata kanë pasqyruar me imtësi të madhe edhe ornamente të veçanta. Pra, krijimet e tyre kanë interes edhe për studiuesit e etnografisë. Të këtij karakteri janë disa punime të T. Valerios, sidomos në veprën *Cift shqiptar nga jugu*, dhe shumë gravura të piktorit Ketën Udvil. Tabloja e tij *Shqiptarë duke u argëtuar* flet edhe për kulturën tonë materiale. Veç figurave me veshje të bukura kombëtare, në to janë punuar me kujdes objekte të ndryshme, pjesë të brendshme të banesës të skalitura me gdhëndje artistike, oxhaku dhe tavani me punime druri etj. Po kaq me vlerë janë edhe tablo të tjera të këtij piktori, si *Në pazarin e Shkodrës*, *Në ditë pazari*, etj.


Udvil duket se ka qenë shumë i entuziazmuar nga pasuria dhe bukuria e ornamentikës shqiptare. Në fjalët që përcjellin grafikate të tij thuhet: "Se pari, shqiptarët nuk janë vetëm punëtorë të aftë për punime të ndryshme dore, por vendi ka disa prodhime të rralla, të cilat nuk qëndrojnë aspak prapa prodhimeve artistike të kryeqyteteve tona perëndimore. A mund të thuhet kjo për serbët, bosnjakët ose malazezët? Në qytetin e Pejës dhe të Gjakovës bëhen punime filigrani prej ari e argjendi, që janë shumë më të mira se ato të Maltës, si nga ndjenja artistike që shfaqet në motivet e tyre ashtu edhe nga thurja e finesa e mrekullueshme e këtyre objekteve. Këto punime të shkëlqyera të Gjakovës, të ngjashme me dantelat, kërkohen me shumë dëshirë në çdo pazar. Të çmueshme janë "Kupat e arta të punuara në filigran, të bëra për të mbrojtur dorën nga të djegurit", sikundër i përmend Bajroni në veprën "Don Zhuan" e që, zakonisht, vendosen nën filxhanët e vegjël të kafesë; ato janë gjithmonë të prodhimit shqiptar. Prizreni është i famshëm për qilimat e tij, por veç anërisht për prodhimin e kobureve të mrekullueshme të veshura me argjend dhe për jataganët e zbukuruar me rrahje e me dorezë të stolisur me gurë të çmuar, të cilët shkëlqejnë në brezin e çdo shqiptari të pasur. Ndërsa Shkodra është e njohur në artin e endësve dhe për finesën e qën-

disjeve me fije ari”<sup>14</sup>.

Nga vlera të tilla artistike u entuziazhua edhe Edit Durhami kur udhëtoi në Shqipëri. Siç ka shkruar në një letër dërguar një miku të saj në Londër, ajo erdhi për të vizatuar pamje nga këto anë<sup>15</sup>, por kur zbriti në Shqipëri pa se ndodhej midis një krijimtarie të pasur popullore, që e bëri ta ndërrojë itinerarin e udhëtimit. Si mbërriti në Shkodër, më 1901, ajo shkroi: “Shkodra më bëri përshtypje menjëherë. Kishte ngjyrë, jetë, art” Ndërsa kur u fut më në thellësi, vuri re se larmia e krijimeve popullore ishte më e madhe. Duke përshkruar veshjet e zonës së Shkrelit, ajo vë në dukje se “shumica e banorëve mbanin armë shumë të bukura, të veshura me argjend, në brez kishin për zbukurim rrumbuj të mëdhenj prej argjendi. Shamitë e kokës të bardha si bora, që shkëlqenin në diell, xhamadanët e kuq e të artë dhe jelekët, xhurdia e shkurtër e zezë dhe gajtanët e bukur të zinj të tirqeve, si dhe zinxhiri i madh i orës prej argjendi, që lëshoheshin të lirë e të zbukuruar me gurë artificiale, të cilët u pëlqejnë shumë malësorëve, i bënë figurat thatanike e të buta të dukeshin madhështore”<sup>16</sup>.

Edit Durham, një nga mbrojtëset më të shquara të çështjes shqiptare në fillim të shekullit tonë, ka pohuar prejardhjen ilire dhe karakterin origjinal të kulturës sonë tradicionale. Është publiciste e njohur e autore e disa librave edhe për Shqipërinë, por këtu do ndalemi në krijimtarinë e saj si piktores. Disa nga

*Një nga vizatimet  
e E. Durhamit.*






E. Durham me veshje shkodrane, fotografuar nga Marubi më 1901.

botimet e saj, si *Shqipëria e epërme* (1909, ribotim më 1985), *Mbi origjinën e disa fiseve. Kanune dhe zakone të vendeve të Ballkanit* (1920), *Lufta për Shkodrën* (1914), ajo i pajisi me vizatime të vetat, por akuarelet e shumta, si dhe mjaft vizatime, skica e grafika me pamje nga vendi ynë mori në Londër. Në vitin 1972 studiuesi Xhevat Lloshi ka bërë kërkime në arkivin e Institutit Antropologjik Mbretëror të Londrës. Sipas përshkrimit të tij, po paraqesim përmbledhtas pasurinë me shumë interes për kulturën tonë që përmbajnë këto materiale.

Dorëshkrimi me titull "Blokun e shënimeve të mija nga Ballkani" (My Balkan Notebook, 1900-1914) me shifrën MS 41 përbëhet nga 3 vëllime. Vëllimi I përveç fotove ka edhe 8 vizatime për banesa të Mirditës e të Shkodrës, si dhe pamje të brendshme. Vëllimi II që merret me simbolikën e diellit e të hënës përmban veç fotove edhe 13 vizatime për orenditë shtëpiake e gurët e varreve në Shqipërinë e Veriut. Vëllimi III që u kushtohet fiseve, kostumeve, ndërtesave etj, veç fotove përmban edhe 65 vizatime të larmishme nga Durrësi, Apolonia, Shpati, Berati, Elbasani, Tirana e Shqipëria e Veriut, ku paraqiten kështjella, manastire, xhami, kisha, rrugë, banesa, burra e gra me veshjet karakteristike etj. Dorëshkrimi me shifrën MS 47 përbëhet nga 8 fletore. Në fletoren e parë (1908, Shqipëria e Veriut) ka pak vizatime me gra që luten në kishë dhe me kostumin e dikurshëm të priftërinjve. Dorëshkrimi me shifrën MS 48 nuk ka vizatime e skica. Dorëshkrimi me shifrën MS 50 ka 4 vizatime akuareli: një kositës në Shkodër (1910), një bari në Sheldi (1910), një cinar dhe dëborë në Cukal (1912). Dorëshkrimet e tjera (MS 44, 45, 33, 55 dhe 58) nuk kanë vizatime, me përjashtim të një skice me ngjyra të helmetës dhe të emblemës së Skënderbeut në MS 45. Ndërkëq, studiuesi anglez Uiliam Bland pati mirësinë të na dërgonte fotokopje dhe diapozitiva; fotografi të akuareleve me pamje nga natyra e vendit tonë, me skena nga jeta në qytete e në fshatra, figura me kostume kombëtare, një numër të madh vizatimesh të ornamentikës popullore dhe pamje të tjera me interes. Nga riprodhimet që na ka dërguar e që, sigurisht, janë vetëm një pjesë e vogël e krijimeve të Durhamit, vihet re përkushtimi i saj kulturës popullore shqiptare. Në arkivin e In-

Një nga tablotë për Greqinë,  
e piktorit P. Viltes,  
ku janë pikturuar edhe  
shqiptarë me veshje  
kombëtare.



stitutit Antropologjik të Londrës ndodhet edhe një fotografi e Durhamit me kostum popullor shqiptar, bërë nga Marubi në Shkodër në vitin 1909. Aty ruhen edhe shumë dokumente të tjera që tregojnë lidhjet e studiueses të shquar me Shqipërinë.

Nga rreth 100 akuarele, grafika e vizatime që bëri çifti anglez Kora e Xhon Gordon më 1925 në Shqipëri, pjesa më e madhe paraqesin portrete dhe figura shqiptarësh nga krahina të ndryshme të vendit, mjedise karakteristike e ndërtime dhe objekte të tjera me veçori kombëtare. Idenë e larmisë së kostumeve ato e shprehin duke dhënë figura të moshave e krahinave të ndryshme. Ata botuan edhe një libër me shënime udhëtimit<sup>17</sup>.

Edhe në libra të tjerë për Shqipërinë janë botuar gravura me figura me veshje kombëtare. Disa janë realizuar nga autorë të njohur, si Pjer Fritel, A. Bonamore, Irton., ndërsa nëpër muze të ndryshme ka disa vepra më këtë motiv, si: *Fshatarë shqiptarë*, akuarel nga Charl Gler (Muzeu i Artit, Boston), *Grua shqiptare*, nga Teodor Alinji (Muzeu i Artit, Marsejë), *Ushtar shqiptar*, nga Dominik Magré (Muzeu i Luvrit, Paris), etj.

Kostume kombëtare tonat janë pikturuar edhe në shumë vepra me temë nga vende të tjera, në të cilat paraqiten edhe figura shqiptarësh. Për dy tablo me përmasa të mëdha (273x416 cm dhe 250x410 cm) të piktorit Peter von Hes me temë nga Gre-



*Tabloja e piktorit  
R. Bonington.*

qia në një botim anglez është shkruar se në ato vepra të mrekullueshme paraqiten “malësorë dhe banorë të ishujve grekë dhe shqiptarë me kostumet e tyre aq piktoreske e të larmishme”<sup>18</sup>. Të dyja tablotë ndodhen në Muni. Nëpërmjet riprodhimeve në një botim me vepra të autorëve të huaj për Greqinë, vihet re përshkrimi i saktë: kostumet shqiptare dhe greke janë dhënë me vlera piktorike, gjithashtu në shumë e shumë tablo të tjera me motive greke ka figura shqiptarësh me kostum kombëtar. Këtë e vërteton edhe studiuesi i njohur francez Zhak Lakarier, i cili, në parathënien e librit “Greqia e rizbuluar” (Paris 1983), shkruan se në tablotë me motive greke shpesh ka dhe figura shqiptarësh me veshje të tyre kombëtare<sup>19</sup>. Disa piktorë, si Xhovani Boxhi, Adam Freder fon Fridelsburg, Ludwig Vogël, kanë realizuar seri portretesh të heronjve të Revolucionit grek, ku, siç dihet, u shquan edhe shqiptarë, si Boçari, Bubulina, Miauli, Karaiskaqi etj. Në veprat e këtyre autorëve janë përjetësuar disa figura shqiptarësh me veshje kombëtare. Kështu, A.F. Fridelsburgu ka pikturuar një portret të bukur të Bubulinës në litografi me ngjyra dhe shqiptarësh të tjerë, që i përmblodhi në albumin e tij të botuar në Londër më 1825-1827<sup>20</sup>.

Figura të tilla të shquara luftëtarësh shqiptarë pikturoi nga natyra dhe i botoi në një album të veçantë në Paris edhe Xh. Boxhi<sup>21</sup>. Ndërsa zvicerani L. Vogël realizoi më 1832 një tablo të madhe mbi Revolucionin grek, ku dha edhe disa figura shqiptarësh. Në një revistë të vitit 1944 është vënë në dukje se... djali i Marko Bocarit, që piktori e takoi dhe e vizatoi në Muni më 1830, është një nga personazhet e kësaj tabloje”<sup>22</sup>.

Në vitet 1826-1838, në Sallonet a Parisit dhe në ekspozita të tjera, për t’i bërë jehonë Revolucionit grek, u bë si e modës që çdo piktor të realizonte një tablo me motive të tij. Kështu, më 1826, në Galerinë Lebrun në Paris u ekspozuan 176 tablo me motive nga ky revolucion. Në Sallonin e vitit 1827 vetëm Delakrua paraqiti 12 tablo të tilla, midis të cilave edhe një figurë burri me kostum suljot. Gati në të gjitha këto veprimtari ka





patur vepra që paraqesin shqiptarë me kostum kombëtar. Mirëpo meqë Greqia në ato vite ngjalli jehonë të madhe me revolucionin çlirimtar, figurat e shqiptarëve që u paraqitën në to quheshin luftëtarë grekë. Pa bërë ndonjë hulumtim apo studim të plotë për Sallonet e Parisit apo për ekspozitën a Galerisë Lebrun të vitit 1827, mund ta argumentojmë këtë vetëm me dy vepra të riprodhuara në një botim mbi Greqinë, ku thuhet se piktori i njohur anglez Riçard Bonington paraqiti në Galerinë Lebrun figurën e një burri me kostum kombëtar. Tabloja është titulluar *Portreti i një djaloshi grek*. Por si është realizuar kjo vepër? Po në të njëjtin botim thuhet se Boningtoni nuk ka qenë kurrë në Greqi, por është frymëzuar nga kostumet e mikut të Delakruasë, Robert Ogyst. Shkruhet edhe se tabloja e Boningtonit evokon tablonë *Konti Palatiano* të Delakruasë dhe për një kohë të gjatë është quajtur si vepër e këtij të fundit. Dihet se vetë Delakrua e titullon tablonë e tij *Konti Palatiano me kostum suliot* dhe se e realizoi me veshje shqiptare, që ia solli Robert Ogysti; pra, i njëjti kostum që mori edhe Boningtoni. Atëherë kjo vepër a nuk mund të quhet më saktë *Një djalosh me kostum shqiptar*? I njëjti kostum është pikturuar edhe në një tablo të piktorit A. Kolë, Edhe ky nuk ka qenë në Greqi, pra veprën e tij e ka realizuar nën ndikimin e krijimeve të Delakruasë dhe të Boningtonit, me të cilët ka qenë mik dhe i ka përjetësuar në dy portrete. Ai ka ilustruar “Cajld Haroldin”, ku, siç e kemi përmendur, flitet edhe për kostumin shqiptar. Dy tablotë na japin mundësinë të gjykojmë se në Sallonet e Parisit dhe në Galerinë Lebrun, me siguri “au profit des grecs”,<sup>23</sup> janë paraqitur personazhe shqiptarësh. Tablo me figura shqiptarësh janë realizuar gjithashtu nga piktorë të vendeve të tjera që, me krijimet e tyre, i bënë jehonë Revolucionit grek.

Vepra të tilla, ku gjejmë personazhe shqiptare me kostume kombëtare, u paraqitën edhe në ekspozitën “Ringjallja greke dhe miqtë italinë të Greqisë”, të cilën e përmendëm.

- 1) "Explication des cets estampes qui representent différentes nations du Levant", Paris, Collombat, 1715.
- 2) Një kartolinë me këtë tablo është botuar vitet e fundit edhe nga galeria njohur "Tretjakov" e Moskës, pronë e së ciles është edhe vepra.
- 3) Joseph Cartwright, "Wiews of the Ionian Island", London 1821.
- 4) Disa vepra të këtij autori janë riprodhuar në revistën "Hesperia", 54.2 (1985), dhe në librin "Storia delle letterature del Sud – Est Europa", Milano, 1970.
- 5) N. Kallaimer, "Of Suliots, Arnauts, Albanians and E. Delacroix" "The Burlington Magazine", London, 1983.
- 6) Filippo Delpino, "Vestiaro ed usi della corte, governo, leggee culto, milizia e comuni turchi".
- 7) «Costumes et usages des peuples de la Grèce moderne» par le baron O. M. Stackelberg. Paris 1835.
- 8) Michel le Bris, "Journal de romantisme", f. 165. Paris, 1981.
- 9) René Hughe, "Delacroix ou le combat solitaire", f. 134. Paris, 1962 "Le néo – classicisme francais", f. 21-22. Paris, 1974, etj.
- 10) L.E. Johnson, "Two sources of Oriental Motifs copied by Delacroix" Gazette des Beaux – Arts, 65, VI (1965), f. 163-67. Cituar sipas revistës "The Burlington Magazine", f. 47 London, 1983.
- 11) Në librin "Lettres sur le Morée et les iles de Cerigo, Hydra et Zante", vol. 1, Paris, 1808, f. 96.
- 12) A.D. Dodwell, "A Classical and Topographical Tour through Greece, During the Years 1801, 1805 and 1806", vol. 2, London, 1819 f. 134.
- 13) "Rilindja Shyqyri Nimani, *Kombëtarja si frymëzim piktural*, 31 dhjetor, Prishtinë, 1984.
- 14) Athol Mayhew, "In Albania with the Ghegs". Scribner's Monthly, vol. XXI. New York, 1881.
- 15) Cituar sipas studimit "Edith Durhami dhe shqiptarët" të studiuesit kosovar Shaqir Shaqiri. Botuar në "Nëntori", nr. 10, Tiranë, 1981, f. 148.
- 16) Edith Durham, "Twenty years of Balkan tangle", London, 1920.
- 17) Jan and Cora Gordon, "Two vagabonds in Albania" London, 1927.
- 18) G. Finley, "A History of Greece from its conquest by the Romans to the Present Time", vol. VII, London, 1857, f. 104.
- 19) F.M. Tsikagon, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984, f. 8.
- 20) "Twenty-four portraits... of the principal leaders... in the Greek Revolution", London, 1927.
- 21) Collection de portraits des personnages turcs et grecs les plus renommées soit par leur cruauté, soit par leur bravoure dans la guerre actuelle de la Grèce, dessinés d' après nature par Boggi. Paris, 1826-1829.
- 22) Neue Züricher Zeitung, 14.1.1944. Cituar sipas librit "La Grèce retrouvée", Paris, 1984, f. 196.
- 23) Në fitim të grekëve.

## "Një vend i mrekullueshëm për artistët"

"Shqipëria është një vend i mrekullueshëm për artistët. Kostumet e saj janë shumë piktoreske dhe shpesh kam vrarë mendjen sesi asnjë piktor anglez s'ka marrë mundimin të bëjë një udhëtim në këtë vend. Megjithatë, vitin që shkoi zoti J. F. Ljuiz, fama e të cilit si akwarelist është mjaft e njohur, depërtoi në brendi të shqipërisë..."<sup>1</sup>.

Shënimi i sipërm, i botuar në një libër të vitit 1842, jep një informim për vepra që mund të ketë realizuar në vendin tonë piktori i njohur anglez J. F. Ljuiz, por thënia e tij se asnjë piktor anglez nuk ka ardhur në Shqipëri nuk është e saktë. Siç duket, autori



C. Kokrell:  
"Viroi, Gjirokastër".

i librit nuk është njohur as me krijimet e bashkatdhetarëve të vet. Që në vitin 1813 piktori dhe arkitekti i njohur Carl Kokrell vizitoi vendin tonë dhe pikturoi disa peizazhe. Ai fiksoi pamje të bukura nga Përmeti dhe një peizazh nga Viroi në Gjirokastër, ku paraqet ujin që buron nga liqeni. Por një nga krijimet më të rëndësishme, ndoshta më i miri për nga vlerat artistike, është *Pamje nga Berati*, një tablo tërheqëse, çdo pjesë të së cilës e ka "qëndisur" me ëndje, duke pasqyruar mjedisin karakteristik të qytetit<sup>2</sup>.



H. Uiliams:  
"Bregdeti i Vlorës".

Siç e ka pohuar edhe vetë, me ndihmën dhe nxitjen e Kokrellit, realizoi peizazhe të bukura edhe piktori tjetër anglez H. Uiliams. Po me ndihmën e Kokrellit ai botoi një album dyvëllimësh me përmasa të mëdha, ku përmblodhi edhe pesë peizazhe nga Shqipëria<sup>3</sup>. Ato janë pamje nga bregdeti, prej Vlorës deri në Himarë. Të gjitha peizazhet e Uiliamsit përshkohen nga fryma romantike, sidomos në paraqitjen e mjedisit natyror. Thuhet në çdo tablo shihen dallgë të trazuara, pemë që lëkundën nga era, male të larta, që herë janë të mbuluara me re në prag të stuhisë e herë me një mjegull të lehtë, si një vello e tejdukshme. Gravurat e Uiliamsit janë të shoqëruara me vargje nga Bajroni apo nga shkrimtarë klasikë grekë e latinë, si Homeri, Horaci, Eskili, Virgjili, Klaudiani etj. Siç ka vënë në dukje një nga studiuesit tanë, Uiliamsi ka meritë jo vetëm për veprat me pamje të bukura që ka krijuar, por edhe për punën hulumtuese, pasi ka gjurmuar vargje nga shkrimtarët e vjetër greko – romakë që bëjnë fjalë për lashtësinë e shqiptarëve<sup>4</sup>.

Edhe në peizazhet e autorëve romantikë e të mëvonshëm vihet re i njëjti frymëzim dhe e njëjta mbresë e fortë që ngjall bukuria e natyrës shqiptare. *Himara* e piktorit Th. Veber është tablo tërheqëse. Tek ajo ndihet transparenca e horizontit bregdetar. Për vetë specifikën e tij, peizazhi është nga ato gjini të artit që s'mund të realizohet nga mbresat apo nga përshkrimet e ndonjë tjetri, ashtu siç janë bërë e bëhen tablo e gravura, madje edhe portrete. Sa për natyrën shqiptare, shumë autorë të huaj, kur kanë rënë në kontakt me të, janë befasuar. "Vështirë se do të gjendej një vend vetëm nëntë ditë larg Parisit që të jetë kaq piktoresk sa Shqipëria, – shkruhet pranë gravurave të piktorit

JOURNALS  
OF A  
LANDSCAPE PAINTER

ALBANIA, &c.

BY EDWARD LEAR.

LONDON:  
RICHARD BENTLEY,  
Publisher in Ordinary to Her Majesty.  
M.D.CCC.LI.

Kopertina e botimit të  
parë të librit të Lirit.

Udvil në një botim të vitit 1881 – Për artistin është një vend mbi gjithë të tjerat. Peizazhi i valëzuar i Veriut malor është më i ndryshueshëm se njerëzit, sepse natyra, nën ajrin e rrallë të malësisë, është e ndryshueshme si kameleoni: tani plot ngjyra me dritat e ylberta të agimit, pastaj nën një rrezatim të bardhë e blu, nën diellin e fortë të mesditës dhe shpejt e mbështjellë me mantelin vjollcë të natës. Dhe koha që shkon e vjen mund t'i tregojë malet e liqenet nën një mijë pamjetë ndryshme...<sup>5</sup>.

I mahnitur nga pamjet që përshkruhen më sipër, piktori gjerman Herman Urban realizoi disa peizazhe, të cilat i ekspozoi më 1900 në Munih nën titullin *Peizazhe nga Shqipëria*. Siç u shënuar edhe në njoftimin për ekspozitën, H. Urbani i ka trajtuar punimet me delikatesë dhe dekorativitet, megjithëse në to bie në sy monumentaliteti i maleve shqiptare<sup>6</sup>.

Me madhësi dhe bukuri malet shqiptare janë paraqitur në gravurën e K. Udvilit *Roja kufitare*. Figura e luftëtarit me pushkën e gjatë, pranë një shkëmbi, duket sikur merr jehonë nga malet e larta që ngrihen gjer në re. Kjo të kujton përshkrimin e Naim Frashërit, poetit tonë kombëtar:

*O malet e Shqipërisë, që mbani kryet përperjetë,  
Tmerr e frikë përhapni, përpini qiejt' e retë!  
Të patundur për jetë jini, pa kur oshëtini  
Udhëtarit në zemër frikë të madhe i vini<sup>7</sup>.*

Po në këtë këndvështrim është paraqitur peizazhi shqiptar edhe në grafikën *Rrugës për në Shkodër*, të piktorit francez Teodor Valerio. Shkëmbinjtë këtu janë vizatuar nga poshtë, për t'u paraqitur më madhështorë. Edhe ndriçimi natyror nxjerr në dukje siluetën e shkëmbit në hije, që bën kontrast me qiellin e pastër. Pra, nuk mund të quhet rastësi që tre piktorë nga tri vende të ndryshme – H. Urban me ekspozitë të vecantë, K. Udvil me *Rojen kufitare*, T. Valerio me *Rrugës për në Shkodër* – ta trajtojnë me të njëjtin këndvështrim peizazhin tonë. Vërtet ata janë frymëzuar nga ndjenja epike që të ngjallin malet shqiptare, por më shumë se një "paraqitje objektivist", ata dhanë një paraqitje simbolike të qëndresës shqiptare në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të cilën e ndien dhe e panë edhe vetë gjatë udhëtimit nëpër vendin tonë.




E. Lir: Mure të pamatura akroeraune. Bregdeti i Shqipërisë.

Pamje epike të natyrës shqiptare janë pasqyruar edhe në tri nga peizazhet më të bukura të autorit anglez Eduard Lir. Në litografinë *Himara* ai ka fiksuar një pamje që të frymëzon: last nga perëndimi i diellit në horizont. Silueta e bregdetit të Himarës të krijon përshtypjen e një kështjelle gjigante, ndërsa shtëpitë me dritëhije të ngjallin përfytyrimin e bedenave. Figura e ulur në plan të parë me veshje kombëtare duket sikur sodit vetëm perëndimin e diellit mbi det, ndërsa shikuesi i peizazhit sodit me endje gjithë natyrën: shkëmbinjte, qiellin, detin me reflekset e diellit dhe figurën e ulur. *Mure të pamatura akroeraune: Bregdeti i Shqipërisë* është një peizazh tjetër i Lirit, që paraqet bregdetin shqiptar, por me këndvështrim tjetër, me pamje nga deti. Mbi vijën horizontale të detit ngrihen si dallgë madhështore male të larta, që japin pamjen e një muri të madh shkëmbor. Efekti i rrezeve të diellit në perëndim dhe kontrasti që krijojnë linjat e zhdërvjellta të maleve me vijën e drejtë horizontale të detit, i japin tablosë originalitet dhe freski.

Ndërsa peizazhi me pamjen më madhështore në tërë krijimtarinë e Eduard Lirit është *Mali i Tomorit, Shqipëri*. Tomori është në sfond me ngjyra blu të thellësive të horizontit, ndërsa

*Mali i Tomorrit  
(me grafikën V).*



në plan të parë shfaqen rrjedha e lumit, shkëmbinj e pemë të larta, burra, gra e fëmijë të veshur me kostume kombëtare. Kompozimi në formën e shkronjës V, formuar nga qafa e malit, e bën shikuesin ta drejtojë vështrimin thellë në horizont, ku janë vizatuar me imtësi brigje, gërxhe, pemë e lugina të bukura. Një skemë të tillë kompozicionale pas *Malit të Tomorit*, sic është vërejtur nga studiues të huaj, Liri e përsëriti edhe në disa krijime me temë nga vende të tjera të Lindjes. Pikturimi në këtë tablo i figurave me veshje kombëtare (për të cilat pozoi shqiptari Gjergj Kokalli me kostumet që u morën në Shqipëri) mendojmë se është bërë për të shtuar ngjyrat lokale, si dhe për të vënë në dukje kontrastin midis nuancave të ndezura të kostumeve me ato të gjelbërimit të pemëve dhe toneve të kaltra të horizontit, duke theksuar tipare sublime të peizazhit. Një mjedis i tillë, i pikturuar me realizëm deri në hollësi të vogla, bën që vizitorit ti ngjallet përfytyrimi për vitet e kryengritjeve popullore shqiptare kundër Tanzimatit, që vazhdonin edhe në vitet kur kaloi Liri, më 1848, e kur çetat e Gjolekës e të Rrapo Hekalit me shokë, të cilat, siç u ka kënduar populli, luftonin "jo për mua e për ti, po për gjithë Shqipëri".

Punën për pikturën *Mali i Tomorit* Liri e filloi pas kthimit të tij në Angli, më 1849. Pamja e kësaj tabloje është fiksuar

gjatë udhëtimit nga Elbasani për në Tiranë. Në ditarin e tij Liri shkruan se u nisën herët, në orën gjashtë të mëngjesit. Pjesa më e madhe e rrugës kalonte nëpër luginën e një përroi, degë e Shkumbinit. "E kapërcyem nja tridhje të herë, sa, më në fund, fillojmë ngjitjen në një kodër të zhveshur, pastaj në një faqe mali të lartë, i cili ndan territorin e Elbasanit nga ai i Tiranës... Ç' pamje madhështore duket nga maja e malit! Vështrimi endet nëpër luginën dhe mbi përroin që gjarpëron deri në vijën e horizontit, – një skenë që i bën realitet trilleve më të dashura të imagjinatës së artistit"<sup>8</sup>. Dhe në vepër ky frymëzim ndihet qartë.

Një akuaarel me të njejtën pamje, i titulluar *Qafa e Tiranës, Shqipëri*, Liri e përfundoi më 1851. Por takimi me piktorin e njohur anglez Holman Hunt<sup>9</sup> më 1852, siç ka vërejtur një studiues i veprës së Lirit, mund të ketë qenë shkaku që ai e braktisi këtë punim, pasi peizazhi anglez nuk mund të kishte një pamje të njejtë për ta pikturuar drejtpërdrejt në natyrë<sup>10</sup>. Vepra mbeti për disa vjet në studio, e papërfunduar. Më 1872 ai vendosi ta ripunonte. Dhe e përfundoi brenda një kohe të shkurtër.

*Mali i Tomorit* është një nga pesë tablotë më të mëdha, me ngjyra vaji, që ai ekspozoi në galerinë e re Vila Emili. Edhe në ekspozitën e madhe retrospektive që u organizua më 1985 nga Akademia e Arteve në Londër, ajo u vlerësua si një nga të paktat tablo me ngjyra vaji me përmasa të mëdha e nga më



Vila Emili në San Remo,  
ku u ekspozuan tablotë e  
E. Lirit me temë shqiptare.





Selvitë në Elbasan.

të bukurat e gjithë krijimtarisë së tij që u grumbullua për atë veprimtari<sup>11</sup>.

Por pamje nga peizazhi ynë janë fiksuar edhe në dhjetëra akuarele, litografi e vizatime të Lirit. Në krijimet e tij shihet prirja për të pasqyruar vendet karakteristike, si dhe dëshira për të fiksuar pamjet që e kanë tërhequr shumë, siç ka shkruar në librin e tij *"Ditari i një piktori peizazhist në Shqipëri"*. Mbresa të mëdha nga gjithë udhëtimi Lirit i la Berati. Lidhur me këtë, më 14 tetor 1848, ai shkruante: "Më në fund arritëm në Berat, një qytet shumë piktoresk, i cili i kaloi parashikimet e mia". Për Beratin Liri kishte lexuar që para se të nisej për udhëtim. Ai e kishte zakon që para se të vizitonte një vend, studionte çdo material që mund t'i jepte informacion për natyrën fizike dhe historikun e tij<sup>12</sup>. Për Shqipërinë ai kishte lexuar Likun<sup>13</sup>, Hjuzin<sup>14</sup> dhe vepra udhëtarësh të tjerë, ndërsa për Beratin kishte parë edhe peizazhin e Çarl Kokrellit, një nga punimet më të shquara të autorëve të huaj për këtë qytet, realizuar 25 vjet para udhëtimit të tij. "Fillova të vizatoj menjëherë, – shkruan ai, – pasi nuk ka kohë për të humbur në këtë vend kaq interesant". E gjatë katër ditëve ai bëri dhjetëra vizatime. Ndërsa kur u largua shkroi: "Po largohem nga Berati dhe nuk mund t'ju fsheh keqardhjen që po lë prapa një pamje kaq madhështore. Një artist mund të shkojë lehtë në çdo kohë të jetës së tij për të parë Romën, Konstandinopojën, Jerusalemin, por Beratin dhe Ilirinë nuk mund t'i vizitojë lehtë"<sup>15</sup>. Krahasimi me qytete të tjera të njohura të botës dëshmon njëkohësisht edhe admirimin që artisti i shquar pati për arkitekturën e përsëritshme të Beratit tonë.

Nga vizatimet e shumta Liri realizoi disa akuarele e litografi për Beratin, si dhe mbi njëqind të tjera me pamje nga Shkodra, Kruja, Tirana, Elbasani, Durrësi, Vlora, Tepelena, Gjirokastra etj. Litografitë dhe akuarelet e tij janë vepra të krijuara me ndjenjë dhe të realizuara me shije të hollë. Me ndonjë përjashtim, ato shquhen nga saktësia e vizatimit, karakteristike edhe për krijimet e tjera të tij me temë nga Greqia, India etj. Linja e hollë e kontureve në akuarelet e tij është në harmoni me transparencën e ngjyrave. Peizazhet janë gjithnjë me figura njerëzish.




E. Lir: " Rrap i vjetër në Tepelenë".

Përveç ekspozitës së H. Urbanit më 1900, bukuritë e peizazhit shqiptar u bënë objekt edhe për ekspozita të tjera nga autorë të huaj. Në dhjetor të vitit 1917, në Universitetin e Vjenës u ekspozuan disa peizazhe shqiptare të autorëve austriakë Fanrih dhe L. Forstner. Punimet nga Shqipëria u vendosën në një pavion midis eksponateve të shumta etnografike dhe arkeologjike të vendeve ballkanike. Ekspozita qëndroi e hapur deri më 20 janar 1918 dhe peizazhet u vlerësuan si pasqyrim i bukur i pamjeve nga Shqipëria<sup>16</sup>.

Më 1918 në Shkodër u hap një ekspozitë me punime të tre piktorëve austro – hungarezë: Horovits, Pravotincki dhe Bescedes, në të cilën si më të realizuarat u çmuan peizazhet. Në portretet, siç u vërejt edhe në një shkrim për ekspozitën, nuk u arrit të jepet qartë karakteri i shqiptarit, që ndryshon nga ai ku nën freskinë e ajrit shquhen objekte të ndriçuara nga dielli. Prirja për një punim të tillë e miqësoi atë edhe me piktorin tonë të shquar Vangjush Mio, me të cilin punuan disa tablo me pamje nga Korça e Pogradeci.

Piktori dhe skulptori gjerman Karl Blohm, me peizazhet dhe portretet që realizoi gjatë vitit 1934, përgatiti një ekspozitë




L. Hesaimer: "Monument kulture, Tiranë".

vetjake për ta hapur në Tiranë, por që nuk e realizoi. Një pjesë të punimeve i mori në vendin e tij, ndërsa pjesën tjetër, siç njofton një gazetë e kohës, e dërgoi në një panair në Bari të Italisë<sup>21</sup>. Nuk dihet nëse tablotë dhe akuarelet u kthyen nga Bari, por punimet që mori në Gjermani i ekspozoi në Karlsruhe, Itzohe dhe në qytete të tjera. Në të dy katalogët e ekspozitave i popujve të tjerë të Ballkanit<sup>17</sup>. Pjesa më e madhe e peizazheve janë të karakterit impresionist, realizuar vetëm nga një vështrim i natyrës, "de premier coup", sic thuhej atëherë në gjuhën e piktorëve. Me mbylljen e ekspozitës autorët i morën punimet në vendin e tyre.

Më 1930, piktori italian Vincenzo Çardo (Vincenzo Ciardo), që kishte udhëtuar në vendin tonë gjatë vitit 1929, hapi në Romë një ekspozitë me tridhjetë peizazhe nga Shqipëria. Në pesëmbëdhjetë ekspozitat që organizoi sa ishte gjallë, u shpreh mendimi se peizazhet nga natyra shqiptare i kishte autentike. Siç shkruhet edhe në një studim për veprën e tij<sup>18</sup>, natyra shqiptare e frymëzoi për të shkruar edhe artikujt "Një fushatë e shkurtër piktorike në Shqipëri" dhe "Klima piktorike Shqipërisë"<sup>19</sup>, të cilët i botoi në shtypin e kohës. Bashkatdhetari i Çardos, piktori Xhorxho Oprandi (Giorgio Oprandi) organizoi në Romë një veprimtari tjetër të këtij lloji, më të pasur në vepra dhe në vlera artistike. Në të ai ekspozoi pamje nga Shkodra, Tirana e Gjirokastra, nga Llogaraja e Himara, nga Maliqi dhe malet rrëzë Prespës. I dashuruar pas natyrës shqiptare, ai realizoi tablotë *Brigjet e Erzenit*, *Pranë Shkumbinit*, *Mali i Tomorit* etj. Pas ekspozitës u botua edhe broshura me riprodhime "*Shqipëria në tablotë e Xh. Oprandit*" ("L' Albania nei quadri di G. Oprandi"). Nga tablotë botuara në të njihemi edhe me vlerat artistike të piktorit. Siç shkruan shtypi i kohës, në veprat me motive shqiptare Oprandi tregoi një shkallë të re të artit të tij, pasi edhe vite më parë ai kishte organizuar ekspozita me temë nga vende të tjera<sup>20</sup>. Pas tablove me motive nga Italia, ai paraqitet më me mjeshtëri në portrete e peizazhe të reja, që ndonëse të qeta në dukje, të bëjnë për vete me natyrshmërinë dhe qartësinë. Në peizazhet e tij ndien një frymëmarrje të plotë, pasi në përgjithësi ai i ndërton ato në plan të gjerë, me perspektivë në horizont,

të tij janë shënuar disa tituj të peizazheve nga Shqipëria, që qëndrojnë midis punimeve të tjera me motive nga Parisi, nga qytete të Gjermanisë, si dhe nga ndonjë vend tjetër ku piktori vajti për të realizuar vepra<sup>22</sup>. Siç na ka njoftuar R. Pier (nga Gjermania), në Hamburg jeton ende e veja e piktorit, e cila ruan rreth 100 skica, akuarele e vizatime të të shoqit me motive nga Shqipëria.



Peizazh nga Shkodra.

Veç ekspozitave, janë realizuar edhe peizazhe të veçanta nga autorë të ndryshëm që kanë vizituar vendin tonë. Piktori vjenez Z. Hesaimer, autori i gravurës *Shqiptari*, që përmendëm, ka pikturuar disa pamje të bukura, si: *Brigjeve të Drinit*, *Selvitë në Elbasan*, *Monument Kulture në Tiranë* etj. Siç kujton prof. Aleks Buda, disa nga peizazhet që kishte punuar në vendin tonë, L. Hesaimer i paraqiti në ditët e kulturës shqiptare që organizuan studentët shqiptarë në Vjenë më 1936. Në tablone *Selvitë në Elbasan* piktori ruante si të paharruara netët e bukura verore në atë qytet, ku yjet shndritnin me një shkëlqim të veçantë<sup>23</sup>. Në vitin 1925 ai kishte hapur një ekspozitë të vogël në Salzburg me këto motive.

Shumë peizazhe në grafikë janë realizuar edhe nga piktorë të tjerë, si G. G. Sarzheni, Irtoni, F. Robida, L. Mane etj., të

cilat janë botuar në revista të ilustruara, në libra me shënime udhëtimi në vende të Ballkanit, si dhe në libra të posacëm për Shqipërinë. Litografia me pamje nga Butrinti (1855) e piktorit anglez P. Beresford, akuareli nga Apolonia (1924) i piktorit francez E. Grand dhe pastelet e akuarelet nga Shqipëria e Veriut (1927) të çiftit anglez Kora e Xhon Gordon janë disa nga riprodhimet me ngjyra që u botuan në shtypin e huaj. Në fondin e Galerisë së Arteve në Tiranë ruhen edhe disa vepra me pamje nga natyra jonë, të pikturuara nga autorë të huaj.

- 1) J. J. Best, "Excursions in Albania", London, 1842, f. 200.
- 2) Th. S. Hughes, "Voyage à Janina en Albanie, par la Sicilie et la Grèce", Paris, 1821.
- 3) British Painting, tab. 64, London, 1976.
- 4) "Drita". R. Kadia, "Me vargje të artistëve të shquar të lashtësisë", Tiranë, 1987, f. 12.
- 5) A. Mayhew, "In Albania with the Ghegs" Scribner's Monthly, vol. XXI, New York, 1881, f. 379.
- 6) "Le paysage Albanais a une exposition d'art à Munich", Albania, f. 79. Bruxelles, 1900.
- 7) N. Frashëri, "Bagëti e Bujqësia", Tiranë, 1978, f. 71.
- 8) "Journal of a landscape painter in Albania", London, 1851.
- 9) Holman Hunt, piktor anglez (1827 – 1910). Veprat të tij ruhen në disa muze të Londrës, kurse të tjera jashtë Anglisë. Ka pasur miqësi me Lirin, tek i cili ndikoi në krijimtarinë artistike dhe i ka bërë një nga portretet më të bukura, që ruhet në Galerinë Kombëtare të Portreteve në Londër.
- 10) "Edward Lear, 1812 – 1888", London, 1985, f. 142.
- 11) "Art and Design", nr 4, London, 1985, f. 15.
- 12) "A Leaf from the Journal of Landscape Painter", Macmillan Magasine, London, april 1897. Cituar nga "Edward Lear", London, 1985.
- 13) W. M. Leake, "Travels in Northern Greece", London, 1835.
- 14) Th. S. Hughes, vep. cit.
- 15) Edward Lear, "Journal of a Landscape Painter in Albania", London, 1851.
- 16) "Ekspozicion ballkanik n' Universitet të Vienës", "Posta e Shqypnies", nr 11, Shkodër, 1918.
- 17) "Ekspozicion pikturash në Shkodër", "Posta e Shqypnies", nr 40, Shkodër, 1918.
- 18) A. Cassiana, "Vincenzo Ciardo", Puglia, 1979, f. 7.
- 19) Artikujt janë botuar në "Japigia", më 1931, dhe në "Meridiano di Roma", më 20.1.1940.
- 20) G. Banti, "Il pittore Giorgio Oprandi", Roma, 1942.
- 21) "Besa", Piktura për qoshkun e KTAM – it në Panairin e Barit, 22 Ogusht 1934, Tiranë.
- 22) Sipas dy katalogëve të ekspozitave të karl Blohmit në Itzohe, Gjermani.
- 23) Sipas një bisede me prof. A. Budën. Dorëshkrim, Tiranë, 1986.

## "Ndërtime të bukura me origjinalitet të qartë"

Si vizatime më të hershme të riprodhuara në botime të ndryshme për Shqipërinë janë disa harta të Durrësit, Vlorës, Kaninës, Shkodrës, Sazanit, Butrintit etj., në të cilat janë skicuar edhe kështjella e mure rrethuese të tyre. Në gravurat më të njohura të riprodhuara në librat e autorëve Françesko Komoço (Francesco Comocio), Xhuzepe Rosaço (Giuseppe Rossacio) dhe Vincenzo Koroneli (Vincenzo Coroneli), që i përskasin fundit të shekullit XVII, jepet edhe imazhi i arkitekturës e i urbanistikës së qyteteve më të hershme shqiptare. Përgjithësisht në to paraqiten kështjella me mure të larta, brenda të cilave janë skicuar edhe ndërtesa të tjera banimi dhe shoqërore, godina të veçanta jashtë mureve, si kisha, tregje, shtëpi banimi etj. Disa nga gravurat e të tri botimeve kanë gjasim, por kanë edhe ndryshime përsa u përket godinave e kalave të vogla jashtë qyteteve, gjurmët e të cilave sot janë zhdukur.

Gravurat e librit të Komoços me pamje të qyteteve të Durrësit dhe Vlorës mbajnë datën 1571, ndërsa për ato të Rosaços<sup>1</sup>, ku jepen kalaja e Shkodrës, ajo e Durrësit dhe e Vlorës, si dhe për ato të dy librave të Koronelit<sup>2</sup>, ku paraqiten pamje të Vlorës, Durrësit, Kaninës, Sazanit, Grykës së Drinit, Shkodrës etj., studiuesit kanë shënuar data të ndryshme. Sidoqoftë, edhe ato u përskasin viteve 1574 – 1696. Pra, paraqitja e kështjellave dhe e objekteve e monumenteve të tjera të kulturës përbën motivin më të hershëm shqiptar në vizatimet e riprodhuara në botime të ndryshme.


Durrësi nga një libër i Koronelit.



Numri vizatimeve, gravurave dhe tablove me pamje të tilla erdhi gjithnjë duke u shtuar. Si objekte të kulturës materiale për të vizatuar apo pikturuar kanë shërbyer edhe vepra që pasqyrojnë pamje të tjera të jetës shqiptare. Më të pranueshme janë krijimet me motive të qëndresës, ku kështjellat, muret rrethuese, urat, rrugët e gurta e objekte të tjera përbëjnë mjedisin kryesor, ose pasqyrohen në sfond, si dhe në peizazhe nga natyra.

Autorët e vizatimeve më të hershme ishin gjeografë, ndër- sa gravuret e tjera të mëvonshme në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera të Evropës Juglindore, u bënë nga shtegtarët rilindës, që erdhën për të nxjerrë nga shtresat e nëntokës statuja e monumente mermeri, dëshmi të qytetërimit të lashtë.

Zbulimi i parë arkeologjik në vendin tonë nis me Kiriakun e Ankokës (1391 – 1452) qysh në vitin 1418. Por as për këtë vit dhe as për udhëtimin e dytë që bëri 17 vjet më vonë, më 1435, nuk kemi dëshmi vizatimesh për monumente, me përjashtim të mbishkrimeve që kopjoi apo përshkrimeve për statujat e monumentet që pa, të cilat i botoi në veprën e tij<sup>3</sup>. Zbulimet e tjera arkeologjike, gjatë të cilave zakonisht bëhen edhe vizatime a gravura për monumentet e zbuluara, u ndërprejnë për një kohë të gjatë për shkak të pushtimit të vendit nga ushtritë osmane.




Tepelena. (Botues H. Holand).

Nga fundi i shekullit XVIII dhe në vitet e para të shekullit XIX, drejt vendit tonë morën rrugën edhe udhëtarë të ndryshëm, të cilët ose shoqëroheshin nga piktorë e arkitektë, ose skiconin vetë objekte e monumente të kulturës, për t'i botuar si ilustrime në veprat e tyre me shënime udhëtimi. Të kësaj periudhe njihen disa vizatime, litografi e gravura, në të cilat u fiksuan pamje që nuk u dihet fati, jo vetëm për shkak të luftërave dhe të fatkeqësive natyrore, por edhe për faktin se të huajt nuk u "kursyen" për t'i grabitur.

Tri gravurat – *Kështjella në Gjirokastrë, Sarajet në Tepelenë, Shtyllë dorike në Apoloni* – të botuara në librin e Holandit japin tri pamje, që sot i gjejmë krejt të ndryshuara. Të skicuara në fillim të shekullit XIX, më 1812 ato kanë fiksuar disa monumente të kulturës shqiptare të saponjërtuara. Holandi i ka vizatuar ato drejt nga natyra, ndërsa në libër janë botuar të gravuruara nga E. Byrne dhe R. Sands<sup>4</sup>.

Një vit më vonë, më 1813, udhëtari tjetër anglez Th. Hjuze bashkë me arkitektin e njohur Çarl Kokrell. Hjuze ishte i bindur se në Shqipëri do të gjenin monumente të arkitekturës, prandaj e shkëputi Kokrellin nga puna për të skicuar kryeveprat e antikitetit grek. Dhe vërtet, kur kaluan në vendin tonë, ata vizituan objekte e monumente të bukura, shumë prej të cilave





*Shtyllë në Apolloni.  
(Botues H. Holand).*

i skicuan. Befasimin e parë e patën në Berat. Lidhur me këtë Hjuzi shkruan: "Duke iu afruar Beratit, ne gjetëm një vend të kultivuar dhe banorë shumë të qytetëruar. Një urë e bukur me nëntë harqe mbi lumin Osum të çonte në varrezat piktoreske, që formonin periferinë e qytetit. Nga e djathta ngrihej një mal i lartë, mbi të cilin shtrihej kështjella..."<sup>5</sup>. Ndërsa "përshkrimin" më të plotë për qytetin na e jep Kokrelli. Në gjithë kuadrin ai ka vizatuar ndërtesa të shumta e me stil të larmishëm. Në plan të parë paraqet një shtëpi dykatëshe, që të mahnit me pasurinë e zbukurimeve dhe mjeshtërinë e të ndërtuarit. Çdo gjë në të duket e skalitur: tymtari, dritaret, ballkonet, dyert, shkallët, deri edhe çatitë e gjithë elementet e tjera. Nëpërmjet një "skalitjeje" të tillë, artisti anglez shpreh entuziazmin e tij për ornamentikën e pasur. I njëjti entuziazëm vihet re edhe në pikturimin e urës mbi lumin Osum, të ndërtesave karakteristike në lagjen përballë, si dhe të kështjellës që ngrihet në mal. Veç duhet thënë se në këtë tablo ka edhe një pasaktësi: mali me kështjellën nuk mund të shihen nga ai këndvështrim që e ka ndërtuar kuadrin piktori, ata janë në anën kundërt të pamjes nga është vizatuar. Thua të jetë lajthitje apo ngatërresë gjatë përpunimit në studion e tij në Londër, larg pamjes reale? Por duke gjykuar thellë, mbështetur edhe në krijime të tjera të tij, mendojmë se, ndoshta, kemi të bëjmë me një trajtim të qëllimshëm, për të

C. Kokrell: "Monumente të lashta kulturore".



dhënë në një kuadër të vetëm gjithë pjesët më të bukura dhe më karakteristike të qytetit: urën, lagjen me shtëpitë njëra nbi tjetrën, malin me kështjellën në majë, si dhe kishën në faqen që bie pingul mbi rrugën e qytetit. Në një nga punimet më të bukura të tij, që ruhet në Akademinë Mbretërore të Arteve në Londër, janë kompozuar në një tablo të vetme dhjetëra monumente kulture të lashtësisë. Kjo vepër, që mbahet edhe si një nga punimet më të bukura të artit britanik, është botuar në një album me 116 krijime të zgjedhura<sup>6</sup>. Në rastin tonë kjo tablo, që titullohet *Monumente të lashtësisë*, dëshmon se vendosja në një kuadër të vetëm e dy më shumë pamjeve, që në realitet nuk janë pranë njëra – tjetrës, ashtu si edhe te *Pamje nga Berati*, ka qenë një prirje e përgjithshme e këtij autori.

Në fillim të shekullit XIX erdhi nga Anglia në Greqi edhe piktori U. Uiliams për të vizatuar monumente të lashtësisë, por nuk u fut në brendësi të tokës shqiptare. Gjatë bregdetit pikturoi vetëm disa pamje nga brigjet e Vlorës dhe Malet akrokeraune pranë Himarës, vepra që i ekspozoi më 1822 në Edimburg, bashkë me disa të tjera me pamje monumentesh të antikitetit grek<sup>7</sup>.

Nga ky këndvështrim është punuar edhe një nga gravurat më të bukura për Gjirokastrën, gdhendur në metal nga një autor anonim anglez. Ndihet në të e njëjta prirje romantike si ajo e

Sarzhën: "Shtyllë në Apolloni".



peizazheve të Uiliamsit. Kalaja dhe ujësjellësi janë vizatur në pikën më të lartë të qytetit. Pamja duket edhe më monumentale nga perëndimi i diellit. Dritë bie në maja, në kalanë mbi shkëmb dhe te harqet e ujësjellësit. Peizazhi është mbuluar nga tonet e errëta të muzgut. Por vlera më e madhe e kësaj grafike qëndron në vizatimin e dy monumenteve më të bukura të Gjirokastrës, që mbeten sot si dëshmi figurative të pamjes së plotë të tyre. Një litografi e Lirit, që paraqet gjithashtu të njëjtën pamje, nuk i ka aq të detajuar ujësjellësin dhe kalanë. Në gravura të autorëve të tjerë ujësjellësi nuk pasqyrohet më, sepse u shkatërrua, ndërsa kalaja jepet e dëmtuar, – dëshmi e gjurmëve shkatërrimtare të kohëve.

Në katër litografite me temë shqiptare që botoi në albumin e tij, Henri Kuk ka vizatuar pamje shtëpish karakteristike të

Shkodrës, të kështjellës në Butrint dhe dy monumente gjysmë – të rrënuara në bregdetin e Jugut. Rreth monumenteve është paraqitur edhe mjedisi natyror me liqenet e malet, me pemë e kopshite, por H. Kuk, si arkitekt që ishte, ka treguar më tepër kujdes në vizatimin e ndërtimeve, të cilat kanë edhe vlerë historike. Për kështjellën e Butrintit, p.sh., ai na ka dhënë të vetmin punim figurativ me pamje të plotë, ndërsa litografitë për Shkodrën paraqesin lagjen karakteristike me shtëpi prej druri, e cila nuk ekziston sot. Siç dëshmojnë historianët, ajo është djegur e gjitha gjatë luftërave. Litografitë nga Shqipëria janë shoqëruar edhe me shënime të vetë autorit, të botuara në faqet e para të albumit.

Me të njëjtën pikë vështrimi si te libri i Holandit që përmendëm në fillim, pamjet *Kështjella në Gjirokastrë, Sarajet në Tepelenë dhe Shtyllë dorike në Apoloni* janë gravuruar rreth 30 vjet më vonë nga G. F. Sarzhen. Këndvështrimi dhe kompozimi i grafikave është aq i përafërt me ato të Holandit, sa të krijohet përshtypja sikur janë kopje të tyre Megjithatë, po t'i shohësh me vëmendje, ato ndryshojnë jo vetëm nga trajtim artistik, por edhe nga disa elemente të tjera. Ngjashmëria na krijon bindjen se gravurat e Holandit kanë qenë të njohura e, ndoshta, janë përdorur si bazë për të gjetur këndvështrimin dhe për të pasqyruar ndryshimet e tridhjetë vjetëve. Duke vizatuar nga i njëjti këndvështrim, bëhet më i lehtë krahasimi i ndryshimeve. Nga sa njohim deri tani, gravurat e Sarzhenit marrin edhe një vlerë tjetër, si të vetmet krijime grafike që pasqyrojnë pamje nga këndvështrime të njëjta të vizatuara tridhjetë vjet më vonë, duke dhënë ndërtimet e reja, mirëmbajtjen e monumenteve dhe ndryshimet natyrore.

Duke bërë krahasim me gravurat e Gjirokastrës, shihen më qartë ndryshimet. Në të dytën pasqyrohen shtëpi të reja banimi, ndërsa për Apoloninë, veç mjedisit natyror në kodrën pas shtyllës, paraqiten ndërtime që nuk shihen në gravurën e parë. Këto pamje, të realizuara nga Sarzheni, janë riprodhuar në një botim të ilustruar me 366 gravura të gdhendura në dru, të realizuara nga një grup autorësh, të cilët, siç shkruhet në faqen e parë, janë nga artistët më të njohur të Parisit dhe të Londrës. Libri me këto gravura u botua në Paris dhe në Londër



E. Lir: "Kruja".

njëkohësisht; madje pati edhe ribotime<sup>9</sup>.

Kalaja e Shkodrës është vizatuar nga disa autorë, si nga Kirshneri, që pasqyron edhe urën mbi Bunë bashkë me lagjen në anën jugore të kalasë, E. Knajti, që ka vizatuar edhe dajlanin poshtë kështjellës, etj. Pamjen më të plotë, me vizatime të hollësishme të të gjitha ndërtimeve, si dhe të lagjes në mes të gjelbërimit, e ka paraqitur autori italian A. Bonamore. Në plan të parë janë vizatuar një karvan me kuaj dhe shqiptarë me veshje kombëtare. Vështrimi drejtohet nga kështjella, ku ngjitet edhe kreu i karvanit. Dallohen vetëm silueta të zeza me pushkë të gjata mbi supe. Gravura është botuar në revistën "La guerra d'Oriente", rreth viteve 1880. Të këtyre viteve janë edhe disa krijime të piktorit Ketën Udvil. Si piktor realist, ai i ka vizatuar figurat e shqiptarëve me veshje kombëtare në mjedise të ndryshme familjare e shoqërore. Interes për vlera historike dhe arkitekturore paraqet gravura *Pranë vendvarrimit të Skënderbeut në Lezhë*, ku ndërtimet prej guri e druri janë vizatuar me qartësi të parë me syrin e një arkitekti. *Hyrja në një fshat shqiptar*, *Pushim në han*, *Në pazarin e Shkodrës*, *Kthimi i luftëtarit*, *Shqiptarët duke u argëtuar*, që kemi përmendur, janë gravura dhe tablo të tjera të K. Udvilit, në të cilat shihen shtëpi karakteristike të Shkodrës e të zonave të tjera të Veriut. Ashtu si në pasqyrimin e veshjeve kombëtare, edhe në vizatimin e objekteve të arkitekturës Udvili është realist, aq sa krijon një përfytyrim të saktë edhe për mjeshtërinë e të ndërtuarit në Shqipëri.

Peizazhet e piktorit Eduard Lir krijojnë imazhe të plota të shumë objekteve dhe monumenteve të kulturës sonë kombëtare. Disa litografi që paraqesin qytetet tona, si Shkodrën, Durrësin, Krujën, Gjirokastrën, Beratin, Butrintin, kanë në qendër kështjella, ndërsa në tri të tjera, me pamje nga Vlora, Tirana dhe Berati, vizatohen shtëpi karakteristike, rrugë, ura etj. Kështjella e Krujës ka pamje më monumentale. Autori ndërton një shkallëzim ngjitës, që fillon me figurën e një burri me veshje kombëtare në plan të parë me shtëpinë, pemën e lartë, lagjen karakteristike dhe shkëmbin, mbi të cilin ngrihet kështjella me kullën e vrojtimit në sfondin e qetë të qiellit. *Kështjella e Krujës* bashkë me *Himarën* janë dy litografi të frymëzuara, që



E. Lir: "Ura e Bahçallëkut, Shkodër".

riprodhohen në librin e tij me shënime nga udhëtimi në Shqipëri<sup>10</sup>. Por në gjithë krijimtarinë e tij, duke përfshirë edhe akuarelet e tablotë që krijoi më vonë, dy punime janë me interes për historinë e arkitekturës shqiptare: akuareli *Ura e Bahçallëkut* dhe litografia *Gjirokastra*. Në të parën kemi të vetmen dëshmi figurative për urën e gurtë mbi Drin, pranë Shkodrës, që paraqitet si monument me vlera arkitektonike dhe artistike. Ka ngjashmëri me Urën e Mesit, një nga monumentet më të bukura shqiptare. Vlera e akuarelit të Lirit qëndron edhe në paraqitjen e plotë të urës, pasi sot thuhet nuk gjendet asnjë gjurmë prej saj. Të rralla janë edhe përshkrimet për të, veç asaj që përmend Marin Barleti në veprën e tij *Rrethimi i Shkodrës*. Duke e pikturuar qindra vjet më vonë, Liri jep këtë përshkrim në faqen e ditarit të tij të 2 tetorit 1848, datë që është shënuar edhe në akuarelin që po analizojmë: "Vizatova pa pushim gjatë gjithë ditës nga pika të ndryshme të anës jugore të kështjellës, prej nga pamja është fort imponante, si dhe urën më të vjetër mbi lumë, e ndërtuar me harqe me masë dhe gjerësi të ndryshme. Ndofta pamja më madhështore e Shkodrës është nga shkëmbi në anën lindore të pazarit. Kështjella dhe malet sipër, qyteti i rrënuar poshtë, lumi që gjarpëron nën urë dhe shikon tutje, — të gjitha këto krijojnë një pamje të mrekullueshme"<sup>11</sup>.

Në litografinë që ka riprodhuar në libër, Shkodra jepet nga pika që e tregojnë madhështore. Në të pasqyrohen të gjitha pam-

"Akuadukti i Gjirokastrës".  
(Litografi nga E. Lir).



Kullë në Nikaj. (Vizatim  
nga E. Durham).



jet që përshkruan në ditar. Duke u nisur nga ky përshkrim, si dhe i ndihmuar nga akuareli që përmendëm, i botuar në një libër të ri kushtuar Lirit<sup>12</sup>, vëmë re se ura me harqe duket pjesërisht në thellësi midis gjelbërimit edhe në litografinë *Shkodra*. Pra, dalin dy punime të Lirit që pasqyrojnë këtë monument me rëndësi, nga i cili nuk kemi ndonjë të dhënë tjetër.

Në litografinë *Gjirokastra* paraqitet kalaja me bedenat dhe dritaret për vendosjen e topave. Pasqyrohet edhe ujësjellësi i famshëm i këtij qyteti, prej të cilit sot ruhen vetëm disa gjurmë. Vizatimi dhe trajtimi artistik i Lirit janë bërë në mënyrë më realiste se në gravurë. Aty vihet re atmosfera romantike, si dhe ndonjë teprim i përmasave, apo ndryshim i relievit natyror. Kështu që litografia e Lirit mbetet edhe më besnike, merr më shumë vlera, sidomos për krijimin e përfytyrimit të ujësjellësit, që nuk ekziston më.

Të bukura janë edhe punimet me pamje nga Vlora dhe litografitë për Beratin. Veç pikturave të bukura, krahasimi i Beratit me qytete të njohura të botës, siç e përmendëm, është shprehje e admirimit për arkitekturën e tij. Sot këto krijime kanë edhe vlera njohëse arkitektonike.

Dhjetëra vizatime dhe akuarele të E. Durhamit paraqesin pamje të shtëpive, rrugëve, kështjellave e brendive të zonave veriore. Në dy vizatime që ka botuar në një nga librat e saj<sup>13</sup>, vihet re interesi për të paraqitur banesat karakteristike. *Kulla*

në *Nikaj* është një përmendore mbi shkëmb. Po ashtu edhe dy kullat në vizatimin *Katund i vjetër Lurë*. Vizatime të tilla Durhami botoi edhe në libra të tjerë të saj, si në "Lufta për Shkodrën" (1914) dhe "Mbi origjinën e disa fiseve, kanune dhe zakone të vendeve të Ballkanit" (1928). Akuarelet dhe vizatimet e tjera që mori në Londër, janë pak të njohura. Në akuarelet me pamje nga Shkodra ajo ka pikturuar dyqane të zanatçinjve e argjendarëve dhe lagje karakteristike.

Etnografë, arkeologë e albanologë të tjerë, që nuk vizatonin si E. Durhami (Durhami ishte piktorë profesioniste), shpesh merrnin me vete piktorë për të ilustruar studimet apo shënimet e tyre të udhëtimit. Thuhet se me grupin e arkeologëve francezë në vitet 20 – të erdhi piktori E. Grand. Ai pikturoi edhe peizazhe nga natyra e vendit tonë, si *Kodrat e gjelbëruara në Pojan* (akuarel). Në një revistë arkeologjike që dilte në Paris, ai ka botuar tri vizatime të ndryshme, me anën e të cilave jep pamje të xhamisë së Tiranës dhe vizaton hollësi arkitekturore të saj<sup>14</sup>.

Pavioni me piktura për Shqipërinë që u hap në Vjenë, pranë ekspozitës etnografike e arkeologjike të vendeve të Ballkanit, u përgatit nga piktorët Farnih dhe L. Forstner, që gjithashtu shoqëronin ekspeditat arkeologjike dhe etnografike<sup>15</sup>. Ekspozita që u organizua në Shkodër më 1918 nga piktorët austrohungarezë, përmbante shumë vizatime dhe peizazhe me monumente të Apolonisë, me pamje të shtëpive karakteristike në Berat dhe në zonat veriore të vendit<sup>16</sup>. Shumë krijime u realizuan edhe nga autorë të tjerë që vinin në Shqipëri për të bërë peizazhe.

Shpesh krijimet artistike janë shoqëruar me përshkrime mbi bukuritë e ndërtimeve tona, ndërsa shënimet e udhëtimit edhe janë ilustruar. Kur çifti anglez Kora e Xhon Gordon pa për herë të parë Gjirokastrën, shkroi: "Pasi pamë Tiranën, Elbasanin, Pogradecin, Korçën dhe Shkodrën, pasi kishim parë shumë qytete të Jugosllavisë, gjetëm në Gjirokastrë një madhësi të shkëlqyer dhe një individualitet të theksuar. Nuk besojmë të ketë në botë një qytet tjetër si Gjirokastra. Ka pjesë përrallore, por që kanë parë ditë më të shkëlqyera. Në pjesën e banuar qëndron pika më magjike e qytetit. Mbi kodra të larta gjenden shtëpi



Muzeu i Artit në Londër.



trikatëshe me dhjetëra dritare të gjera në fasadën kryesore, me ballkon të thellë që del jashtë mureve...<sup>17</sup> Por këtë mrekulli që përshkruan me fjalë, ata nuk mundën ta pasqyrojnë kaq bukur edhe në vizatimet e akuarelet e tyre, magjithëse pamjet që krijuan në vendin tonë, një pjesë të madhe prej të cilave (rreth njëqind) i botuan në librin *"Dy udhëtarë në Shqipëri"*, paraqesin interes. Në një tablo me ngjyra ata kanë pikturuar edhe brenzinë e një kishe në Përmet të pasur në ikona të pikturuara me art. Veç krijimeve të botuara në libër, çifti anglez me siguri ka realizuar edhe akuarele me vizatime të tjera, ndoshta edhe tablo me ngjyra vaji, që tani mund të ruhen në ndonjë koleksion në Angli.

Në kohën kur u krijuan, këto vepra patën rëndësi të madhe, pasi bënë të njohur në botë monumente të arkitekturës shqiptare, në të cilat shpesh, siç janë shprehur edhe vetë autorët e tyre, vihen re punime madhështore dhe spikat individualiteti i theksuar kombëtar. Ndërsa tani gjithë ato krijime shërbejnë edhe si dëshmi figurative për gjendjen e mëparshme të shumë objekteve, por edhe për të dalluar ndryshimet që kanë pësuar gjatë kohës. Ato shërbejnë edhe si një ndihmesë konkrete për restauruesit, si bazë e rëndësishme dhe, madje, e pazëvendësueshme për të ruajtur me saktësi origjinalitetin e monumenteve që kanë nevojë për restaurim.

- 1) G. Rossaccio, "Viaggio da Venetia a Costantinopoli per mare e per terra...", Venetia, 1574.
- 2) V. M. Coronelli, "Città, fortezze ed altri luoghi principali dell' Albania, Epiro e Livadia", Venetia, 1689; Isolano, "Descrizione geografico-istorica...", Venetia, 1696.
- 3) Cyriaco d' Ancona, "Inscriptiones sen epigramatu graeca et latina reperita per Illyricum", Roma, MDCCXLVII.
- 4) H. Holand, "Travels in the Ionian Islands, Albania, Thessaly, Macedonia, during the years 1812 and 1813", London, 1815, f. 488, 496.
- 5) Th. S. Huges, vep. cit.
- 6) "British Painting", London, 1976.
- 7) "Views in Greece, Italy, Sicily and the ionian Islands. Painted in Water-colours by H. W. Williams". Katalogu i ekspozitës, Edimburg, 1822.
- 8) Henry Cook, "Ionian Islands, Greece and Constantinopole", London, 1853.
- 9) "La Grèce pittoresque et historique ancienne et moderne", Paris, 1841; "Greece: Pictorial, descriptive and history". London, MDCCXLIV.
- 10) Edward Lear, "Journals of a Landscape Painter in Albania", London, 1851.
- 11) Edward Lear, vep. cit.
- 12) "Edward Lear, 1812 - 1888". London, 1985.
- 13) Edith Durham, "High Albania", London, 1908, ribotim. London, 1985.
- 14) "Albania", revue d' archeologie, d' histoire, d' art et des sciences appliquées en Albanie et dans le Balkans, Paris, 1924.
- 15) "Ekspozicion balkanik n' Universitet të Vienës", "Posta e Shqypnies", nr II, Shkodër, 1918.
- 16) "Ekspozicion pikturash në Shkodër", "Posta e Shqypnies", nr 40, Shkodër, 1918.
- 17) Jan Gordon and Cora Gordon, "Two vagabonds in Albanie" London, 1927.

## Jehonë në botime të huaja

Veprat më të shquara të pikturës, skulpturës dhe grafikës mbeten pasuri e muzeve dhe e galerive. Përfundimi i tyre në këta tempuj të artit është dëshirë e çdo krijuesi të vërtetë dhe vlerësimi më i lartë që i bëhet veprës artistike. Në disa muze e galeri të njohura të botës kanë hyrë edhe vepra me temë shqiptare.

Pas vlerësimit të parë, brenda muzeve e galerive bëhet një ndarje tjetër e dytë, duke i klasifikuar përsëri. Një numër i



*Muzeu i Peti Palese,  
Paris, ku ka vepra me  
temë shqiptare.*

caktuar qëndron në fond dhe bëhet objekt i studiuesve të artit, kurse ato të pjesës tjetër, të cilat përbëjnë koleksionin që herë pas here kalon në sallat e ekspozimit, kur i rezistojnë kohës, qëndrojnë vazhdimisht të ekspozuara. Midis veprave që përbëjnë thesarin më të çmuar të koleksioneve të huaja shquhen edhe ato me temë shqiptare.



Grua me veshje kombëtare.

T. Valerio: "Baresha".



Ndarja brendapërbrenda muzeut bëhet edhe për arsye vendi. Magjithatë, asnjë muze, sado i madh e i pasur në vepra, nuk mund ta pasqyrojë të plotë zhvillimin e artit. Por ajo që nuk arrihet dot nga muzetë, bëhet nga bibliotekat. Sot një bibliotekë e pasur mund të ruajë (të riprodhuara) krijimet më të bukura të artit botëtor. Riprodhimi i tyre me forma e mjete të efektshme (libra, albume, katalogë, kalendarë, kartolina etj.) i shndërron ato në pronë të një numri të madh njerëzish dhe siguron jehohën artistike të tyre në botë. Por sa tablo me temë shqiptare kanë këtë fat?

Nga hulumtimet e deritanishme kemi arritur në përfundimin se një sërë punimesh me temë shqiptare i kanë kapërcyer muret e muzeve. Riprodhimet e tyre janë të shumta e të larmishme. Për shembull, tabloja *Shqiptarja* e piktorit të shquar francez Kamil Koro është riprodhuar me ngjyra në përmasat e origjinalit në fletë të veçanta, në kalendare, në kartolina dhe në disa libra arti kushtuar pikturës botërore, vetë piktorit Koro etj. Ndërsa tabloja *Haideja* është botuar edhe në revista arti të vendeve të tjera (veç Francës, ku ruhet vepra<sup>1</sup>). *Haideja* është riprodhuar edhe në një album me kryevepra të pikturës botërore (midis 131 tablove më të bukura)<sup>2</sup>.

Krijimet me temë shqiptare të Eduard Lirit, për veprën e të cilit kohët e fundit po tregohet interes i veçantë, janë riprodhuar në disa libra e albume. Në vitin 1985 Akademia e Arteve në Londër botoi një cikël kartolinash me vepra të tij, si: *Berat 1848*, *Mali i Tomorit*, *Shqipëri* etj. Me rastin e hapjes më 1985 të ekspozitës së madhe retrospektive, u njoftua se u stampuan në përmasa të mëdha disa nga veprat më të bukura. Duhet besuar se është botuar edhe tabloja *Mali i Tomorit*, *Shqipëri*, që në atë veprimtari u vlerësua midis punimeve më të arrira me ngjyra vaji e që ndikoi edhe në krijimtarinë e mëvonshme të piktorit.

Në kartolina janë stampuar edhe krijime të Pajo Jovanovicit (botuar në disa vende, ku ndodhen edhe veprat), tabloja *Festë në Venedik* e piktorit M. Skoti, ku në plan të parë është figura e një shqiptari me veshje kombëtare (botuar nga galeria e njohur Tretjakov, pronë e së cilës është edhe vepra). Botime të tilla

vazhdojnë edhe në ditët tona. Në kalendarin e vitit 1986, me vepra të muzeut të Soloturnit (Zvicër), është riprodhuar tabloja *Shqiptari në vrojtim* e piktorit Frank Bukser, si një nga 12 krijimet më të bukura të muzeut. Kjo vepër është botuar në Zvicër edhe në albume, libra e revista arti.

Veprat e Dëlakruase *Etyd për Boçarin*, *Luftëtar shqiptar*, *Burra me kostum suliot*, *Dy luftëtarë shqiptarë* janë riprodhuar në libra e revista arti kushtuar veprimtarisë së artistit të shquar, pikturës franceze dhe asaj botërore. Pjesa tjetër e krijimeve me motive shqiptare, që ruhet në fondet e muzeve të Francës, u botua para dy vjetësh në Paris, në një katalog të ilustruar me rastin e ekspozitës retrospektive me vizatimet më pak të njohura të këtij mjeshtri.

Në shekullin XIX, kur u realizuan disa vepra të shquara me temë shqiptare, riprodhimet me ngjyra ishin ende të vështira. Për këtë arsye mjaft nga ato tablo u gdhendën në gravura për t'i shumëfishuar. Kopje të atyre gravurave të para qarkullojnë edhe sot, kur është përsosur riprodhimi me ngjyra, pasi gdhendjet janë realizuar me shumë mjeshtri. Vepra *Gratë suljote që hidhen nga shkëmbi* e Ari Sheferit popullaritetin më të madh e fitoi që në kohën kur u krijua, duke i kaluar kufijtë e Francës nëpërmjet gravurave të shumta që u përhapën jashtë Muzeut të Luvrit.



*Gra shqiptare duke korrur grurin.*  
Një nga gravurat për tablonë "Gratë suliote".



# SOLEIL DU DIMANCHE



Tabloja e P. Jovanovicit në kopertinën e revistës "Soleil du Dimanche".  
Kopertina a revistës "Le petit Journal" me tablonë për Shqipërinë.  
Gravurë e piktorit L. Heshaimer në kopertinë të një libri për vendin tonë.

Nga fillimi i shekullit XX përhapje të madhe mori edhe shumëfishimi nëpërmjet fotogravurave, një teknikë tjetër kjo për të popullarizuar veprat me ngjyra vaji. Me këtë mënyrë janë riprodhuar edhe krijime të piktorit Leon Zherom, një nga autorët që e ka trajtuar gjerësisht temën shqiptare. Katër tablo të këtij piktori të riprodhuara në teknikën e fotogravurave, iu dhuruan kohët e fundit Galerisë sonë të Arteve nga një bashkatdhetar me banim në SHBA.

Në shekullin tonë janë bërë riprodhime të shumta punimesh me temë shqiptare. Më shpesh ato janë botuar në libra e revista që flasin për Shqipërinë, por ka edhe riprodhime të përdorura për kopertina revistash, si në ato të revistave franceze "Soleil du Dimanche", "Le Petit Journal", si dhe në libra për Shqipërinë.

Tema shqiptare ka gjetur shprehje edhe në albumet me vepra arti kushtuar një autori të vecantë, sic janë albumet me veprat e grafistit anglez H. Uiliams, botuar në Londër më 1851, albumet e piktorëve Stakelberg dhe Filipo Delpino me kostume kombëtare të vendeve të Evropës Juglindore (1825), të litografistit Hendri Kuk me pamje nga Shqipëria, Greqia dhe Turqia (1855), të piktorit francez Lui Dypré *Udhëtim nga Athina*

FRIEDRICH WALLISCH  
ALBANIEN

UND SEINE  
WERTZEICHEN

Le Petit Journal

ADMINISTRATION 5 CENT SUPPLEMENT ILLUSTRÉ 5 CENT  
21<sup>me</sup> Année Numéro 1.212  
DIMANCHE 15 MARS 1914





K. Udvil:  
"Pazari i Shkodrës".

në Kostandinopol (1825), si dhe më të rëndësishmet për vendin tonë, albumet me litografi të Xhozef Kartraitit "Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia" (Londër, 1822) dhe "Skena nga Shqipëria e Jugut", e piktorit Poer Beresford, botuar po në Londër më 1855. Serisë së botimeve të ilustruara i përkasin edhe katalogët e pajisur me vepra arti, si "Shqipëria në tablotë e piktorit Xh. Oprandi", shtypur në Romë në vitet 30-të të shekullit tonë.

Jehona e veprave me temë shqiptare është bërë edhe me teknika me vlera më të larta artistike, si oliografi e litografi. Disa tablo të P. Jovanoviçit e J. Cermakut, të riprodhuara në oliografi, ndodhen edhe nëpër muze të vendit tonë. Sipas krijimeve të Jovanovicit, janë bërë edhe replika me ngjyra vaji nga vetë autori, madje edhe nga piktorë të tjerë, pasi ato janë pëlqyer dhe i kanë kërkuar muze e koleksionistë të shumtë. Janë bërë edhe punime në gobelin. Në vendin tonë ndodhen disa replika të punuara nga piktorë të huaj dhe shqiptarë.

Botimet e mësipërme përbëjnë vetëm një pjesë të jehonës nëpërmjet riprodhimeve, pasi veprat me temë shqiptare janë popullarizuar edhe me anë të shkrimeve e studimeve kritike, në të cilat janë bërë vlerësime me interes. Kjo lloj jehone, që është më e vonshme, vazhdon edhe në ditët tona, madje edhe për veprat e shekullit të kaluar. Nga më interesantët është artikulli i studiueses N. Kallaimer "Shqiptarët dhe Ëzhen Dëlakrua", botuar në revistën angleze "The Burlington Magazine" në gusht 1983, ku analizohen krijimet me temë shqiptare të mjeshtrit të shquar francez dhe vihet në dukje ndikimi i piktorit anglez Xh. Kartrait me albumin me litografi për Shqipërinë, që botoi në vitin 1822. Në studimin e N. A. Kallaimerit krijimtaria e Dëlakruasë me temë shqiptare analizohet dhe vlerësohet si një punë e një shkalle të tillë që e çoi mjeshtrin drejt një veprë më madhore, siç është tabloja *Masakra në Hios*. Ky sjell edhe argumente të reja bindëse për mbështetjen e Dëlakruasë në gravurat me ngjyra të Xh. Kartrait; madje arrin edhe në mendimin se "... litografite e Xh. Kartrait dhe poezitë e Bajronit kanë qenë të vetmet burime të "ikonografisë shqiptare" që i dolën përpara Dëlakruasë në vitin 1820. Por, siç është pranuar edhe nga studiues të tjerë, dhe siç e kemi përmend me parë Dëlakrua u mbësh-



Muzeu Kombëtar, Pragë.

tet shumë në kostumet që i solli nga Shqipëria piktori R. Ogyst, si dhe në albumin e kolegut të tij Lui Dypré e në botimet e udhëtarëve të tjerë të huaj, ndonjërin prej të cilëve ai e citon edhe në ditarin e tij<sup>3</sup>.

Tabletë e piktorit Leon Zherom kanë përfunduar në muze të disa vendeve, veç jo në muze të Francës, ku jetoi e punoi. Edhe jehona për krijimtarinë e tij mori po ato përmasa. Në fillim u shkrua në botimet për Sallonet e Parisit, ku u ekspozuan për herë të parë, ndërsa shkrime të tjera i shoqëruan veprat edhe jashtë Francës. Të huajt arrinin të dallonin figurën e shqiptarit edhe në tablo me tema të tjera të këtij piktori. Siç e përmendëm, një studiues i huaj ka vërejtur se në tabletë e Zheromit "shqiptari njihet që me vështrimin e parë, pasi në shprehjen e tij etnografike autori është gjithnjë i vërtetë<sup>4</sup>. Për tabletë me temë nga Lindja poeti dhe kritiku francez Teofil Gotié ka shkruar se Zheromi ka sy të shpejtë e të saktë, dorë që punon me siguri, duke na dhënë në veprat hollësi me po aq besnikëri sa edhe një fotograf. Mbi të gjitha, ai ka një sens që ne do ta quanim ekzotik, që e ndihmon të dallojë ndryshimet karakteristike të secilit komb<sup>5</sup>.

Shumë vlerësime janë bërë edhe për vepra të veçanta të këtij piktori. Për një tablo ku paraqitet një shqiptar me fustanellë




duke i rënë çiftelisë, pasi u ekspozua në Sallonin e Parisit, u deklarua: "Qyteti i Nantës tregoi shije të lartë duke blerë më të mirën tablo që Zheromi shiti në Sallon"<sup>6</sup>. Ndërsa 27 vjet më vonë, më 1863, u vu në dukje se kjo vepër ishte më e famshmja që kishte firmosur Zheromi dhe që bëri të vraponte i gjithë Parisi për ta parë<sup>7</sup>. Shkrime të tilla gjenden edhe për vepra të tjera të Zheromit.

Krijimet e piktorit anglez Eduard Lir u vlerësuan që në botimin e parë të vitit 1851. Pas një viti u bë botimi i dytë dhe në një libër tjetër të vitit 1852, në faqen e titullit, u shënuar se Liri është "autor i Ditarit të një piktori peizazhist në Shqipëri"<sup>8</sup>. Ndërsa në veprën e bashkudhëtarit të Bajronit, lordit Brajton, punimet e Eduard Lirit u vlerësuan si një përshkrim i bukur i Shqipërisë dhe u cilësuan si "krijime të një niveli tjetër", më të lartë, në krahasim me gravurat e autorëve të mëparshëm<sup>9</sup>. Por vlerësimet më të mëdha Lirit iu bënë për tablotë me ngjyra vaji që ekspozoi pas kthimit të tij në Londër. Vlerësime të tilla janë të shumta dhe vazhdojnë deri në ditët tona. Por nga të gjitha veprat e këtij piktori, siç dihet, tabloja *Mali i Tomorit, Shqipëri* pati jehonën më të madhe. Prej saj u frymëzua edhe poeti i njohur Alfred Tenison për t'i kushtuar katër vargje, nëpërmjet të cilave i thuren lavde mjeshtërisë së piktorit dhe ngrihet lart madhështia e Tomorit<sup>10</sup>. Krahas përkthimit të tyre, po i japim vargjet edhe në origjinal:

*Tomor e Athos – fron magjie,  
vjen hija e largët gjer tek ne,  
një penel një furçe e bie...,  
e ndiej si t'isha vetë atje!<sup>11</sup>*

*(Tomohrit, Athos, all things fair,  
With such a pencil such a pen,  
You shadow forth to distant men...,  
I read and felt the I was there!).*

Vlerësime për veprat me temë shqiptare ka në të gjitha botimet e gjertanishme për Lirin, si dhe në revista e libra të tjerë



Galeria Nacione, Londër.

të artit anglez dhe të atij botëror, ku flitet edhe për krijimtarinë e këtij piktori.

Riprodhimet e shumta të tablosë *Shqiptarja* të piktorit Kamil Koro janë shoqëruar edhe me vlerësime kritike. Në një botim francez është shkruar se ajo qëndron midis porteteve më të mira të Korosë dhe është trajtuar me aq mjeshtëri sa edhe peizazhet, në të cilat u shfaq më qartë madhështia e tij. Ndërsa në parathënien e albumit me disa kryevepra të artit botëror, duke pasur parasysh tablonë *Haideja*, si dhe portrete të tjera të Korosë (*Shqiptarja*, *Vajza me tualet* etj.), është shkruar: "Figurat e vajzave të krijuara nga Koroja të robërojnë me pastërtinë, thjeshtësinë, si dhe me finesën, që mbizotëron"<sup>12</sup>.

Tabloja *Gratë suljote* e piktorit Ari Shefer, në një artikull kushtuar figurës së gruas në pikturën evropiane të shekullit XIX, është cilësuar si një nga pesë punimet më të bukura të artit modern. Ajo është përmendur, madje edhe analizuar, në çdo botim enciklopedik, si dhe në librat kushtuar atij dhe pikturës romantike botërore. Ajo është analizuar para veprave të njohura *Gratë e Algjerit*, e Dëlakruasë, dhe *Gruaja në tualet*, e Rembrandit<sup>13</sup>.

Shumë mendime janë dhënë edhe për tablonë *Valltarët shqiptarë* të piktorit A. Deka, që cilësohet si vepra më e bukur e koleksionit të shekullit XIX të muzeut të Brestit, siç na ka shkruar studiuesi i artit në këtë muze Rënë Lë Bihan. Vepra është paraqitur në disa ekspozita, madje edhe jashtë Francës, pasi, sipas mendimit të studiuesve, ajo quhet përjashtim në krijimtarinë e autorit. Në një revistë arti në Francë është shkruar: "I karakterizuar nga ngjyra pastoze dhe të përpunuara, në këtë tablo Deka paraqitet ndryshe. Ndërsa vizioni për peizazhin dhe skenat e lindjes është përgjithësisht i ashpër ose konvencional, në këtë tablo gjallëria e penelatave dhe gama koloristike japin entuziazmin e dy luftëtarëve në valle, që kontraston me natyrën shkëmbore përreth. Kontrasti i qiellit në muzg me blunë e thellë të detit forcon më shumë bukurinë joshëse të kësaj skene"<sup>14</sup>.

Vlerësime me interes janë bërë edhe për tablotë e piktorit Pajo Jovanović. *Vallja me shpata* dhe *Shqiptari luan me armë* u bënë në disa variante, për të plotësuar kërkesat e disa muzeve të njohura. Po ashtu edhe tabloja *Lufta e gjelave*, e cila fitoi medalje të artë në Vjenë më 1898, është pikturuar në disa replika. Muzetë e Evropës i kërkonin tablotë me temë shqiptare, ndërsa gazeta të njohura vinin në dukje vlerat artistike të tyre. Për tablonë *Këngë për Skënderbeun* kritiku "Observerit" të Londrës ka shkruar se "piktori ka arritur një mjeshtëri të rrallë teknike". Ndërsa në gazetën "Morning Post" po për këtë tablo është shkruar: "E shkëlqyeshme në kompozim, brilante në kolorit, dramatikisht e llojlojshme. Në të paraqiten disa shqiptarë fisnikë dhe të thjeshtë, të mbledhur rreth një plaku të varfër, i cili këndon këngën për Skënderbeun, shoqëruar nga tingujt e instrumentit me një tel të ngjashëm me benxhin modern"<sup>15</sup>.

Artikuj, apo edhe shënime të shkurtra, janë botuar në libra, revista e gazeta të huaja edhe për vepra të tjera me temë shqiptare të P. Jovanovićit, J. Çermakut, K. Udvililit, Ç. Kokrellit, E. Bukserit, Sh. Glerit e të tjerë.

- 1) "Bildende Kunst", nr 4, f. 3, Berlin, 1983.
- 2) "Shedervi zhivopisi v zarubezhnih sobranijah" Moskva, 1974.
- 3) Është fjala për librin "Memoires du colonel Voutrer sur la guerre actuelle des grecs" (Paris, 1823), që është konsultuar për tablonë *Masakrat në Hios*, ku ka vendosur edhe figurën e një suljoti me kostum kombëtar.
- 4) "Gérome", New York, 1881, f. 6.
- 5) "Gérome", New York, 1881, f. 8.
- 6) L. Ayrray, "Salon de 1863", Paris, 1863.
- 7) Gouse, "Les Chefs – d'oeuvres des Musées de France. La peinture". Paris, 1900.
- 8) Edward Lear, "Journal of a Landscape Painter in Southern Calabria". London, 1852.
- 9) Lord Broughton, "Travels in Albania", volum I, London, 1858.
- 10) "Edward Lear, 1812 – 1888", London, 1985.
- 11) Shqipëruar nga Xhevahir Spahiu.
- 12) "Shedevri zhivopisi v zarubezhnih sobranija". Moskva, 1974.
- 13) "Nouveau Larousse illustré", vol. 4, Paris, f. 475.
- 14) "Revue du Louvre", nr 4 – 5. Paris, 1964, f. 285 – 286.
- 15) "Rilindja". Sh. Nimani, "Kombëtarja si frymëzim piktural". 31.12.1984, Prishtinë.

## Në botime shqiptare...

Në kohën kur në disa vende të Evropës krijohehin vepra për Shqipërinë, vetë shqiptarët nuk e dinin një fakt të tillë. Ata vazhdonin qëndresën kundër pushtuesit osman. Po kur lëvizja për liri e pavarësi filloi të bëhej më e organizuar dhe ndërgjegjja atdhetare po rritej, atdhetarët shqiptarë vunë në shërbim të lëvizjes edhe krijimet artistike të autorëve të huaj. Nuk njiheshin gjithë veprat që ishin krijuar, nuk dihej ku ndodheshin dhe, më e vështira, nuk ishin krijuar mundësitë për t'i riprodhuar ose për t'u bërë jehonë nëpërmjet shtypit. Shoqëritë patriotike jashtë Atdheut shfrytëzuan mundësitë teknike dhe realizuan riprodhime në kartolina, në revista, në gazeta, në libra e në botime të tjera.

Në morinë e krijimeve ata zgjodhën veprat me tematikë të kohës: motive nga qëndresa e shqiptarëve për liri e pavarësi. Figura e Skënderbeut, që ishte kthyer në simbol të bashkimit të shqiptarëve, përbënte një nga riprodhimet e para që kanë bërë atdhetarët tanë rilindës prej veprave të autorëve të huaj. Poeti arbëresh Leonardo de Martino (1830 – 1923) ka shtypur në fund të shekullit XIX një kartolinë me portretin e Skënderbeut sipas pikturës së njohur të Galerisë Ufici të Firences e që është një nga krijimet më të bukura kushtuar heroit tonë kombëtar. Në vitet e luftës për pavarësi kartëpostale të tilla nga njëra anë kishin figurën e Skënderbeut, kurse nga ana tjetër, e bardhë, shkruanin përshëndetjet në formë mesazhi atdhetar.

Riprodhime të shumta u bënë edhe në organe të shtypit, gazeta e revista të shoqërive atdhetare. Janë botuar disa gravura për Skënderbeun e bashkëluftëtarë të tij të shquar, për Pirron, si dhe për luftëtarë të tjerë shqiptarë. Ndërsa gravurat me motive nga qëndresa e popullit tonë ndaj pushtuesve në disa gazeta të kohës së Rilindjes janë botuar me shënime të veçanta, ose me tituj e nëntituj që shprehin më qartë idenë atdhetare të veprës. Për shembull, sa herë është riprodhuar tabloja e piktorit italian A. Biankini, i janë vënë tituj të tillë: *Shqiptarkat marrin pjesë në goditje të armikut, Ja si luftojnë amazonat e maleve iliriane për shpëtimin e Shqipërisë*<sup>1</sup>, etj. Gravurës së piktorit francez T. Valerio *Cift shqiptar nga Jugu* i është vënë titulli *Shqiptari përgatitet për fillimin e një kryengritjeje të re*<sup>2</sup>, ndërsa krijime të tjera titullohen: *Shqiptarët i përgjigjen thirrjes për luftë, Trima shqiptarë në ndjekje të armikut, Në mbrojtje të kufijve* etj. etj.


Disa herë veprat e artit janë shoqëruar edhe me shkrime e shënime të shkurtra, me anën e të cilave bëhen thirrje të hapura për bashkim e luftë kundër pushtuesve. Pranë gravurës së T. Valerios *Shqiptari përgatitet për një betejë të re*, botuar në prag të kryengritjeve të mëdha para Shpalljes së Pavarësisë, duke iu drejtuar pushtuesve osmanë, në një gazetë shkruhet: "Ju kërkoni me dhelpëri të mbani kombin shqiptar në padije e në fanatizëm, por kombi shqiptar u zgjua dhe kërkon të drejtat e tij, kërkon të rrojë i lirë në vend të vet, do të diturohet dhe të hyjë në udhën e kombeve të qytetëruara. Kombi shqiptar shumë shpejt do të bashkohet nën flamurin e kuq të Skënderbeut e do të dërrmojë hekurat që i kanë lidhur këmbë e duar dhe do ta shpëtojë Shqipërinë nga tirania e 500 vjetëve"<sup>3</sup>.

Grafika pranë këtij shënimi është riprodhuar me një ndryshim të vogël, por me rëndësi, nga botuesit. Katër kryqet në kordonet e veshjes së gruas janë kthyer në ornamente, në formë ylli shumëcepash. Në ato vite kur luftohej për pavarësinë e Atdheut, vargjet e Vaso Pashës "... E mos shikoni kisha e xhamia/ feja e shqyptarit asht shqyptaria" u bënë motoja e kohës. Madje edhe të huajt që e vinin re, e kanë shprehur po kaq bukur moton e shqiptarëve në vitet e luftës për liri e pavarësi,



*Nikolla Lako me Fan Nolin gjatë viteve që riprodhonte vepra me temë shqiptare në Paris.*

*Dy nga kartolinat që botoi N. Lako në Paris.*



duke theksuar se "nacionaliteti i bashkon shqiptarët më shumë sesa i ndan feja"<sup>4</sup>. Prandaj edhe ato shenja fetare në grafikën e Valeriosë atdhetarët i kanë kthyer në ornamente, që figurat e pikturuara të ishin simbol i gjithë shqiptarëve dhe jo i një krahine a feje të veçantë. Riprodhimet e veprave të autorëve të huaj u shumëfishuan me shtimin e gazetave, revistave e librave të shoqërive tona atdhetare, duke u përdorur si ilustrime. Riprodhimet në fletë të veçanta, apo në kartolina, qenë ende të rralla në atë kohë.

Nga fillimi i shekullit tonë shoqëria atdhetare e shqiptarëve në Paris njoftonte për riprodhime në kartolina mbi fletë të veçanta të pikturave për Shqipërinë. Atdhetari Nikolla Lako, i njohur edhe si publicist, pas botimit të revistës "Shqipëria" në Sofje dhe "Opinga" në Bulonjë (pranë Parisit), iu kushtua popullarizimit të pikturave për Atdheun. Në fillim ai botoi në kartolina vepra të piktorit shqiptar Theohar Gjini, që banonte e krijonte në Paris; madje edhe ndihmoi për organizimin e një



Kopertina e revistës  
"Përparimi" me kartolinën  
e N. Lakos.

ekspozite vetjake të këtij "piktori mëmëdhetar", siç e quanin bashkatdhetarët. Në këtë ekspozitë u paraqitën vepra kryesisht me motive shqiptare. Nikolla Lakoja botoi edhe kartolina me krijime të tij për Skënderbeun. Në fondin e Galerisë së Arteve dhe të koleksioneve vetjake në Tiranë e në Korçë ruhen punime me ngjyra vaji e në grafikë të realizuara gjatë kohës që ai punonte në Francë. Por veprimtaria e tij më e ndritur në fushën e artit është botimi në kartolina i tablove me temë shqiptare të autorëve të huaj. Nikolla Lakoja është i pari shqiptar që ndërmori një veprimtari të tillë me vlerë. Në disa organe të shtypit tonë të Rilindjes dhe të Pavarësisë gjejmë herë pas here njoftime për vënien në qarkullim të kartolinave me piktura nga Shqipëria, të cilat N. Lakoja i kishte bërë sipas tablove të vjetra që ndodheshin në Paris<sup>5</sup>. Në disa gazeta e revista është shënuar edhe lista e veprave të riprodhuara. Vihet re, gjithashtu, prirja e botuesit për të popullarizuar tablo që tregojnë interesin e botës ndaj traditave luftarake e kulturore të Shqipërisë.

Njoftimet për veprat *Skënderbeu mbi kalë*, *Skënderbeu* (në format të madh), *Shqiptarë që kërcejnë*, *Vallja e shpatave*, *Çift shqiptar nga Jugu*, *Luftëtar shqiptar*, *Dy shqiptarka që mbledhin kallinj*, *Shqiptarë që luajnë shah*, *Bareshë shqiptare*, *Një luftëtar shqiptar*, *Vajzë shqiptare*, *Një djalë shqiptar* etj. N. Lakoja i përsëriste jo vetëm në revistën e tij "Opinga", por edhe në organe shtypi të vendeve të tjera. Kartolinat, që përhapeshin në shumë vende, vinin edhe në Shqipëri, duke nxitur krenarinë kombëtare të bashkatdhetarëve. Disa kartolina të N. Lakos botues të tjerë i përdorën si ilustrime të shkrimeve për Shqipërinë. Një kartolinë e tillë e zmadhuar është botuar edhe si kopertinë e revistës "Përparimi", që dilte në Nju – Jork. Përpara titullit të tablosë së riprodhuar *Baresha shqiptare* është vënë shënimi: "Botues N. Lako, Paris"<sup>6</sup>.

Po tani ku ndodhen botimet e Nikolla Lakos?

Me përjashtim të disa kartolinave që ruhen në arkivin e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë, ose edhe në ndonjë familje, pjesa më e madhe është dëmtuar. Në vitet 30 – të, siç është njoftuar edhe në një gazetë të kohës, N. Lakoja, së bashku me një numër të madh librash studimi albanologjikë, i fali



bibliotekës së Korçës edhe një koleksion me kartolina dhe riprodhime të tjera që kishte bërë në Francë, por nga pakujdesia, shumë punime me vlerë u zhdukën.

N. Lakoja bëri disa riprodhime edhe në revistën e tij "Opinga", të cilat i ka shoqëruar me shënime për autorin dhe vendndodhjen e veprave. Ndërsa një nga tablotë e piktorit Ketën Udvil, të cilën e ka marrë nga revista spanjolle "El Correo de



Skulptura "Luftëtar shqiptar" që ruhet në familjen Lako.  
Kartolina e botuar nga Marubi.

Pa is", e ka shoqëruar edhe me një shkrim, në të cilin bën vlerësime për autorin dhe veprën<sup>7</sup>. Veç riprodhimeve në kartolina e fletë të veçanta, si dhe botimeve në gazeta e revista të kohës, N. Lakoja u përpoq të grumbullonte edhe vepra origjinale. Në "pinakotekën" që krijoi gjatë veprimtarisë në Paris, veç pikturave, grafikave e akuareleve të tij e të piktorit Theohar Gjini, bën pjesë edhe skulptura e një autori francez që paraqet një malësor shqiptar. Në pamjen e përgjithshme skulptura të kujton gravurat e K. Udvilit me motive nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndërsa në trajtimin plastik të jep përshtypjen e një statuje me përmasa të mëdha.



Disa kartolina me vepra të autorëve të huaj u botuan edhe nga Studio Marubi në Shkodër, sipas fotografive që u bëheshin veprave nga riprodhime të mëparshme. Më e përhapura nga këto është *Vallja e shpatave*, sipas tablosë së P. Javonoviçit.

Njoftime e gjykime për vepra të tjera me temë shqiptare janë botuar edhe në shkrimet "A ekziston një portret autentik i Skënderbeut?" dhe "Peizazhi shqiptar në një ekspozitë arti në Muni", shtypur në revistën "Albania" më 1900.

Si një ngjarje me rëndësi, në shkrimin e dytë u njoftua hapja e ekspozitës "Peizazhe nga Shqipëria", e piktorit gjerman Herman Urban.

Veç realizimit të tablove me temë nga qëndresa e popullit ndaj pushtuesve, në ato krijime atdhetarët vinin re se piktorët e huaj po përjetësonin në vepra arti edhe bukuritë e natyrës sonë. Veprimtaria në Munih tregonte, gjithashtu, se piktorët e huaj po krijonin jo më një a dy vepra, por edhe ekspozita të veçanta me motive shqiptare. Në këtë shkrim përmenden edhe krijime të piktorëve J. Çermak dhe J. Riselberg<sup>8</sup>, ndërsa për vepra të Paolo Veronezes mbi rrethimin e Shkodrës është shkruar në një libër për Skënderbeun botuar në Shkodër<sup>9</sup>. Për veprat e piktorit të shquar Ezhën Delakrua dhe skulptorit David d' Anzhe me temë shqiptare njoftimi i parë në shtypin shqiptar është dhënë qysh më 1923, në revistën "Hylli i Dritës", ku theksohet edhe se disa muze të Italisë e të Greqisë kanë vepra me temë shqiptare<sup>10</sup>.

Me gjithë rëndësinë që patën në forcimin e atdhedashurisë e të ndjenjës së krenarisë kombëtare, në botimet shqiptare të Paraç lirit nuk u dha mundësia për të krijuar një përfytyrim më të plotë për gjithë atë krijimtari të madhe të autorëve të huaj. Shembujt që u sollën mbetën vetëm konstatime të rastit, pa një pikësynim për të bërë hulumtime më të plota. Veprimtaria e atdhetarit Nikolla Lako, më seriozja, arriti të marrë një drejtim të caktuar për të krijuar, të paktën, koleksione me kartolina e riprodhime në fletë të veçanta të tablove që ndodheshin në Paris, por duke mos u përkrahur nga shteti, ajo mbeti përgjysmë, edhe ato që u arritën të realizoheshin, nuk u ruajtën, të paktën për të dokumentuar atë përpjekje të parë.



Xh. Oprandi: "Malësor shqiptar".

Pas Çlirimit, disa gravura të huaja janë botuar si ilustrime në libra të ndryshëm dhe janë paraqitur në ekspozita e muze të vendit tonë si ilustrime të periudhës së Rilindjes e të Pavarësisë. Në albumin "Gjergj Kastrioti – Skënderbeu" (Tiranë, 1968), përgatitur nga K. Biçoku, dhe sidomos në albumin "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" (Tiranë, 1980), përgatitur nga K. Frashëri, janë botuar shumë punime të tilla. Disa autorë të huaj që kanë krijuar motive nga vendi ynë, janë përfshirë edhe në "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar".

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

- 
- 1) Kalendari i shoqërisë "Vatra". Boston, 1917.
  - 2) "Liri e Shqipërisë", nr 9. Sofie, 1911.
  - 3) "Liri e Shqipërisë", nr 9. Sofie, 1911.
  - 4) Jurien de la Gravière, "La station du Levant", vol. 2, Paris, 1876, f. 89.
  - 5) "Korça", nr 19, f.4, Korçe, 1909. Njoftime të tilla janë botuar edhe në "Ylli Mëngjazit", "Përparimi" etj., që dilnin në Nju – Jork, Boston etj.
  - 6) Revista "Përparimi", nr 3. New York, 1917.
  - 7) "Opinga", nr 2. Boulogne, 1920.
  - 8) "Le paysage Albanais à une exposition d'art à Munich", rev. "Albania". Bruxelles, 1900.
  - 9) "Skënderbeu mbas gojëdhanash", Shkodër, 1926, f. 102.
  - 10) "Hylli i Dritës", nr 8 – 10. Shkodër, 1939.

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

# RIPRODHIMET

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

GEORGIUS

SCANDER  
BEK



K. Altissimo: "Skenderbeu" (vaj),  
Galeria Ufici, Firenze.





R. Veroneze: "Rrethimi i Shkodrës" (afresk)  
Pallati i Dozheve, Venedik.



E. Delakrua: "Episod nga lufta me osmanët" (vaj),  
Koleksioni Oskar Reinhard, Zvicër.



K. Koro: "Haideja" (vaj),  
Muzeu i Luvrit, Paris.

K. Koro: "Shqiptarja",  
Muzeu i Bruklinit, Nju J



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας





L. Zherom: "Shqiptare te prijësi i tyre",  
koleksion privat, SHBA.

L. Zherom: "Shqiptari",  
koleksion privat, Londër.

J. Cermak: "Robinat",  
Muzeu i artit, Pragë.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Sh. Gler: "Fshatare shqiptare",  
Muzeu i Institutit Luel, Boston.



Th. Filips: "Bajroni me kostum shqiptar",  
Galeria e Portreteve, Londer.





"Ali Pashë Tepelena" (vaj),  
Muzeu Benaki, Athinë.  
A. Skoti: "Shqiptari në Venedik",  
Galeria e Artit Tretjakov, Moskë.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας





Xh. Kartrait: "Shqiptar me veshje kombëtare" (akuarel), Muzeu Benaki, Athinë.

E. Lir: "Mali i Tomorrit" (akuarel), Shoqata e Arteve të Bukura, Londër.

Xh. Kartrait: "Shqiptar me veshje kombëtare" (akuarel), Muzeu Benaki, Athinë.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κονίτσας



E. Lir: "Perëndim në Himarë" (litografi)


E. Lir: "Akuadukti i Gjirokastrës" (litografi).



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



E. Lir: "Shkodër 1848" (litografi).  
"Berati"





E. Lir: "Grua nga Shkodra" (akuarel)  
 E. Lir: "Berat 1848" (akuarel).



Putani d'Albania  
 Oct. 6. 1848.

head - deep - worked lace with muslin.  
 vest - 3 rows of gold frogs.

sleeves crimson -  
 vest - purple silk

2. scarlet, green, blue. silk handkerchief.  
 trousers purple (also - gold embroidery)  
 Under x - a bonnet with lace.  
 A & A = collar & 3 gold filigree & Zecchini } 1/6  
 A



Δημοσιονομική Επιβλεπτική Επιτροπή

Beirut.  
October, 1948.



E. Lir: "Bregdeti i Shqipërisë" (vaj),  
koleksion privat, SHBA.

E. Lir: "Berat 1848" (litografi).





E. Lir: "Tirana 1848" (litografi).





P. Beresford: "Shqiptare duke kuvenduar" (litografi).

"Shqiptare duke kuvenduar" (litografi).



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κονίτσας





P. Jovanovic: "Lufta e gjelave" (vaj),  
Muzeu i Artit, Beograd.

P. Jovanovic: "Vallja e shpatave" (vaj),  
Muzeu i Artit, Vjenë.





Δημόσια Κρατική Βιβλιοθήκη Κόντσας

P. Jovanovic: "Përgatitja e nuses shqiptare" (vaj), Muzeu.








Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



O. Shila: "Djaloshi nga Krraba" (vaj).



K. Udvil: "Roja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit".






Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

E. Delakrua: "Kampi i Marko Bocarit" (vaj),  
Koleksioni Zhak Dypo, Paris.

E. Delakrua: "Etyd për Bocarin" (vizatim),  
Muzeu i Luvrit, Paris.



E. Delakrua: "Shqiptare" (akuarel),  
Muzeu i Luvrit, Paris.

E. Delakrua: "Kalorës shqiptar" (akuarel),  
Muzeu i Luvrit, Paris.





E. Delakrua: "Etyd me kostum suliot" (vaj),  
Muzeu i Luvrit, Paris.





Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κονίτσας



A. Shefer: "Gratë suliote" (vizatim),  
Instituti Neolandez, Paris.  
A. Shefer: "Gratë suliote" (vizatim),  
Instituti Neolandez, Paris.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



Ç. Kokrell: "Shqiptarë në ndjekje të armikut".

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Τσαλαρδοπούλου





Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

A. Deka: "Luftëtar shqiptar" (vaj),  
Koleksioni Wallas, Londër.



A. Deka: "Shqiptar me veshje kombëtare",  
koleksioni Wadsworth, Hartford.



A. Deka: "Valltarë shqiptarë" (vaj),  
Muzeu i Brestit, Francë.



L. Zherom: "Luftëtar shqiptar" (vaj).





L. Zherom: "I burgosuri" (vaj),  
Muzeu i Artit Nantes, Francë.

L. Zherom: "Shqiptar duke pirë duhan" (vaj),  
koleksion privat, SHBA.





Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

L. Zherom: "Gjatar shqiptar" (vaj.).



L. Zherom: "Shqiptare që këndojnë" (vaj),  
koleksion privat, SHBA.





K. Udvil: "Roje shqiptare".  
K. Udvil: "Në vendvarrimin e Skënderbeut".





Δημόσια Κεντρού Βιβλιοθήκη Κόντσου

Calvin Woodville

MEIS LORD AND MASTER - ALBANIA



K. Udvil: "Fundi i një tradhtari" (vaj).

K. Udvil: "Shqiptarë që këndo

K. Udvil: "Darkë në male".





Δημόσια Κεν

Κτηματοθήκη Κοινοβ

G. Caton Woodville  
Sculptor.



K. Udvil: "Në pazarin e Shkodrës".





P. Jovanovic: "Vajza që mëson çiftelinë" (vaj).

K. Udviç: "Shqiptare në varkë" (vaj).





E. Lir: "Vlorë 1948" (vaj).

L. Liparini: "Betimi i Bajronit  
në varrin e Marko Bocarit" (vaj)  
Muzeu Civiko, Trevizo Itali.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

Zh. Hile: "Luftëtarë shqiptarë",  
Muzeu i Luvrit, Paris.

A. Deka: "Grua shqiptarë" (vaj).





Δημόσια Κε... ή Βιβλιοθήκη Κοινο...  
ΕΛΛΗΝΙΚΗ ΚΟΙΝΟΤΗΤΑ



A. Biankini: "Gra shqiptare në vijën e parë të frontit" (vaj).



J. Čermak: "Shqiptari dhe robinat",  
Muzeu i Artit, Pragë.





Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

A. Mago: "Shqiptarja"  
Muzeu Kantini, Marsej



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



T. Valerio: "Çift shqitar nga Jugu".



Xh. Baret: "Florence Naintingel në Shkodër" (vaj), koleksion privat, Londër.



J. Sargent: *"Mbledhës të ullinjve, Shqipëri"*,  
*Muzeu i Artit, Manchester.*

U. Uiliams: *"Bregdeti i Shqipërisë së  
Jugut"*, *Muzeu Edinburgut.*





U. Uiliams: "Bregdeti i Shqipërisë së Jugut", Muzeu Edinburgut.


Irton: "Burim uji në Delvinë".






"Kështjella e Gërokastrës".






Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κονίτσας



Th. Veber: "Himara".  
L. Hesaimer: "Selvitë në Elbasan" (vaj),  
koleksion privat, Vjenë.



E. Durham: "Shqiptare në treg" (vaj),  
Muzeu Halifaks, Londër.

E. Durham: "Shkodra më 1901" (vaj),  
Muzeu Halifaks, Londër.





Xh. Oprandi: "Vajzë shqiptare" (vaj),  
koleksion privat, Itali.

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

AUTORË TË HUAJ  
DHE  
VEPRA ME TEMË  
SHQIPTARE

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

AUTORE TË HUAJA  
DHE  
VEPRA ME TEMË  
SHQIPTARE

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

**SHËNIM:**

Në burimet bibliografike janë cituar vetëm botimet ku flitet për Shqipërinë, pa përmendur veprat e shumta që janë shfrytëzuar për jetëshkrimin e autorëve. Për autorët dhe veprat për të cilat na ka munguar bibliografia, jemi bazuar në shënimet dhe fotokopjet që kemi marrë nga muzetë e huaja që ruajnë vepra me temë shqiptare.

## AGRIKOLA, Filipo (*Filippo Agricola*)

Piktore italian (1795-1857). Në fillim ndoqi stilin e të atit, Luixhit, që ishte piktor i njohur, pastaj studioi në Akademinë e San-Lukës. U shqua për tablotë që krijoi në Akademi, sidomos për portretet, për të cilat e quajtën "Rafael i shekullit". Është përfaqësues i neoklasicizmit italian.

Si një ndër veprat më të mira të krijimtarisë së tij është vlerësuar edhe tabloja *Një vajzë shqiptare që i shpëton ndjekjes së një turku*. Ka qenë pronë e kontit Lytzov (Lüt-zow) në Itali.

Enciclopedia italiana Treccani. Roma 1929.

## ALLAN, Wiliam (*William Allan*).

Piktore anglez. (1782-1850). Studioi në disa shkolla arti dhe në Akademinë Mbretërore të Londrës. Ka realizuar tablo me temë bashkëkohore dhe me subjekte nga historia. Më 1805 shkoi në Rusi ku pikturoi disa vepra mbi jetën e vendit. Më pas udhëtoi në disa shtete të Evropës.

Në një shënim të Akademisë së Arteve të Londrës thuhet që U. Allan mendohet të ketë realizuar tablo edhe me subjekte nga Shqipëria.

## ALINJI, Teodor (*Theodore Caruelle d'Aligny*)

Piktore francez (1798-1871). Autor i njohur për trajtimin e peizazhit historik, por dhe nga të parët që ka këmbëngulur për domosdoshmërinë e pikturimit drejtpërdrejt nga natyra. Në vitin 1825 u miqësua me piktorin K. Koro (C. Corot), gjatë qëndrimit në Itali, dhe u inkurajua mjaft prej tij. Më vonë udhëtoi në rajone të ndryshme të Francës, në Itali dhe në Greqi (1843). Vitet e fundit ishte drejtor i Shkollës së Arteve të Bukura në Lion. Veprat e tij janë të ekspozuara në Luvër dhe në muze të tjerë, si: në Avinjon, në Lion etj.

Gjatë udhëtimit në Greqi ndoshta ka kaluar edhe në vendin tonë. Deri tani njihet punimi *Luftëtar shqiptar* (16.3 × 21.4 cm), që është realizuar në vitin 1866. Paraqet një figurë burime uniformë oficeri, të ulur, në profil. Ndodhet në kabinetin e vizatimeve të Muzeut të Luvrit. Është blerë në vitin 1927 nga një koleksionist privat.

## ALTISIMO, Kristofan (*Christofano dell'Altissimo*)

Piktore italian i shekujve XV-XVI. Ka jetuar dhe punuar në Firence. Sipas një botimi të huaj të kohëve të fundit (1983) mendohet se është autori i portretit të njohur

të Skënderbeut, që ruhet në Galerinë Ufici të Firencës.

Tabloja është punuar me ngjyra vaji dhe supozohet si një nga portretet e pakta autentike të Skënderbeut, sipas të cilit janë realizuar shumë krijime të mëvonshme. Thuhet se portreti u punua sipas një tabloje që ruhej në koleksionin e arkidukës Ferdinand i Tirolit, vepër e krijuar nga një vizatim origjinal i Xhentile Belinit.

## AMAN, Jost (*Jost Amman*)

Piktore dhe grafist zviceran (1539-1591). Pak gjëra dihen për formimin e tij si artist. Në vitin 1560 u vendos në Nyrenberg, ku qëndroi derisa vdiq. Punoi mbi bakër dhe në dru. Gravurat e tij u botuan në libra të ndryshëm. Shumë vepra të tij ruhen në Muzeun e Luvrit, në Albertina të Vjenës dhe gjetiu. Nga tablotë në pikturë njihen fare pak.

Për shumë gravura J. Aman u frymëzua, nga qëndresa shqiptare kundër vërshimit otoman. Rrethimet e Krujës dhe betejat e shqiptarëve për liri u përjetësuan në disa prej gdhendjeve më të bukura të këtij mjeshtri që u quajt *një nga artistët më të frytshëm të kohës së vet*. Për herë të parë ato u riprodhuan në botimin gjermanisht të viti 1577 të "Historisë së Skënderbeut" të Barletit. Amani ka bërë edhe një gravurë të veçantë për Skënderbeun, riprodhuar po në atë libër, shtypur edhe si fletë më vete. Më pas gravurat e tij mbi Shqipërinë u ribotuan edhe në libra të tjerë.

Marinus Barletius "Scanderbeg...", Frankfurt 1577; G.T. Petrovitch; "Scandebeg. Essai de bibliographi rasionnée", Paris, 1881 (ribotuar nga F. Babinger, Munih, 1967); J. Irmsher, "Skënderbeu dhe Gjermania", në Konferencën I të Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969.

## ANZHE, David (*David d'Angers 1788-1856*).

Studimet e para i mori në vendlidje në Anzhe (Anger). Më 1808 u vendos në Paris, ku vazhdoi studimet në atelienë e skulptorit Roland. Në vitin 1811 mori çmimin e Romës, që jepej në Francë për skulptorin ose piktorin më të mirë.

Nga ngjarjet bashkëkohore, skulptorit francez i la mbresa vrasja e suljotit Marko Boçari, luftëtar për pavarësinë Greqisë. Në përkujtim të heroit ai gdhendi në mermer një djalosh të ulur që shkruan emrin "Boçari". Skulptura u vendos në vendin ku u vra heroit. Pas disa vjetësh ajo u dëmtua. Skulptori vajti dhe ndreqi pjesët e thyera. Për t'u ruajtur nga dëmtime të mëtejshme skulptura u vendos në Muzeun Etnologjik të Athinës. Në vitin 1912 një kopje besnike e saj, e realizuar nga skulptori grek G. Bonama, u vendos mbi varrin e Boçarit. Sipas kësaj skulpture janë bërë edhe figurina në bronz që ruhen në koleksione të ndryshme në Greqi.



Nouveau Larousse illustré, Paris; "Hylli i Dritës", Shkodër, 1939; F. M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

### AHEN Hans fon (*Hans von Achen*).

Piktor gjerman. (1552-1615). Ka realizuar disa portrete të njerëzve të shquar të kohës së tij. Në njërën prej tyre përjetësoi figurën e strategut të shquar shqiptar Gjergj Basta. Si udhëheqës i ushtrive të bashkuara evropiane në luftë kundër osmanëve, Gjergj Basta u bë i njohur në Evropë dhe tërhoqi vëmendjen e artistëve. Figura e Bastës është ravijëzuar edhe në vepra të autorëve të tjerë, por portreti i piktorit gjerman Hans Ahen është më i përhapuri.

Dh. Pilika, "Një shkrimtar dhe teoricien i shquar shqiptar në artin ushtarak botëror", Rev. "Ylli", Tiranë, 1966.

### AUGUSTINCIQ, Antun (*Augustincic Antun*).

Skulptor kroat. (1900-1979). Studimet e larta i bëri nën drejtimin e skulptorit të dëgjuar I. Mestrovic në Zagreb. Më vonë vazhdoi studimet në Paris dhe që prej vitit 1945 punoi si profesor në Akademinë e Arteve Figurative të Zagrebit. Ka fituar çmime në disa konkurse ndërkombëtare. Krijimet e tij shquhen për trajtimin realist, sidomos në portrete.

Në vitin 1937, Augustinçiqi mori pjesë në konkursin për monumentin e Skënderbeut që u organizua në Tiranë. Boceti i tij u pëlqye midis dhjetëra krijimeve të paraqitura nga skulptorë të disa vendeve të Evropës. Juria i dha çmimin e parë. Boceti i Augustinçiqit mbeti para realizuar për shkak të ndërhyrjeve të fashizmit italian në vendin tonë.

"Përpyjekja shqiptare", nr. 13, Tiranë, 1938, Enciklopedia e Jugosllavisë, bot. shqip, Zagreb, 1984.

### AVELO, H (*H. Avelot*).

Piktor francez i shekullit XIX. Ka udhëtuar në Shqipëri bashkë me Marius Bernard, autorin e librit "Rreth mesdheut". Në libër përshkruhen peizazhet e bukura të vendit tonë, kostumet e larmishme si dhe tipa të ndryshëm shqiptarësh. Të njëjtat motive janë fiksuar edhe në krijimet e piktorit Avelo. Janë gjithsej 131 grafika. Më të bukurat prej tyre me temë shqiptare janë: *Fshatar nga Durrësi, Saranda etj.*

Marius Bernard, "Autor de la Méditerranée", Paris, 1873.

### BARBERIS (*Barbérís*).

Grafist i shekullit XIX. Është një nga kronistët e shumtë të viteve 1870-1880 që fiksoi aspekte nga veprimtaria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në gravurat e tij pasqyrohen luftëtarë malësorë, pjesëtarë të Lidhjes Shqiptare.

### BARET, Xheri (*Jerry Barret*).

Piktor anglez. (1824-1906). Nga viti 1851 ekspozoi disa vepra me temë bashkëkohore dhe historike në Akademinë e Arteve në Londër. Pas këtij ekspozimi, piktori u bë shumë i njohur nga bashkëkohësit. Disa nga pikturat e tij u popullarizuan nëpërmjet riprodhimeve, që u bënë sipas gdhendjeve me çelik.

E para nga dy veprat më të suksesshme të tij titullohet *Florensa Naitingen në Shkodër*. Është realizuar në vitin 1856, me ngjyra vaji, mbi Kanavacë. Përmasat 140 × 210 cm. Një vizatim i plotë i pikturës është në koleksionin e Galerisë Kombëtare të Portreteve në Londër ndërsa një replikë, më përmasa 60 × 69 cm, realizuar po nga Xh. Baret, është shitur në Sathenbi (Sothenby) më 14 korrik 1983.

Graham Reyndas, "Victorian Painting", London 1966.

### BARONI, Euxhenio (*Eugenio Baroni*).

Skulptor italian i fillimit të shekullit XX. Në vitin 1932 ka punuar për një monument të Skënderbeut. Boceti që realizoi në bronz, aty nga fundi i vitit 1932, u vlerësua prej specialistëve të artit dhe u bë objekt diskutimi për realizimin në përmasa të mëdha. Nuk dihet përse nuk mori pjesë në konkursin që u organizua në Tiranë më 1937 dhe përse vepra e tij nuk u realizua në përmasa të mëdha, në vend të asaj të R. Romanelit, pasi është me më shumë vlera artistike.

"Il monumento a Scanderbeg di Eugenio Baroni", në rev. "L'Eroica", Roma, 1939.

### BELINI, Xhentile (*Gentile Bellini*).

Piktor italian. (1429-1507). Pjesëtar i familjes së njohur të piktorëve Belini, i ati Jakopo, vëllai më i vogël Xhovani (1430-1516). Mësoi të pikturojë në studion e të atit. Veprat e para i takojnë vitit 1465. U shqua më shumë si portretist dhe u bë piktor zyrtar në Venedik, ku pikturoi disa portrete të personaliteve të kohës. Vajti në Stamboll ku bëri portretin e Mehmetit II. Qëndroi dhe në Egjipt, dhe është ai që futi orientalizmin dhe ekzotizmin në pikturën veneciane.

Gjatë kohës që punonte në Venedik, mund të ketë bërë edhe portretin e Skënderbeut, të vizatuar drejtpërdrejt nga natyra, kur heroi luftoi në jug të Italisë (1460-1461) ose kur vizitoi Romën (1466-1467). Sipas mendimit të disa historianëve, gjatë kohës kur Skënderbeu shkoi në Itali në ndihmë të Ferdinandit të Napolit, piktori Xhentile Belini u porosit t'i bënte portretin.

"Existe-t-il un portrait authentique de Scanderbeg?", rev. "Albania", Bruxelles, 1901; "Scanderbeg", Paris, 1983.

## **BENFELER, Franc** (*Franz Benfeler*).

Piktor gjerman i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa grafika me motive shqiptare, 7 prej të cilave janë riprodhuar në një libër të botuar në Munihi në vitin 1912. Në to paraqiten pamje nga natyra e vendit tonë si dhe figura me veshje kombëtare.

Karl Otten, "Die Reise durch Albanien", München, 1912.

## **BERESFORD, Poer** (*Poer Beresford*).

Piktor anglez i shekullit të kaluar. Udhëtoi në disa vende të Ballkanit, ku realizoi dhjetëra litografi dhe vizatime.

U interesua kryesisht për kostumet popullore dhe për ndërtimet karakteristike, la edhe pamje të bukura të natyrës. Në Londër, me krijimet më të mira, ai botoi albume të ndryshme.

Një album të veçantë e përgatiti me aspekte nga vendi ynë. Aty ka paraqitur pamje të natyrës dhe figura me veshje kombëtare. Në albumin "Skena nga Shqipëria e Jugut", autori ka pikturuar edhe figura shqiptarësh që banonin në Artë, në Prevezë, në Janinë, në Filat. Litografite kanë interes për paraqitjen e bukur të kostumeve popullore, si dhe mjediset karakteristike, ku ai vendos figurat, që janë gjithashtu të pasura me objekte të kulturës popullore.

Poer Beresford, "Scenes in Southern Albania", London, 1853.

## **BESHDES** (*Beszedes*).

Skulptor hungarez i shekullit XX. Ka qenë në vendin tonë gjatë viteve 1917-1918. Bashkë me dy piktorë austriakë organizoi në Shkodër, nga 30 prilli e deri më 2 maj, një ekspozitë me piktura mbi Shqipërinë. Kolegët e tij paraqitën më shumë vepra me ngjyra, ndërsa Beshedes - kryesisht skica, etude dhe vizatime, peizazhe dhe aspekte nga jeta në disa vise të Shqipërisë, si: Elbasani, Berati, Fieri, Kavaja, Shkodra etj. Ndonjë nga punimet e tij origjinale thuhet se ruhet në Shkodër.

"Ekspozicion pikturash në Shkodër", në gaz. "Posta e Shqypnisë", Shkodër, 1918.

## **BIANKINI, A.** (*A. Bianchini*).

Piktor italian i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa tablo me ngjyra vaji. Mendohet të ketë bërë disa punime me motive shqiptare. Deri tani njihet tabloja *Gratë shqiptare në vijën e parë të sulmit*. Skena është realiste dhe jep atmosferën e vërtetë të viteve kur luftohej për lirinë e Shqipërisë. Autori ka fiksuar një aspekt karakteristik për shqiptarët: në mbrojtje të lirisë të gjithë dalin në vijën e parë të frontit. Vepra e Biankinit ka pasur jehonë të madhe. Ajo u botua në disa organe të shoqërive atdhetare shqiptare.

Gaz. "Dielli", Boston, 1916, Kalendar i Shoqërisë, "Vatra", Boston, 1917.

## **BLOM Karl** (*Carl Blohm*).

Piktor dhe skulptor gjerman. (1886 - 1946). Në vitin 1934 qëndroi për disa muaj në vendin tonë. Realizoi, në akuarel, kryesisht portrete dhe peizazhe. Në vitin 1934 përgatiti punimet më të mira për një ekspozitë vetjake në Tiranë.

Vor fünfzig Jahren Museum Prinzesshof, Itzehoe 1977, Gedächtnis - Ausstellung Carl Blohm Itzehoe 1959, Ausstellung Carl Blohm, Brockdorff 1979; "Piktura për qoshkën e KTAM - it në Panairin e Barit", gaz. "Besa" Tiranë, 22 gusht 1934, "Kujtime" të O. Paskalit, dorëshkrim, Tiranë, 1979; "Shënime" nga Rudiger Pier, dorëshkrim, 1987.

## **BOL, Ferdinand** (*Ferdinand Bol*).

Piktor holandez (1616 - 1680). Erdhi në Amsterdam që në moshë të vogël dhe mësoi në studio e Rembrandit nga viti 1633 deri më 1638. Në këtë periudhë thuhet se mjeshtri i madh shiti disa kopje të pikturave të tij të ekzekutuara nga Boli. Veprat e para të piktorit F. Bol, veçanërisht portretet, janë shumë të ngjashme me ato të Rembrandit dhe shpesh janë ngatërruar edhe nga specialistët. Pas vitit 1650 F. Boli realizoi në stilin barok disa dekoracione të bukura për ndërtesa të rëndësishme publike në Leiden dhe në Amsterdam.

Midis portreteve të njerëzve të shquar nga vende të ndryshme të botës, Bol ka pikturuar edhe - një portret të Pirros së Epirit. Origjinali nuk dihet se ku ndodhet, ndërsa një riprodhim në përmasat e origjinalit ndodhet në Bibliotekën Kombëtare në Paris. Vepra për Pirron është pikturuar në kohën kur kryengritjet shqiptare kundër pushtuesve osmanë kishin pasur jehonë në Evropë. Njihet edhe një tjetër gravurë për Pirron, që ndoshta edhe ajo është e piktorit Bol ose e nxitur nga portreti që krijoi ai.

Gaz. "Rilindja", 3 mars 1971, Prishtinë;

Gaz. "Shqipëria e Re", Sofje, 1913.

## **BOKAZH, Barbi dy** (*Barbie du Bocage*).

Autor francez i shekullit XVIII. ka qenë anëtar i Institutit Francez të Gjeografisë. Në krijimtarinë e tij bëjnë pjesë edhe ilustrime me figura, zbukurime dhe harta të botuara në libra të Pukëvilit. Disa prej grafikave janë me temë shqiptare. Në krijimet e B. Bokazhit paraqiten figura me kostume kombëtare, luftëtarë etj.

Pouqueville, "Voyage en Morée, à Constantinople et en Albanie", Paris, 1805;

Pouqueville, "Voyage dans la Grèce", Paris, 1852.

## BONAMORE, A. (*A. Bonamore*).

Piktor italian i fundit të shekullit XIX. Është autor i disa gravurave me motive nga vendet e Mesdheut, të botuara në revista dhe libra të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX. Në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ka udhëtuar në vendin tonë dhe realizoi disa gravura, që u botuan në revistën "La Guerra d' Oriente". Veç vizatimeve nga natyra, Bonamore është mbështetur edhe në fotografi të Marubit. Punimet e Bonamores për Shqipërinë janë riprodhuar edhe në libra e revista të tjera.

Luigi Pennazzi, "La Grecia Moderna", Milano, 1880.

## BRAUN, C.H. (*C.H. Brown*).

Piktore angleze e shekullit XIX. Ka udhëtuar në vendin tonë në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gravurat me motive nga Shqipëria e Veriut u riprodhuan në një libër për vendin tonë, botuar në Londër në vitin 1888. Akuarelet e saj dallohen për trajtime piktorike me interes dhe parqitje me realizëm të mjedisit, si dhe të veçorive karakteristike të shqiptarëve.

H. A. Brown, "A Winter in Albania", London, 1888.

## BREU, Jorg (*Jourg Breu*).

Piktor dhe grafist gjerman (1510–1547). Mësimet e para për pikturë dhe grafikë i mori nga i ati që ishte një autor i njohur. Më vonë bëri disa udhëtime studimi në Itali. Realizoi shumë tablo me ngjyra vaji, që ruhen në muze të njohura të Munihut dhe të qyteteve të tjera të Gjermanisë. Popullaritetin më të madh e mori nga gravurat në dru.

Pesëmbëdhjetë nga gravurat e këtij mjeshtri janë me subjekte nga qëndresa shqiptare kundër invazionit osman. Breu i realizoi në moshë të re, sapo u kthye nga studimet që bëri në Itali. Gravurat e tij u përdorën si ilustrim i botimit gjermanisht të vitit 1533 të Historisë së Skënderbeut të Barletit. Pas Jost Amanit, gravurat e Breut janë ndër krijimet më të bukura kushtuar qëndresës shqiptare kundër pushtuesve osmanë. Disa prej tyre u botuan edhe në libra të tjerë për Shqipërinë, ndërsa origjinalet mund të ruhen ende në muze të Munihut, ose në muze të tjerë të Gjermanisë.


Franz Babinger, "Zwei baierische...", Leipzig 1959; J. Irmsher, "Skënderbeu dhe Gjermania", në Konferencën I të Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969.

## BUHSER, Frank (*Frank Buchser*).

Piktor zviceran (1828–1890). Studimet i bëri në Itali. Krijimtaria e tij përbëhet nga tablo, portrete, peizazhe, dhe ruhet kryesisht në muzetë të Balës dhe të Lucernës.

Stili i tij realist është kristalizuar gjatë pikturave drejtpërdrejt nga natyra. Ka bërë disa udhëtime për të pikturuar.

Veprat me temë shqiptare i ka bërë gjatë udhëtimit të dytë nëpër vendet e Ballkanit, nga marsi deri në shtator



të vitit 1881. Janë dy figura të kompozuar: *Shqiptari në vrojtim* dhe *Vajzë shqiptare*. Të dyja janë të ekspozuara në Muzeun e Soloturnit në Zvicër.

Gemälde und Skulpturen, Von Peter Vignou – Wilberg, Soloturn 1973; Aus der Sammlung, des Kunstmuseums Soloturn, 1986.

## ÇARDO, Vincenzo (*Vincenzo Ciardo*).

Piktor italian i fillimit të shekullit tonë. Jetoj dhe pikturoi kryesisht në vendlindje, në krahinën e Puljes. Sa ishte gjallë hapi 15 ekspozita vetjake me portrete dhe peizazhe. Është një nga piktorët e njohur italianë të viteve 30-të.

Erdhi në Shqipëri më 1929. Realizoi disa peizazhe dhe portrete. Me 30 punimet më të mira hapi ekspozitën vetjake në Pulje në vitin 1930. Tani ato ruhen në koleksione të ndryshme në Itali.

Antonio Cassiano, "Vincenzo Ciardo", Puglia, 1979; V. Ciardo, "Una breve campagna pittorica in Albania" në rev. "Japigia", Roma, 1931; V. Ciardo, "Il clima pittorico del' Albania", në "Meridiano di Roma", 1940.

## ÇERMAK, Jaroslav (*Jaroslav Čermak*).


Piktor çek (1830–1878). Filloi studimet në vendlindje dhe i plotësoi në disa akademi dhe studio të vendeve të tjera, si: Mynih, Dyseldorf, Anvers e Bruksel. Në vitin 1852 u stabilizua përfundimisht në Paris. Gjatë kësaj kohe qëndroi disa muaj në Malin e Zi, Dalmaci në vendet fqinje, ku trajtoi motive nga jeta e përditshme dhe nga lufta kundër pushtimit osman. Tablotë e tij me këto motive u pëlqyen për koloritin e gjallë dhe për frymën romantike.

Çermak realizoi edhe disa portrete të bukura.

Tablotë ku paraqiti figura shqiptarësh mund të jenë të periudhës kur artisti u vendos në Paris. Ai kishte udhëtuar pranë veriut të vendit tonë.

Në pikturimin e shqiptarëve Çermak i kushton rëndësi si realizimit të tipave të veçantë, ashtu edhe paraqitjes sa më të plotë të kostumeve kombëtare. Tablotë janë në ngjyra vaji dhe qëndrojnë të ekspozuara në Galerinë Kombëtare të Pragës dhe muze të tjera të Evropës.

"Le paysage Albanais à une exposition d' art a Munich", rev. "Albania", Bruksel, 1900; "Narodni Galerie ceske malirstri XIX Stodet", Praha, 1952.



## DĚLAKRUA, Ęzhen (*Eugène Delacroix*).

Piktor, akuaelist, disenjator e litograf (1798 – 1863). Studioi në atelienë e piktorit Gerën. Më 1822 ekspozoi në Sallon *Dante dhe Virgjil* në Ferr, që shquhej për shprehjen dramatike, tonalitetin e thellë dhe që ngjalli reagime të ndryshme. *Masakra në Hios* (1824) u quajt manifest i shkollës romantike në sajë të frymës tragjike dhe të vibracioneve koloristike. Nga një udhëtim në Angli (1825) ai u dha me pasion pas Shekspirit, Skotit e Bajronit. Në këtë (kohë) realizoi disa tablo të frymëzuara nga ngjarjet bashkëkohore, si: *Liria udhëheq popullin në barrikada* (1831), *Greqia jep shpirt në rrënimet e Mesolongjit* (1827) etj. Më 1832 qëndroi disa kohë në Algjeri, ku bëri gjithashtu disa tablo shumë të çmuara si *Gratë e Algjerit* etj. Delakrua luftoi për të gjetur një gjuhë plastike të pastër, ishte kundër kompozimeve statike. Në pikturat e tij ndihet dinamizmi i linjave të forta dhe shpërthimi i njollave koloristike.

Deri tani njihen mbi dhjetë punime me temë shqiptare të realizuara nga E. Dëlakrua. Më të njohurat janë: *Dy luftëtarë shqiptarë*, *Dy etyde me kostum suljot*, *Një*

*luftëtar dhe grua shqiptare*, *Kampi i Marko Boçarit*, *Etyd për Boçarin*, *Kalorës shqiptar*, *Episod nga lufta kundër turqve*, *Burrë me kostum suljot* etj.

Pjesa më e madhe e këtyre krijimeve ruhen në Muzeun e Luvrit në Paris, të tjerat në muze dhe në koleksione private në Zvicër, në Greqi dhe në Francë.

R. Escholier, "Delacroix", Paris, 1926; René Hyghes, "Delacroix ou le combat solitaire", Paris, 1964; Michel le Bris, "Journal du romantisme", Paris, 1981; "Le néo – classicisme français", Paris, 1974; "Delacroix", Milano, 1963; "Supplément hebdomadaire de la Galerie des Arts", nr. 227, Paris, 1985; "Shënime dërguar nga Muzeu i Luvrit", Paris, 1985; rev. "Hylli i Dritës" nr. 8 – 10, Shkodër, 1935; Rexhep Goxhi, "Edukata estetike", Prishtinë, 1980; N.A. Kallmier, "Of Suliots Arnauts, Albanians and Eugène Delacroix", "The Burlington Magazine", London, 1983; Important 19 – th Century European Paintings (Drawings and Watercolours), New – York, 1987; gaz. "Corriere della sera", Milano, mars, 1986; H. Dumesnil, "Le Salon de 1859", Paris, 1859; L. E. Johnson: Two sources of Oriental Motive copied by Delacroix", "Gazette des Beaux – Arts", Paris, 1965.

## DELPINO, Filip (*Filippo Delpino*).

Piktor italian i shekullit XIX. Pas një udhëtimi të gjatë nëpër Ballkan, botoi në Itali një album me përmasa të mëdha, me gdhendje druri të ngjyrosura. Aty paraqiti figura të kombësive të ndryshme me kostumet kombëtare.

Në atë album ka edhe disa pamje kushtuar shqiptarëve, si: *Tre shqiptarë* (Tab. 91), *Ushtarë shqiptarë* (Tab. 101), *Shqiptarë* (Tab. 105), *Ushtar shqiptar* (Tab. 114), *Gjuetar shqiptar* (Tab. 122) etj.

Filippo Delpino, "Vestiaro ed usi della corte, milizia e comuni Turchi", Roma.

## DEKÂ, Aleksandër (*Alexandre Gabriel Decamps*).

Piktor francez (1803 – 1860). Një nga përfaqësuesit më të njohur të romantizmit në Francë. Filloi me vizatime satirike, pastaj vazhdoi me tablo në traditën e pikturës klasike. Pas udhëtimit në disa vende të Ballkanit realizoi tablo, akuaerele dhe vizatime, që e bënë të shquar si specialist të skenave të Lindjes. Vlerësohet si një nga pasuesit më të shquar të Dëlakruasë. Është shkruar, gjithashtu, se në disa vepra, ai ishte po aq gjeni sa edhe E. Dëlakrua. Vitet e fundit të jetës u vendos në Fontenblo pranë "poetit të peizazhit" Kamil Koro (Corot), autor i tablosë së njohur *Shqiptarja*. Gjatë kohës që ishin pranë njëri – tjetrit, është shkruar se Koro, me dëshirën e tij, i dekoroi studion.

A. Dekâ është autor i tablosë *Valltarët shqiptarë*, një

nga më të bukurat me temë shqiptare. Të dhëna plotësuese për tablonë: u pikturua në vitin 1835 (ngjyra vaji 76 × 124 cm). Në fillim ishte pronë e një koleksionisti privat. Në vitin 1960 u ble në Paris për Muzeun e Brestit, ku ruhet ende. Është botuar në katalogun "Romantizmi në pikturën franceze", "Revue de Louvre", Paris, 1964. Është ekspozuar në Luvër (1974 – 1975) dhe në disa muze jashtë Francës (1968 – 1969).

Vepra të tjera: *Grua shqiptare me fëmijë* (1843), *Luftëtarë shqiptarë* (akuarel 29 × 25 cm) (1835), *Fshatar shqiptar* (vizatim), *Shqiptar në dyluftim* (vaj).

Figura të shqiptarëve gjenden edhe në vepra të tjera me temë nga Lindja të A. Dekasë, p.sh. figura e luftëtarit shqiptar me fustanellë të bardhë spikat në tablonë *Truproja pronë e Izmirit*.

"Revue du Louvre", Paris, 1964; "Le Romantisme dans la peinture française", Paris, 1974; Th. Hughes, "Voyage à Janina en Albanie", Paris, 1828; "Histoire générale de l'art", Paris, 1950; "Revue de Brest", 1985, "Les Orientalistes, peintres voyageurs 1828 – 1890", Paris, 1985.

## DODUELL, Eduard (*Edward Dodwell*).

Piktor anglez (1767 – 1832). Ka udhëtuar në disa vende të juglindjes së Evropës dhe me litografitë që realizoi kur u kthye në Londër botoi albume. Në njërin prej tyre janë riprodhuar pamje nga Shqipëria, si dhe shumë figura me kostume kombëtare shqiptare. Vite më vonë veprat e Doduellit janë riprodhuar disa herë në albume. Litografitë origjinale ruhen në Londër dhe në Athinë.

Në një ribotim të veprave të Doduellit në Gjermani më 1982, përmenden edhe piktorët Kokrell e Stakelberg, që gjithashtu kanë bërë tablo për vendin tonë. Aty vihet në dukje interesi i përbashkët ndaj motiveve shqiptare.

E. Dodwell, "A. Classical and Topographical Tour Through 1819", "Views of Greece from Drawings by Edward Dodwell Esq", Londër, 1812; "Klassische Statten und Landschaften in Griechenland", Dortmund, 1982. F. M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

## DOMENIK, Kusto (*Custos Domenicus*).

Grafist i shekullit XVII. Është autori i dy gravurave për Skënderbeun. Janë të vitit 1602 dhe ruhen në një koleksion të njohur në Gjermani. Heroi ynë paraqitet me përkrenaren që njohim sot. Vizatimi është bërë me mjeshtëri. Dallohet nga shumë krijime të tjera për Skënderbeun të shekujve XVII – XVIII për trajtimin grafik shumë realist dhe për lëvizje krejt të veçanta në krahasim edhe me gjithë krijimet e mëvonshme.

"Albanien in Begegnungen", Hamburg, 1986.

## DURHAM, Edit (*Edith Durham*).

Autore angleze (1863 – 1944). E filloi karrierën e saj si piktoresh ilustratore. Në brigjet e Adriatikut, siç ka shkruar vetë, erdhi fillimisht për të pikturuar dhe u lidh ngushtë me jetën, zakonet dhe luftën e popujve për liri. Qëndroi shumë vjet në Ballkan. U njoh me jetën e luftës dhe u kushtoi atyre disa libra me ilustrime.

Kur ishte në Romë, Durhami është takuar me piktorin tonë të Rilindjes Ndoc Martini. Vajza e Kolë Kamësit në Shkodër ruan një kartolinë të N. Martinit, ku njoftohet për këtë takim e për ardhjen e Durhamit në Shqipëri. Ka të dhëna që Martini i ka bërë një portret mikes angleze. Akuarele dhe vizatime të Durhamit janë riprodhuar edhe në libra e revista të ndryshme për të ilustruar shkrime mbi Shqipërinë.

Edith Durham, "High Albania", London, 1909 (ribot. 1985); "The struggle for Scutari", London, 1914; "Some tribal origins and customs of the Balkans", London, 1928; gaz. "Liri e Shqipërisë" Sofie, 1912; "John and Cora Gordon, "Two Vagabonds in Albania", London, 1927; Franz Nopcsa, "Haus und hausrat in Katholischen Nord Albanien", Sarajevo, 1912; Sh. Shaqiri, "Edith Durhami dhe shqiptarët", Nëntori nr. 10, Tiranë, 1981, f. 149.

## DYFRENUA (*Dufrenoy*).

Piktore franceze e shekullit XIX. Në një libër të vitit 1825 ka botuar si ilustrim disa gravura me temë shqiptare. Veç figurave historike si Ali Pashë Tepelena, Marko Boçari, Bubulima etj., që i ka trajtuar në çaste të ndryshme të jetës dhe të veprimtarisë së tyre, Dyfrenua ka realizuar gravura edhe me motive nga jeta e përditshme. Njëra prej tyre titullohet *Gra shqiptare*.

"Beautés de l'histoire de la Grèce moderne", Paris, 1825.

## DYPRE, Lui (*Louis Dupré*).

Piktor francez. Mësimet i mori në studion e piktorit të njohur francez David (Louis David 1748 – 1835). Ka realizuar disa punime në grafikë, akuarel e litografi.

Është autori i portretit më të njohur të Ali Pashë Tepelenës. Në vitin 1819 ai shkoi në Butrint që të realizonte drejtpërdrejt nga natyra portretin që njohim sot. Dypre është edhe autor i disa vizatimeve me figura shqiptarësh të veshur me kostume kombëtare. Disa prej tyre u botuan në librat e Pukëvililit. Më vonë u ribotuan në libra të autorëve të tjerë. Në bazë të vizatimeve, artisti realizoi edhe tablo me ngjyra vaji. Nga riprodhimet në botime të ndryshme mësojmë se edhe në disa tablo me motive nga Greqia ka pikturuar shqiptarë me veshje kombëtare. Litografitë me motive nga vendet e Lindjes ai i botoi në

Paris më 1825 në albumin e titulluar "Udhëtim nga Athina në Kostandinopol", ku përmbledhi disa grafika me temë shqiptare. Origjinalet ruhen në muze të Francës dhe të Greqisë.

Pouqueville, "Histoire de la régénération de la Grèce", Paris, 1825; "Byron", London, 1981; Luis Dupre, "Voyage à Athenes et à Constantinople", Paris, 1825; N. A. Kallaimer, "Of Suliots, Arnauts, Albanians and Eugène Delacroix" në rev. "The Burlington Magazine", London, 1983; "Catalogue of the Arts Council Exhibition in Athens", 1974; F. M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

### DYPRE, Zhan (*Jean Dupré*).

Skulptor toskan me origjinë franceze (1817 – 1882). Studioi për skulpturë në moshë të vogël. Ekspozoi disa buste në Romë që u pritën me interes; pak më vonë ekspozoi në Paris, ku mori edhe medalje (1855). Ka realizuar disa buste dhe monumente që ndodhen në Itali dhe në Francë.

Në vitin 1876 gdhendi në mermer bustin e shkrimtares me origjinë shqiptare Dora d' Istria. Mendohet të jetë i së njëjtës familje me piktorin Lui Dypre.

Nouveau Larousse illustré. Vol. 3, Paris.

### DYRER, Albreht (*Albrecht Durer*).

Piktor dhe grafist gjerman (1471 – 1528). Mjeshtri më i shquar i shkollës gjermane dhe një nga artistët më të mëdhenj të Rilindjes Evropiane. Ndikim të madh në jetën artistike të Dyrerit patën udhëtimet e tij në Vendet e Ulëta dhe në Itali, ku u njoh me kulmet e pikturës së Rilindjes që ishin arritur në ato vende. Duke ruajtur një frymë kombëtare gjermane, ai asimiloi arritjet e piktorëve flamingë, përfitoi nga zbulimet e piktorëve italianë e dha një kontribut të madh në pasurimin e mëtejshëm të artit të Rilindjes me veprat e tij teorike e sidomos me krijimet artistike.

Gjenia e tij u shfaq kryesisht në pikturën me ngjyra vaji, por madhështia e Dyrerit qëndron edhe në gravurat e shumta me metal. Në këtë teknikë mendohet të jetë gdhendur edhe portreti i Gjergj Kastriot – Skënderbeut. Njoftimi i parë në shtypin shqiptar për këtë vepër është dhënë në rev. "Djalëria" të Vjenës, në vitin 1922. Aty është riprodhuar gravura me shënimin *Skënderbegu mbas origjinalit prej Dyrerit*. Ndërsa në dy faqe pas saj janë paraqitur dy fotopllakata që kanë në qendër këtë gravurë të kombinuar edhe me elemente të tjera, si shqiponja dykrenare, ylli me pesë cepa, shpata dhe përkrenarja e Skënderbeut (fotografi nga origjinali), mbishkrimet: *Një për të gjithë, të gjithë për një, Një pikturë autentike e bame*

*me pendë më 1500*. Në fund, të dy fotopllakatet kanë të shënuar: *Foto dhe tableau (tablo) prej ateliesë mbretërore Charles Scolik, Vienë*.

Rev. "Djalëria", Vjenë, 1922; Sven Aurel "Europisk Orient", Helsinki, 1936; "Shënime" nga Odhise Paskali, dorëshkrim, Tiranë, 1976.

### EDMOND, Paul (*Paul Edmond*).

Autor anglez i fillimit të shekullit XX. Ka botuar disa libra me shënime udhëtimi. Në një libër të veçantë, ku përmbledhen mbresat nga udhëtimi në vendin tonë, të ilustruara me 75 grafika, paraqiten pamje të ndryshme nga natyra dhe aspekte të jetës së përditshme.

Paul Edmond, "To the land of the eagle", London, 1927.

### ESTURNEL, Zhozef (*Joseph d'Estournel*).

Autor francez i shekullit XIX. Me mbresat gjatë udhëtimit në vendet e Lindjes së Evropës, botoi një libër të ilustruar me dhjetëra litografi. Njëra prej tyre është me temë shqiptare: *Pamje nga Butrinti*.

Joseph d'Estournel, "Journal d'un voyage en Orient", Paris, 1844.

### FANRIH (*Fahnrich*).

Piktor austriak i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa portrete dhe peizazhe me subjekte nga vendi ynë. Në vitin 1917 udhëtoi nëpër vise të ndryshme të Shqipërisë dhe fiksoi portrete e pamje nga shtëpitë karakteristike, rrugë të hershme si dhe peizazhe nga zonat malore. Disa nga veprat më të mira i dërgoi në një ekspozitë që u organizua në Vjenë në janar 1918.

"Ekspozicion Balkanik n' Universitet të Vjenës", gaz. "Posta e Shqypnis", Shkodër, 1918; H. Ulqini, "Grabitës të monumenteve", Tiranë, 1980.

### FILIPS, Tomas (*Thomas Philips*).

Piktor anglez (1770 – 1845). E filloi karrierën si piktor miniaturash në xham. Rrugën e suksesshme e nisi me studimet në studion e B. Uestit dhe në Akademinë e Londrës. Pas vitit 1790 u bë i njohur si portretist. U zgjodh anëtar i Akademisë Mbretërore më 1808. Veç Galerisë Kombëtare të Portreteve në Londër, edhe shumë muze e galeri arti ruajnë portrete të bukura nga T. Filips. Të portretuarit janë njerëz të ndryshëm: ka midis tyre edhe figura të shquara, si: Xh. Bajron, V. Skot etj.

Me rëndësi për historinë dhe kulturën shqiptare janë portretet që T. Filips i bëri Bajronit.

Tabloja që ndodhet në Galerinë Kombëtare të Portreteve në Londër është pikturuar në ngjyra vaji mbi

kanavacë, me përmasa 76.5 × 63.9 cm. Në të njëjtën teknikë janë pikturuar edhe dy variante të tjera. E dyta ka përmasat 127.5 × 102 cm dhe mban datën 1814. Përmasat më të mëdha në këtë rast kanë bërë të mundur që artisti të bëjë ndryshime nga varianti i parë. Bajroni paraqitet me më shumë trup e rrjedhimisht duken më shumë pjesë të kostumit shqiptar; pjesa e sipërme, me përjashtim të disa ornamenteve të shallit, që ka të lidhur në kokë, thuhet nuk ka ndryshime. Që nga viti 1976 kjo tablo ndodhet në Athinë. Varianti i tretë është në përmasat 46 × 35.2 cm dhe i përket koleksionit të Xhon Murrajt, botuesit të njohur anglez të shekullit XIX.

Pikturimi i kostumit shqiptar në figurën e Bajronit është bërë me të njëjtin adhurim që shpreh poeti në letrat dhe krijimet e tij, ndërsa emocionet që krijohen para saj janë të dyfishta: fiksohet fakti historik që Bajroni qëndronte i veshur me kostum shqiptar, si dhe shprehet admirimi i përbashkët i poetit dhe piktorit, për bukurinë e kostumit tonë.

"Correspondance de Lord Byron", Paris, 1825; Bajron, "Çajld Haroldi", Tiranë, 1973; L. A. Marchand, "Byron's Letters and Journals", London, 1973-76; Andre Serisat, "Lord Byron chez Ali pacha d' Albanie", Paris, 1924. Victoria and Albert Museum, "Byron Catalogue", London, 1974; "Catalogue of the Arts Council exhibition in Athens", 1974; R. Walker, "Regency Portraits", London, 1975; "The Orientalists Delacroix to Matisse", Royal Academy of Arts, London, 1982.

## FËRSTNER, Leopold (*Leopold Förstner*).

Piktor austriak i fillimit të shekullit XX. Gjatë vitit 1917 bëri disa portrete dhe peizazhe në vendin tonë. Në janar të vitit 1918 i paraqiti në Ekspozitën Ballkanike të Universitetit të Vjenës. Tablotë mbi Shqipërinë u vendosën në një pavijon të veçantë të Ekspozitës së madhe Et-nografike dhe Arkeologjike me objekte nga disa vende të Ballkanit. Peizazhet paraqitnin kryesisht shtëpi karakteristike, rrugë dhe pamje nga natyra e vendit tonë, ndërsa në portrete tipa të ndryshëm që piktori takoi gjatë udhëtimit të tij.

"Ekspozicion balkanik n' Universitet të Vjenës", gaz. "Posta e Shqypnies", Shkodër, 1918; H. Ulqini, "Grabitës të monumenteve", Tiranë, 1980.

## FRIEDEL, Adam (*Adam Friedel*).

Piktor danez i shekullit XIX. Dimë pak për forminin e tij si piktor. Ka qenë në Greqi në vitet e revolucionit çlirimtar; atje u miqësua me udhëheqësin grek Ipsilanti. Vizatoi nga natyra disa nga heronjtë e luftës. Më 1825 u vendos në Londër, ku botoi një album me 24 portrete në litografi

me ngjyra. Nga më të bukurat është vlerësuar portreti i Laskarina Bubulinës, realizuar në vitin 1827. Friedel ka pikturuar edhe heronj të tjerë shqiptarë, si: Boçarin, Karaiskain, Miaulin etj.

Th. Greeks, "Twenty - four portraits... in the Greek Revolution", London, 1825 - 1827.

## FRITEL, Pjer (*Pierre Fritel*).

Piktor dhe grafist francez i shekullit XIX. Ka realizuar disa gravura me temë shqiptare. Dy prej tyre janë shtypur në një botim francez të vitit 1876. Në të parën paraqitet një grua nga Prizreni dhe në të dytën një familje shqiptare në portën e shtëpisë. Të gjitha figurat janë të veshura me rroba kombëtare. Janë vizatuar me interes, duke vënë në dukje shumëllojshmërinë e tyre, si dhe pasurinë e ornamenteve.

Elisée Reclus, "Nouvelle Géographie universelle", Paris, 1876.

## GORDON, Kora dhe Xhon (*Cora and John Gordon*).

Çift autorësh anglezë. Në një libër për Shqipërinë kanë botuar rreth 100 grafika, vizatime dhe akuarele. Kryesisht janë bërë nga Kora, e cila ishte piktoresh.

Gjatë vitit 1925 ata udhëtuan në vendin tonë dhe vizatuan pamje të ndryshme nga: Tirana, Elbasani, Berati, Gjirokastra, Përmeti, peizazhe nga Malësitë e Veriut, si dhe shumë portrete. Autorët, si theksojnë edhe vetë, janë përpjekur të japin pamjet me karakteristike.

Në libër janë botuar tri pamje me ngjyra, 40 portrete në tush, 17 peizazhe dhe 42 skena nga jeta e përditshme.

John Gordon and Cora Gordon, "Two Vagabonds in Albania", London, 1927.

## GLER, Charl (*Gleyre Charles*).

Piktor zviceran (1806 - 1874). Studioi në Lion të Bonefordsi (Bonnetfords) (1796 - 1860), në Paris te Hersenti (1776 - 1860) dhe Boningtoni (1801 - 1828), në Romë te Verneti (1789 - 1863). Pas vitit 1834 shkoi në vendet e Lindjes dhe bëri disa tablo me temë nga Greqia, Shqipëria, Turqia dhe Egjipti. Më vonë shkoi edhe në Siri. U kthye në Paris në vitin 1838 gati i verbër.

Nga veprat me temë tonën deri tani njohim *Bujkësja shqiptare* (akuarel 32 × 23.5 cm). Është e vitit 1834. Tani ndodhet në Muzeun e Institutit Luel në Boston.

D. A. Rosenthal, "Orientalism, the Near East in French Painting 1800 - 1880", New York 1982; L. Thornton, "Les orientalistes", Paris, 1984.

## GRANDE, E. (*E. Grandé*).

Piktor francez i fillimit të shekullit XX. Ka ardhur në vendin tonë bashkë me ekspeditat arkeologjike franceze të kryesura nga Leon Rej. Veç objekteve arkeologjike, ka vizatuar e pikturuar pamje nga natyra shqiptare, si dhe vepra të arkitekturës sonë. Disa nga akuarelet dhe vizatimet që realizoi gjatë vitit 1924, i botoi në revistën "Albania" që dilte në Paris atij viti.

"Albania", revue d'archéologie, d'histoire, d'arts, des sciences appliquées en Albanie et dans les Balkans, Paris, 1924.

## GUFJE, Shuazël (*Choiseul – Gouffier*).

Piktor francez i fundit të shekullit XVIII – fillim i shekullit XIX. Pas disa gravurave që bëri në Francë, udhëtoi për të pikturuar pamje dhe kostume nga disa vende të Ballkanit dhe të Azisë së Vogël. Krijimet më të zgjedhura i botoi në albume që u vlerësuan nga bashkëkohësit dhe u ribotuan disa herë.

Kur udhëtoi për Greqi, Gufje vizatoi edhe pamje nga Shqipëria, si dhe disa figura me kostume kombëtare, që i gjeti jo vetëm nëpër vendin tonë por edhe në Athinë apo në vise të tjera greke. Punimet e autorit francez janë nga më të hershmet që njohim deri tani me motive nga vendi ynë. Veç vlerave artistike, shumë nga gravurat kanë interes të veçantë për etnografinë.

Choiseul – Gouffier, "Voyage pittoresque de la Grèce", Tome 1–2, Paris, 1782–1809–1822; Choiseul – Gouffier, "Voyage pittoresque dans l'Empire Ottoman, en Grèce, dans la Troade, les Iles de l'Archipel et sur les côtes de l'Asie mineure" Tome I (1–4), Paris, 1842; R. Pingaud, "Choiseul – Gouffier, La France en Orient sous Louis XVI", Paris, 1887; A. Gjergji në rev. "Kultura Popullore" nr. I/1980; gaz. "Corriere della sera", Milano, 22. IV. 1986.

## HAG, Karl (*Carl Haag*).

Piktor gjerman (1820–1915). Ka studiuar në Nyrenberg dhe në Muni. Për të pikturuar ka vajtur në Belgjikë, në Francë, në Itali, në Egjipt, në Siri dhe në Angli. Në Londër mori pjesë me sukses në disa ekspozita dhe u bë anëtar i Shoqërisë së Piktorëve Britanikë.

Hag ka trajtuar edhe motive shqiptare. Në një nga veprat e tij paraqitet një burrë me veshje kombëtare duke vrapuar. Autori, nëpërmjet një koloriti të ndezur, vë në dukje bukurinë e kostumit shqiptar. Kjo tablo ndodhet në Muzeun Benaki të Athinës.

"Shënim" i prof. Aleks Budës, dorëshkrim, 1986; A. Delivorias, "La guide du Musée – Benaki", Athènes, 1983; A. M. Kolia, Athinë, 1985; E. Benezit, "Dictionnaire des peintres".

## HEJGART, Uiliam (*William Haygarth*).

Grafist anglez (1784–1825). Ka qenë mik i Bajronit. Gjatë qëndrimit në Greqi ai u njoh edhe me shumë shqiptarë, midis të cilëve edhe me shoqëruesin e Bajronit, Dervish Tahirin. Ky shqiptar i la përshtypje jo vetëm për sjelljen dhe kulturën, por edhe për pamjen fizike burrërore, ndaj në vitin 1810 ai i bëri një portret. Grafikën e titulloi *Dervishi – luftëtar shqiptar*.

F. M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

## HESAJMER, Ludvig (*Ludwig Hesshaimer*).

Piktor austriak (1872–1936). Pasi mbaroi shkollën e mesme në Budapest punoi mësues vizatimi. Në moshën 37 vjeç vazhdoi studimet në Institutin e Lartë Grafik, ku përparoi shpejt dhe tërhoqi vëmendjen e botuesve për gravurat dhe vizatimet me motive nga jeta e përditshme.

Gjatë viteve 1917–1918 ai qëndroi disa muaj në vendin tonë dhe realizoi disa grafika. Më e njohura është *Shqiptari, Selvitë e Namazgjahut, Elbasan, Monumente kulture, Tiranë, Viset e Drinit* etj.

Rev. "Vllazinia", Vjenë, 1918; rev. "Djalëria", Vjenë, 1922; "Kujtime" të Prof. Aleks Budës, dorëshkrim, 1985; Friedrich Wallisch, "Albanien und seine Postwertzeichen", Vjenë, 1937.

## HES, Peter fon (*Peter von Hess*).

Piktor gjerman (1792–1871). Autor i disa tablove me temë historike, që ndodhen në Muze të Muniut. Punoi nëntë muaj në Greqi më 1833 për të realizuar tablo me motive nga Revolucioni i vitit 1821. Sipas tablove realizoi edhe disa litografi, që i botoi në një album të veçantë në Gjermani. Pikturoi edhe portrete të luftëtarëve shqiptarë që morën pjesë në Revolucionin Grek. Edhe në tablo të tjera me ngjyra vaji me temë nga Greqia ka pikturuar disa figura shqiptarësh me veshje kombëtare.

G. Finlay, "A. History of Greece", London, 1857; B. Reinhard, "Der Munchner scheachten – und Genremale Peter von Hess"; M. Papanikolau, "Portraits des guerriers de 1821 de Peter von Hess", Athènes, 1980.

## HILER, Zhan (*Jean Baptiste Hilaire*).

Piktor francez (1751–1829). Në Muzeun e Luvrit përfaqësohet kryesisht me vizatime dhe gravura, ndërsa pjesën më të madhe të krijimtarisë e ka në ngjyra vaji. U bë i njohur me tablotë "Muzika" dhe "Leximi", që tani ndodhen të ekspozuara në Muzeun e Luvrit e me tablo të tjera që ruhen në Muzeun e Strasburgut dhe në atë të Grenoblit.

Zh. Hiler është autori i gravurës së njohur *Luftëtarë shqiptarë*. Kjo gravurë është ribotuar në disa botime të



huaja të shekullit XIX, sipas gdhendjes së realizuar në bakër nga J. B. Tillard. Originali ndodhet në Muzeun e Luvrit në Paris.

Choiseul – Gouffier, "Voyage pittoresque de la Grèce, Tomes 1 – 2, Paris, 1782 – 1809 – 1822; Elisée Reclus, "Nouvelle Géographie universelle", Paris, 1876.

## HOROVITC (*Horovitz*).

Piktor austriak i fillimit të shekullit të XX. Ka realizuar disa portrete dhe peizazhe nga Elbasani, Kavaja, Fieri, Berati dhe Shkodra, gjatë viteve 1917 – 1918. Më 30 prill deri më 2 maj 1918, në bashkëpunim me piktorin Pravonticki dhe skulptorin Bescedes, hapi në Shkodër Ekspozitën mbi Shqipërinë. Veprat origjinale autori i mori në vendin e tij pas mbylljes së ekspozitës dhe ndoshta ruhen në ndonjë muze apo koleksion privat në Austri. Mund të ketë ndonjë vepër origjinale dhe në familjet shkodrane.

"Ekspozion pikturash në Shkodër", gaz. "Posta e Shqypnies", Shkodër, 1918.

## HUEL, Zhan (*Jean Houel*).

Piktor e grafist francez (1736 – 1813). Studioi për pikturë në studion e Kazanovës dhe grafikë nën drejtimin e piktorit Leba. Më vonë vajti për studime në Itali. Botoi libra me ilustrime nga udhëtimi i dytë që bëri në Itali. Ilustroi, gjithashtu, edhe libra të tjerë me subjekte të ndryshme.

Në albumin e parë, ku botoi pamje të ndryshme prej udhëtimit të dytë në Itali, ka përmbledhur edhe disa akuarele që bëri në fshatrat arbëreshe. Veç natyrës, ai ka vënë në dukje kostumet e bukura arbëreshe, orendi dhe mjedise karakteristike, ku shihet vazhdimësia e traditës së artit tonë popullor. Vepra ruhen në muze të ndryshme të Francës dhe në koleksione private në Itali dhe në Francë.

Jean Houel, "Voyage pittoresque dans des îles de la Sicile, de Malte et de Lipari", Paris, 1782 – 1787; "Shënime në Kalabri" të Nasho Jorgaqit, dorëshkrim, 1985.

## IRTON (*Irton*).

Grafist francez i shekullit XIX. Në vitet 40 – të të shekullit të kaluar bënte pjesë në grupin e artistëve më të mirë të Londrës dhe të Parisit që angazhoheshin për ilustrimet e librave me pamje nga vendet e ndryshme të botës. Irtoni ka realizuar edhe grafika me pamje nga vendi ynë. Njëra prej tyre titullohet *Burim uji në Delvinë*.

D. C. Wordsworth, "La Grèce pittoresque et historique", Paris, 1841.

## JOVANOVIĆ, Pavël (*Pavle (Pajo) Jovanović*).

Piktor kroat (1859 – 1931). Gjatë periudhës së parë të krijimtarisë u shqua me tablotë ku pasqyrohet jeta piktoreske në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Pas vitit 1893 filloi një seri kompozimesh të konceptuara në formë dekorative. Më vonë (1906) iu kushtua kryesisht gjinisë së portretit. Veprat e tij janë ekspozuar në Vjenë, në Paris, në Romë, në Londër, në Beograd e në Berlin.

Jovanovići ka udhëtuar disa herë në vendin tonë. Në Shkodër ka qëndruar më shumë për t'u njohur me kostumet kombëtare dhe objekte e orendi me ornamentikë të pasur popullore. Nisur nga kjo krijimtari e popullit e nga zakonet e vendit, ai realizoi disa tablo ku pasqyroi me besnikëri tipa dhe karaktere shqiptarësh. Gjatë qëndrimit në Shkodër u miqësua me piktorin tonë të shquar të Rilindjes, Kolë Idromenon. Dashuria për kulturën kombëtare dhe dëshira për t'i pasqyruar ato në art i lidhi ngushtë. Thuhet se në një tablo të Jovanoviçit, Idromenonja ka pikturuar një figurë malësori me veshje kombëtare. Kjo është bërë me kërkesë të Jovanoviçit, në shenjë respekti për kolegun shqiptar.

Mendohet se Jovanoviçi ka realizuar 8 tablo me temë shqiptare. Më të njohura janë: *Vallja e shpatave*, *Këngë për Skënderbeun* (vaj), *Mësimi i shpatës*, *Përgatitja e nuses shqiptare*, *Tregim nga Kosova*, *Vajza me çifteli*, *Lufta e gjelave*. Veprat origjinale me temë shqiptare të Jovanoviçit ruhen në muze dhe galeri të Anglisë, Austrisë dhe të Jugosllavisë.

Shyqyri Nimani, "Kombëtarja si frymëzim piktoral", gaz. "Rilindja", 31 dhjetor 1984, Prishtinë; V. Kolar, Beograd, 1974, f. 28. Enciklopedia Italiane Treccani, Vol XXIX; rev. "Soleil du Dimanche", Paris, 1903; M. Prenushi, "Kolë Idromeno", Tiranë, 1984.

## KAPRIOLO, Aliprado (*Aliprado Capriolo*).

Piktor italian i shekullit XVI. Është marrë me gravurë. Vepra më e rëndësishme e tij është seria e madhe e portreteve të figurave më të shquara të disa vendeve të Evropës. Në vitin 1596 i përmbledhi në një album të titulluar "Portrete të njëqind udhëheqesve të shquar".

Në atë koleksion përfshihet edhe figura e Gjergj Kastrioti – Skënderbeut.

A. Capriolo, "Ritratti di cento capitani illustri", Roma, 1596.

## KARTRAIT, Xhozef (*Joseph Cartwright*).

Piktor anglez (1789 – 1829). Nga viti 1816 deri 1820

punoi si civil në flotën detare angleze dhe u vendos në Korfuz. Gjatë qëndrimit në ishull iu kushtua kryesisht pikturës. Tematika e tij e parapëlqyer ishte pikturimi i pamjeve detare. Pas kthimit në Angli botoi një album me pamje të ishujve të Jonit. Veprat e tij më të bukura ruhen në Akademinë Mbretërore të Arteve, në Shoqërinë e Artistëve Britanikë dhe të Institutit të Arteve të Bukura në Londër. Më 1825 u zgjodh anëtar i Shoqatës së Artistëve Britanikë dhe më 1827 u emërua piktor marine.

Në muzetë që përmendën ndodhen edhe disa vepra me motive nga vendi ynë. Kartrai ka vizatuar peizazhe nga natyra, ku paraqiten figura veshur me kostume kombëtare dhe një litografi mbi Ali pashë Tepelenën. Veprat me temë shqiptare, si dhe të tjerat, u popullarizuan që në gjallje të autorit, nëpërmjet dy albumeve të tij: "Pamje nga ishujt Jonianë" dhe "Kostume të zgjedhura nga Shqipëria dhe Greqia". Kartrai është nga autorët më të hershëm dhe ndër të parët që arriti të botojë edhe albume me pamje nga Shqipëria. Krijimet e tij kanë luajtur një rol me rëndësi edhe për nxitjen e piktorëve të tjerë në trajtimin e temës shqiptare. Disa vepra origjinale me temë shqiptare, veç muzeve të Londrës, ruhen edhe në Muzeun Benaki në Athinë.

J. Cartwright, "Views of the Ionian Islands", London, 1821; J. Cartwright, "Selection of the costumes of Albania and Greece", London, 1822; "Storia della Letteratura del Sud - Est Europeo", Milano, 1970; A. Delivorrias, "Guide du Musée Benaki", Athènes, 1980; N. Kallmyer, "Of Suliots, Arnauts, Albanians and Eugène Delacroix", "The Burlington Magazine", London, 1983; R. Robinson, "Tobacco pipes of Corinth and Athenian Agora", gaz. "Hesperia", 54.2, 1985.

### KASPAR, Paul (*Paul Caspar*).

Grafist austriak i fillimit të këtij shekulli. Ka qëndruar në vendin tonë para vitit 1920. Realizoi disa portrete dhe peizazhe. Veprat origjinale mund të ruhen në familjen e piktorit në Vjenë ose në ndonjë koleksion tjetër. Disa grafika ku paraqiten portrete të malësorëve, si dhe pamje nga qytete të veriut tonë, janë botuar edhe në një revistë shqiptare që dilte në Vjenë. Njëra prej tyre është botuar edhe si kartolinë.

Rev. "Djalëria", Vjenë, 1920.

### KOLE, Aleksandër (*Alexandre Colin*).

Piktor francez (1798 - 1873). Mësoi nën ndikimin e romantikëve Delakrua, Zheriko dhe Bonington, të cilët i përjetësoi edhe në piktura. Më 1825, bashkë me Boningtonin, qëndroi disa kohë në Angli, ku ilustroi me litografi, poemat e Bajronit, të cilat u botuan në Londër më 1833. Disa nga këto litografi ku figurojnë edhe shqiptarë

me veshje kombëtare, u ekspozuan në Galerinë Lebrën në Paris më 1826. Kole nuk ka qenë në vendin tonë, por është njohur me kostumet shqiptare në Paris nga koleksionisti Rober Ogyst ku u mbështetën edhe piktorë të tjerë romantikë.

"Historical illustrations of Lord Bayron's works..., from original Paintings", by A. Colin, London 1833; F. M. Tsikagau, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

### KOLDUELL, E. (*E. Caldwell*).

Autor anglez i shekullit XIX. Gjatë një udhëtimi në vendin tonë ka realizuar disa akuarele dhe grafika me pamje nga natyra. Ka edhe aspekte gjuetie, malësorë shqiptarë bashkë me udhëtarët anglezë etj.

B. Hughes, "Pig shooting in Albania", në rev. "The Burlington Magazine", London, 1896.

### KOKRELL, Çarl (*Charles Robert Cockerell*).

Piktor, arkitekt dhe arkeolog anglez (1788 - 1863). Duke studiuar dhe hulumtuar për botime mbi zbulimet arkeologjike, ai udhëtoi në Greqi, në Shqipëri, në Turqi dhe në Itali, ku bëri zbulime me rëndësi. Kur u kthye në Angli u bë anëtar i njohur i Akademisë dhe pas vitit 1840 profesor i arkitekturës në Akademinë e Londrës. Është autor i disa veprave të rëndësishme arkitekturore si e një muzeu dhe instituti në Oksford, një muzeu në Kembrixh etj. Sot vlerësohet si arkitekt dhe arkeolog i shquar dhe si një nga përfaqësuesit e fundit të neoklasicizmit në Angli.

Me mbresat e shumta gjatë udhëtimit në vendin tonë, në vitin 1813 ai realizoi disa akuarele dhe grafika. Një nga më të bukurat është *Trimat shqiptarë duke ndjekur armikun*, dhe *Berati*. Nga dora e Kokrellit ka dalë dhe një nga portretet më të bukura të Ali pashë Tepelenës, bërë drejtpërdrejt nga natyra. Me interes janë portretet e suliotëve, si dhe disa pamje nga vendi ynë, si ajo e Viroit të Gjirokastrës. Pjesa më e madhe e origjinaleve ruhen në Muzeun Britanik dhe në Institutin Mbretëror të Arkitekturës në Londër.

"Travels in Greece and Albania", by T. S. Hughes, Londër 1820; T. S. Hughes, "Voyage à Janina en Albanie", Paris, 1830; Edward Lear, "Journals of a landscape painter in Albania", London, 1851.

### KORO, Kamij (*Camille Corot*).

Piktor francez (1796 - 1875). Mbahet si një nga mjeshtrit më të mëdhenj të shekullit XIX. Deri vitet e fundit të jetës krijimtaria e tij nuk u çmua aq sa duhet. Në ditët tona veprat e Korosë janë nga më të kërkuarat. Deri më 1979 numëroheshin 49 monografi, 4 katalogë të plotë dhe qindra artikuj e studime. Janë hapur mbi 30 ekspozita vetëm me peizazhet e portretet e tij. Është quajtur "poet

i peizazhit" dhe më "muzikanti i piktorëve francezë". Dallohet për stilin e tij të ndjeshëm, të thjeshtë e të pastër.

Koro është autori i një prej veprave më të bukura me temë shqiptare: *Shqiptarja*. Për realizimin e saj historiani i artit francez Zhan Tomas, në një letër të vitit 1975, shkruan: "Tabloja *Shqiptarja* është pikturuar në janar 1872. Roboja e kishte parë vetë Koronë gjatë kohës që bënte këtë portret (A. Roboja ka qenë dhëndri i piktorit dhe sot mbahet si një nga historiografët më të njohur të Korosë. Ka botuar katalogun në katër vëllime me veprat e plota, F.H.). Autori e pikturoi me përmasat 83×65 cm, por pas një viti u dëmtua në pjesën e poshtme dhe u ngushtua në përmasat që ka sot 74×65 cm. Iu dhurua Muzeut Metropolitan të Nju – Jorkut nga Havemejer. Kostumi shqiptar është zgjedhur për mundësitë pikturoese që i jepte Korosë. Tani ndodhet në Muzeun e Bruklinit në Nju – Jork. Është riprodhuar me ngjyra në përmasa të mëdha në fletë të veçanta, në kalendarë me piktura, në libra dhe në revista arti.

Koro ka realizuar edhe portretin *Haideja* (vajza e im-agjinuar e Ali pashë Tepelenës). *Haideja* u realizua dy vjet para tablos *Shqiptarja*. Është pikturuar me ngjyra vaji. Përmasat 60×44 cm. Ndodhet në Muzeun e Luvrit në Paris.

Jean Leymarie, "Corot", Paris, 1979; "Bildende Kunst", nr. 4, Berlin, 1983; "Albanie nouvelle", nr. 2 Tiranë, 1975; "Shedevri zhivopisi v zarubezhnih sobranijah", Moskva, 1974; D.A. Rosenthal, "Orientalism, the Near East in French Painting", 1800-1880, New-York, 1982; Jean Thomas, "Shënime për tablonë "Shqiptarja", doreshkrimi, Paris, 17.3.1975.

## KORONELI, Vincenzo (*Vinçenzo Maria Coronelli*).

Autor italian i shekullit XVII. Gjeograf zyrtar i Republikës së Venedikut. Më 1680 themeloi shoqërinë e parë të gjeografëve. Më 1684 botoi librin e tij ku paraqiti edhe skica të qyteteve dhe kështjellave të vendit tonë. Veprat e Koronelit janë me rëndësi të madhe për studimet topografike të vendit tonë dhe të Greqisë. Vizatimet për Dur-rësin, Vlorën, Kaninën, Sazanin, Shkodrën etj., janë nga botimet më të hershme për vendin tonë në libra.

V.M. Coronelli, "Citta, Fortezze ed altri luoghi principali dell' Albania, Epiro e Livadia", Venetia, 1689; V.M. Coronelli Isolano, "desiccittiane geografico - istorica...", Venetia, 1696.

## KIRHNER J. (*J. Kirchner*).

Grafist gjerman i shekullit XIX. Në vitet 80-90 ka qenë autor i njohur që krijonte gravura a ilustrime për botues të ndryshëm. Mjaft nga gravurat që ka botuar në

revista e libra kanë qenë me temë shqiptare. Krijimet e grafistit Kirhner u përkasin viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Nga kjo periudhë kemi disa gravura, por punimet e Kirhnerit, ashtu si edhe ato të piktorit Udvil, e paraqesin në një gamë më të gjerë jetën shqiptare të atyre viteve.

"Ilustrierter Führer durch Dalmatien längs der Küste von Albanien", Wien, Pest, Leipzig, 1883; A. Meylan, "A travers l' Albanie", Paris, 1885; "Ilustrierter Führer durch Dalmatien längs", Wien - Pest - Leipzig, 1899; "Besa e Feja e Shqiptarëve të Hershëm", Tiranë, 1927; K. Frashëri, "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", Tiranë, 1980.

## KRIVELI, Karlo (*Carlo Crivelli*).

Piktor italian (1430/1435 – 1493/1495), mësimet e para i mori nga i ati Jakobo. Qëndroi pak kohë në Dalmaci, në Zara (1475), dhe u kthye përfundimisht në Itali më 1467. Është përfaqësues i pikturës dekorative në Rilindjen Italiane. Në pikturimin e tij ndihet stili gotik dhe ai bizantin në një frymë të re. Me përjashtim të pikturave murale, tablote e tjera të Krivel - it janë marrë nga disa muze të njohura të Evropës dhe të Amerikës.

Mjeshtri venecian, i cili në atë kohë ishte piktori më i madh që punonte në Market, në tablonë e tij *Shengjergji vret kuçedrën* (1470) ka pikturuar luftëtarin e shquar shqiptar Gjergj Shqiptarin, që iku pas vdekjes së Skëndërbeut në Fermo të Markeve (Itali) dhe u kthye përsëri në atdhe, ku ra në luftë me pushtuesit osmanë.

Në shekullin e kaluar tabloja u shit nga shpërdoruesit e veprave të artit dhe tani ka përfunduar në Muzeun Isabele Karnter të Bostonit.

Xhois Lusu, "Un partiota albanese in Fermo", botuar në "La nuova Abania", nr. 6, Tiranë, 1974.

## KUK, Henri (*Henry Cook*).

Piktor anglez i fillimit të shekullit të kaluar. Ka realizuar litografi me pamje nga Anglia dhe disa vende të Evropës Juglindore. Është cituar në botime të shekullit si një mjeshtër i pasqyrimin besnik të pamjeve detare.

Disa litografi me temë shqiptare janë botuar në një album (me përmasa të mëdha 64×47 cm.) për Ballkanin. Midis tyre janë dy pamje nga Shkodra, buzë liqenit, Butrinti dhe një kështjellë. Në këto litografi ka edhe figura me veshje kombëtare. Në tekstin që shoqëron veprat artistike citohen vargje të Bajronit për shqiptarët. Litografite e H. Kukut kanë edhe vlera dokumentare historike.

Henry Cook, "Recollections of a Tour in the Ionian Islands, Greece and Constantinople", London, 1853.

## LALIĆ G. (*G. Lallich*).

Piktor i fillimit të shekullit XX. Autor i disa veprave me temë shqiptare. Dy prej tyre janë në Galerinë Nacionale të Artit Modern të Romës; një portret vajze dhe skenë nga një treg shqiptar.

"Shënime" dërguar letër nga Prof; Eraldo Gaudio, Dorëshkrim, Romë, 1985.

## LAMARSH, Stefan (*Stephane Lamarche*).

Grafist francez i fillimit të shekullit XX. Gjatë një udhëtimi në vendin tonë (1916-1917), ka bërë disa vizatime dhe grafika. Katër prej tyre: *Vajzë shqiptare me kostum feste*, *Një shqiptar*, *Fëmijë shqiptar* dhe *Vajzë e re shqiptare* u botuan në Paris më 1927 si ilustrim i një libri me shënime udhëtimi nga vende të Ballkanit.

Pierre Pouget, "Terre d' inconstance et d' acceptation... Albanie, Macedonie, Thessalie", Paris 1921.

## LIPARINI, Ludovik (*Ludovico Lipparini*).

Piktor italian (1780 – 1856). Studimet i bëri në Akademinë e Arteve në Venedik. Pas udhëtimit në Romë dhe në Parma, ai u kthye përfundimisht në Venedik, ku u caktua profesor i pikturës në Akademinë e Artit. Gjatë kësaj kohe realizoi disa nga veprat e tij më të bukura. Në qytetin e tij ishte bërë i njohur që në moshën 15 vjeç. Liparini ka qenë një nga figurat më të shquara të Venedikut, mik i ngushtë me poetin Xh. Leopardi dhe kompozitorin Xh. Rosini. Veprat e tij sot ruhen në disa galeri të njohura të botës.

Një nga tri tablotë më të bukura të gjithë veprimtarisë së tij titullohet *Betimi i Bajronit mbi varrin e Marko Boçarit*. Nëpërmjet kësaj tabloje, Bajroni paraqitet në çastin kur shpreh nderimin për trimin suljot; ndërsa veshja në trupin e Bajronit tregon admirimin e poetit ndaj kulturës sonë popullore.

Tabloja *Betimi i Bajronit pranë varrit të Marko Boçarit* është paraqitur në disa ekspozita, në Itali dhe në vende të tjera. Tani ruhet në Muzeun Çiviko në Trevizo të Italisë. Është me përmasa 260 × 340 cm, me numër inventari 490.

E. Benezit, "Dictionnaire critique et documentaire des peintres, sculpteurs, dessinateurs et graveurs...", Paris, 1956; "Storia della pittura italiana dell' ottocento" Vol. I dhe 3, Milano, 1975; "Corriere della sera", Milano, prill, 1985; Prof. Eugenio Monzato, "Të dhëna mbi tablonë", dorëshkrim, Treviso, 1986; F.M. Tsikagou, "La Grece retrouvée", Paris 1984.



## LIR, Eduard (*Eduard Lear*).

Piktor anglez (1812-1888). Krijimtarinë e ka nisur në moshën 15-vjecare. Në fillim u mor me vizatimin e kafshëve, punoi si piktor në kopshtin zoologjik të Londrës, botoi libra me vizatime të kafshëve dhe të shpendëve, ilustrime të ndryshme etj. Pas vitit 1837 jetoi jasht Anglisë. Udhëtoi për të pikturuar pamje nga Italia, Shqipëria, Greqia, Palestina, Siria, Egjipti e më vonë shkoi edhe në Indi dhe në Cejlon. Në udhëtimet në Lindje për 26 vjet u shoqërua nga shqiptari Gjergj Kokalli. Ribotoi tre libra me vizatime të kafshëve dhe të shpendëve, shtate libra me shënime udhëtimi dhe ilustrime, katër me vjersha. U ka dhënë mësim për pikturë disa autorëve anglzë. Në vitin 1899 me ilustrimet e tij u botuan vjershat e poetit të njohur Alfred Tenison. Pas vdekjes, për Lirin janë shkruar disa dhjetëra libra, qindra studime dhe artikuj, në shumë vende të botës. Me tablotë, akuarelet, litografitë e vizatimet e tij janë hapur 17 ekspozita. Më e rëndësishmja dhe më e plota është Ekspozita Retrospektive, që u organizua nga Akademia e Arteve në Londër me 1985. Me këtë rast ugrumbulluan 6000 punime me ngjyra.

Eduard Liri është një nga autorët që ka realizuar më shumë vepra për Shqipërinë.

Nga veprat më të shquara janë: (ngjyra vaji në kanavacë, 122 × 186 cm.) *Bregdeti ishqipërisë* koleksion privat, Nju - Xhersi, SHBA. Të dyja janë riprodhuar me ngjyra në disa libra dhe revista arti.

Disa nga veprat e tjera *Rrugë për në Elbasan* (akuarel), *Elbasan* (akuarel), *Shkodër*, *Ura e Bahçllëkut* (akuarel), *Kudhës*, *Tepëlenë* (akuarel), *Vlorë* (akuarel). Veprat e mësipërme ndodhen në Departamentin e Pikturës dhe të Artit Grafik të Universitetit të Harvardit. *Bregdeti*

(akuarel), *Shqiptarë pranë ujëvarës* (varianti A, akuarel), *Krua në Tepelenë* (akuarel), *Qafa e Tiranës* (akuarel, koleksion privat, Londër). Ne litografi Eduard Liri ka realizuar këto vepra: *Shkodra, Kruja, Tirana, Durrësi, Berati, Tepelena, Vlora, Himara, Gjirokastra*.

Krijimet e Lirit për Shqipërinë janë paraqitur në disa ekspozita ndërkombëtare të pikturës.

"Edward Lear", *Journals of a Landscape painter in Albania*, London, 1951; "Edward Lear 1912-1888" London, 1985; "Arts and Designs", London, 1985; Lehman "Edward Lear and his world", London, 1977; A. Davidson "Edward Lear landscape painter and poet" London, 1952, F.M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

## LIVORI, Rudolf.

Piktor çek i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa gravura me temë shqiptare. Kryesisht paraqet burra e gra me kostume kombëtare. Dhjetë punime të këtij piktori u riprodhuan në një libër të autorit Karel Sellner për Shqipërinë. Në të njëjtin botim janë riprodhuar edhe rreth 50 vizatime të autorit të librit.

Karel Sellner, "Tajemne e zemi Prihdy ceskehovajcka Albania 1917-1818", Praga, 1925.

## LJUZ, Xhon (John Frederick Levis).

Piktor dhe akuarelist anglez (1805-1876). Vlerësohet si një nga interpretët e parë të temës së Lindjes në Angli. Disa tablo të tij me këtë motiv janë të njohura në artin anglez. Në vitin 1864 ai hyri në Akademinë e Londrës.

Në një botim të huaj është shkruar se në vitin 1841 Ljuz erdhi në vendin tonë. "Shqipëria, si vend i mrekullueshem për artistët dhe kostumet shumë piktoreske shqiptare, thuhet po në atë libër, s'ka dyshim që do të jetë paraqitur me mjeshtëri në një ekspozitë të tij me akuarele".

Capt. J.J. Best, "Excursion in Albania, London. 1842; F.M. Tsikagou, "La Grèce retrouvée", Paris, 1984.

## MAGO, Dominik (Dominique Magaud).

Piktor francez (1817-1899). Eshtë autor i disa tablove dhe vizatimeve që ruhen në muze të ndryshme të Francës. Më i njohur është me pikturat murale që ka bërë në kapelën e vjetër Lazaris dhe në disa salla publike në Marsejë.

Sipas shënimeve, dërguar nga dy muze të Francës, Mago ka realizuar akuarelin *Gra shqiptare*, përmasat 36 × 26 cm, data e realizimit 5 prill 1867. Eshtë blerë nga Muzeu Kortini në Marsejë në vitin 1917, pronë e të cilit është ende. Në këtë punim paraqitet një grua shqiptare në këmbë.

## MARSHAND, Frederik (Frédéric Marchand).

Piktor francez i shekullit tonë. Ka qenë mesues në Liceun e Gjirokastrës dhe në gjimnazin e Tiranës në vitet 20-30 të. Bëri portrete, peizazhe dhe vizatime. Kryesisht pikturonte figura me veshje kombëtare dhe shtëpi karakteristike. Disa botime janë botuar në revistat tona të paraclirimit. Sipas një shënimi të Odhise Paskalit, Marshandi ka hapur ekspozitë vetjake me pamje nga Shqipëria, në Tiranë, në vitin 1936. Vepra të tij mund të gjenden në familje të Gjirokastrës dhe të Tiranës. Pjesën më të madhe autori i mori me vete dhe tani mund të jenë në muze provinciale ose në koleksione private në Francë.

E. Hoxha, "Vite të vegjëlisë - shënime mbi Gjirokastrën, Tirane, 1983; Odhise Paskali "Shënime për ekspozita të autorëve të huaj", Dorëshkrim, Tiranë, 1978; Dh. S. Shuteriqi "Kujtime", dorëshkrim, Tiranë, 1987.

## MARUBI, Pietro (Pietro Marubi).

Arkitekt, piktor dhe fotograf italian (1834-1903). Rreth vitit 1850 u vendos në Shkodër, i ndjekur nga vendi i tij, Piacenza, si garibaldin. Në vendin tonë ai u mor me fotografi, më pak me pikturë, arkitekturë e skulpturë. Me emrin e Marubit lidhet arti i fotografisë sonë, pasi rrugën e tij e vazhdoi Keli dhe Gegë Marubi. P. Marubi ka bërë disa fotografi me vlera të mëdha për historinë shqiptare, si ato nga Kryengritja e Mirditës (1876-1877) dhe nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) që u popullarizuan edhe nga botimi në revista të kohës, "La guerra d' Oriente", "The Illustrated London News", "Illustration" etj.

Krijimtaria e tij në fushën e pikturës dhe të skulpturës njihet më pak. Eshtë shkruar se ka botuar gravurë me temë shqiptare në revistën. "La guerra d' Oriente", por men-



dojmë se e verteta qëndron ndryshe: Marubi ka dërguar për botim fotografi dhe ato janë kthyer në gravura prej grafistëve, pa bërë ndryshime. Në revistën që përmendëm gjenden disa gravura që të kujtojnë foto të njohura të Marubit, por anash tyre është shënuar emri i grafistit A. Bonamore.

Nga punimet në skulpturë, në familjen Marubi në Shkodër, ruhet një portret në gips punuar prej P. Marubit. I portretuari është vjershëtari, këngëtari dhe sazexhiu i njohur shkodran Oso Sela, i mbiquajtur Osja i Faltores.

K. Ulqini, "Gjurmë të historisë kombëtare në fototekën, e Shkodrës, Tiranë, 1982; M. Prenushi, "Osja i Faltores", gaz. "Jeta e Re", Shkodër, 28 janar 1984; Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë, 1985; La guerra d' Oriente", Milano, 1887.

### MATESKU, Peter (*Petre Matescu*).

Piktor dhe grafist rumun (1821-1873). Ka marrë pjesë në Revolucionin Demokratik - Borgjez të vitit 1848. Është autor i disa portreteve, tablove dhe litografive që ruhen në muze dhe në galeri të ndryshme të Rumanisë.

Midis gjithë krijimeve të tij, studiuesit kanë veçuar si veprën më të rëndësishme portretin e shkrimtares e studiuses së njohur me prejardhje shqiptare, Elena Gjika. Piktura është me ngjyra vaji në kanavacë, me përmasat 87,5 x 71,5 cm. Shkrimtarja paraqitet në këmbë, me pendë dhe letër në dorë. Ka frymë romantike, jo vetëm nga qëndrimi por edhe nga peizazhi me det e pemë që i përkund era.

Tabloja ruhet në Galerinë Kombëtare të Bukureshtit.

Mic dictionar enciclopedic, Bucaresti, 1972; The National Gallery Romanian painting in the collection of Art Museum" Bucaresti, 1984.

### MAJAR, D. (*D. Maillart*).

Grafist francez i shekullit XIX. Ka botuar disa grafika me motive nga jeta e popujve të Ballkanit. Sipas shënimeve të botuesve, pjesa më e madhe është në bazë të fotografive. Në disa raste, për një gravurë të veçantë janë përdorur disa foto, kështu që autori, veç përpunimit grafik, ka meritën edhe për organizimin kompozicional. Edhe gravura *Fshatarë shqiptarë në afërsi të Athinës*, është bërë në bazë të fotografive. Autori ka pikturuar me saktësi kostumet popullore dhe ka krijuar marrëdhënie të natyrshme në mes të figurave që janë marrë nga foto të ndryshme.

Elisée Reclus, "Nouvelle Geographie Universelle" Paris, 1876.

### NOJMAN, Stanislav (*Stanislav K. Neumann*).

Poet revolucionar çekoslovak (1875-1947). Konsiderohet ati i fillimeve të realizmit socialist në letërsinë çekoslovake. Njihet si shok pene i M. Gorkit, V. Ma-

jakovskit, R. Rolanit, A. Fransit, H. Barbysit. Gjatë Luftës së Parë Botërore ka qëndruar një vit e gjysmë në Elbasan dhe në Pogradec, ku punoi si sanitar. Kjo i dha mundësi të njihet me jetën shqiptare dhe ta pasqyrojë atë në veprat e tij. Kujtime nga lufta, që kishte filluar ti botonte nëpër revista gjatë viteve 1917-1922, i përmbloodhi në vëllimin me titull "Elbasan" (1922). Përshtypjet si sanitar në rrethin e Pogradecit i përmbloodhi në librin "Berogozhdi" (emër i një fshati) si dhe në 22 poezi me temë shqiptare, të botuara në faqet e shtypit çek (1916). Këto të fundit riqarkulluan më 1927 në veprën "1914-1918 - VJERSHA" të cilat u përhapën në Evropë.

Gjatë qëndrimit në Elbasan, Nojmani përfundoi 35 akuarele dhe pastele me motive elbasanase, të cilat ia kushtonte së shoqes, Bozhena. Ndonëse jetoi në vitet kur gjendja ishte shumë e vështirë, Nojmani dinte të shihte anë të mira të jetës. Në librin e tij ai shkruan se "Në Elbasan kishte edhe plot e plot ditë drite dhe ajri të rrallë. Ato qenë për mua shkollë dhe më mbushën me lumturi. Dhe kështu polargohem nga Elbasani me një ndjenjë mirënjohjeje. Vështrimi im i fundit, kur kthej kryet prapa, është vështrim falenderimi. Vetëm tani po e ndjej pikëllimin e ndarjes..."

Akuarelet e Nojmanit, gjatë gjithë kohës, i ruajti e shoqja Bozhena, në familje. Para disa vjetësh i dorëzoi në Arkivin Qëndror më Pragë ku ndodhen sot.

S.K. Neumann, "Elbasan", Pragë, 1928; S.K. Neumann, Pragë 1949; S.K. Neumann "Berogozhdi" Pragë, 1928; E. Hoxha, "Juaji Enver" Tirane, 1983; Dh. Pilika, "S.K. Nojman, mik zemre i popullit tonë", gaz. "Drita" 6.6.1965; Dh.S. Shuteriqi, "Kujtime", dorëshkrim, Tiranë, 1986, Dh. Pilika, "Kujtime", dorëshkrim, Tiranë, 1987.



### OGYST, Zhyl Rober (*Jules Robert Auguste*).

Skulptor e piktor francez (1789-1859). Në fillim është marrë me skulpturë dhe në vitin 1910 meritoi çmimin e parë në Romë që jepej në Paris. Më vonë e la skulpturën

dhe levroi akuarelin e pastelin. Pas udhetimeve në Shqipëri, në Siri, në Greqi, në Egjipt etj, ai solli jo vetëm punime të shumta në pastel, por edhe një koleksion të pasur me kostume kombëtare, armë dhe objekte të tjera, që ndikuan te piktorët e rinj romantikë që mblidheshin rreth tij. Ai ishte përfaqësuesi i parë i orientalistëve në Francë dhe inspiratori i shumë piktorëve të temës së Lindjes. Muzeu i Orleanit ruan një numër të madh të veprave të tij.

Nga Ogysti, deri sot, njohim vetëm një pastel me temë shqiptare.


Sa herë është shkruar për romantizmin në pikturën franceze, është vënë në krye Ogysti për ndihmesën e tij si inspirator dhe piktor. Ai qëndron në krye të gjithë piktorëve që kanë trajtuar temën shqiptare pasi "peneli" i tij ndihet edhe në shumë vepra të autorëve të tjerë.

"Le néo - classicisme français", Paris, 1974; Michel le Bris, "Journal du romantisme", Paris, 1981; "Delacroix", Milano, 1963; René Hughes "Delacroix ou le combat solitaire", Paris, 1962.

## OPRANDI, Xhorxho (*Giorgio Oprandi*).

Pictor italian i fillimit të shekullit tonë. Lindi në Levore dhe jetoi në Bergamo. Udhëtoi për të pikturuar në disa vende. Është quajtur "kalorës shëtitës i bukurisë natyrore". Ka hapur disa ekspozita vetjake dhe është vlerësuar si një nga piktorët më të shquar të kohës.

Qëndroi disa muaj në vendin tonë dhe bëri më shumë



peizazhe e portrete. Në vitin 1937 me punimet e tij u hap në Romë ekspozita "Shqipëria në tablotë e Xhorxho Oprandit". Aty u ekspozuan portrete dhe peizazhe nga Shkodra, Tirana, Gjirokastra, Llogaraja, Himara e Maliqi, nga malet rrëzë Prespës.

Veprat origjinale të Oprandit ruhen në galeri dhe koleksione private të Italisë. *Mali i Tomorit* ndodhet në familjen e P. Pepos në Tiranë.

"Albania nei quadri di Giorgio Oprandi", Roma, 1939; Giovanni Banfi, "Il pittore Giorgio Oprandi", Roma, 1942, "Kujtime" nga Petraq Pepo, dorëshkrim, Tiranë, 1984.

## ORLIK, Emil (*Emil Orlik*).

Piktor gjerman i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa tablo në ngjyra vaji, gravura e vizatime. Bashkëkohës i mik i aktorit të madh me origjinë shqiptare Aleksandër Moisiu; atij ai i kushtoi disa nga krijimet e tij. Orliku realizoi në vizatim disa portrete nga natyra.

Për aktorin janë realizuar edhe disa vepra të tjera në pikturë, skulpturë e grafikë nga artistë të tjerë bashkëkohës të huaj, si: Henrik Lundi, Lehman Steglitz, A. Stringer, Ferdinand Midi, Rudolf Balu, Kaparik etj. Disa prej këtyre tablove, portreteve e skulpturave janë botuar në librat e shumtë për Moisiun. Origjinalet ruhen në Muzeun e Teatrit të Vjenës, në koleksione private në Austri e në Gjermani.

"Hans Blohm, "Moissi, der Mensch und der Kunstler, Vjenë, 1930.

## PERI, Gembier (*Gambier Parry*).

Autor anglez i shekullit XIX. Botoi disa libra me shënime udhëtimi, të cilat i ilustroi me grafika dhe akuarele. Nga grafikët që realizoi gjatë udhëtimit në Shqipëri, ka riprodhuar dy: *Luftëtarë shqiptarë* dhe *Butrinti*. Për këtë udhëtim u nxit nga krijimtaria e Bajronit. Përballë grafikës që paraqet luftëtarë shqiptarë me fustanellë ka botuar një strofë nga Çajld Haroldi që fillon me vargun *Të rreptë bijtë e shqipes...*

Gambier Parry, "Sketches of a yachting cruise", London, 1889.

## PETROVIÇ, L.E. (*Petroviç, L.F.*).

Grafist i shekullit XIX. Një nga autorët që fiksoi pamje dhe figura shqiptarësh në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në krijimet e tij bie në sy përpjekja për të pikturuar veshjet kombëtare dhe mjedisim karakteristik shqiptar.

K. Frashëri, "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", (album) Tiranë, 1980.

## PINELI, Bartolomeo (*Bartolomeo Pineli*).

Grafist, skulptor e piktor italian (1781-1835). Nisi të studiojë për vizatim që në moshën 11 vjeç në Bolonjë. Mbaroi studimet në Akademinë e Arteve të Romës. Në fillim krijoi në teknikën e akuarelit. Më 1809 publikoi për herë të parë një përmbledhje me pesëdhjetë kostume

piktoreseke incizuar në akuafortë. Pastaj botoi një album me 35 akuarele me pamje nga natyra dhe me kostume popullore. Krijimet më të rëndësishme të Pinelit janë ilustrimet e shumta që bëri për *Historinë romake* (1816), *Historinë e Greqisë* (1821), si dhe gravurat për veprat e Virgjilit, Dantes, Servantesit e T. Tasos.

Në albumet me akuarele dhe akuafortet me kostume popullore Pineli përmbledhi edhe një figurë me kostum, shqiptar, që atij i është dukur tepër piktorik (1809). Sipas shënimit nga Galeria Nazionale e Artit Modern të Romës, në njërin nga veprat e Pinelit paraqitet një arbëreshe nga fshati Vila i Badesës në Abruce, veshur me Kostum karakteristik popullor. Ky fshat u krijua në pjesën e parë të shekullit XVIII me të shpërngulur nga Pigerasi i Bregdetit.

Petit Larousse de la peinture, Vol 2, Paris, 1974; "Shënime" nga Galeria Nazionale e Artit Modern Romë, dorëshkrim, 1985.

### **POKOK, Uiliam** (*William Innes Pocock*).

Piktor anglez i shekullit XIX. Nga familja tij kanë dalë piktorë në zë të temës detare, Pasi udhëtoi, si paraardhësit e tij, në disa shtete të botës, botoi një libër skicash me pamje nga portet dhe bregdetet e shumë vendeve.

Në atë libër me skica u botua edhe një pamje e Durrësit. Origjinali ndodhet në Muzeun Kombëtar të Deteve në Grenuic, Angli.

### **POLAROLI, S.** (*S. Polaroli*).

Piktor italian (1855-1934). Ka qendruar disa vjet në Shkodër. Veç vizatimeve dhe tablove që realizoi me temë shqiptare, u ka dhënë mësim për pikturë artistëve tanë Simon Rrota e Ndoc Martini.

Nga veprat më të njohura të tij është një tablo me figurën e Skënderbeut, e realizuar nga fillimi i shekullit tonë. Heroi paraqitet në këmbë, me shpatën përpara dhe mburojën ku është pikturuar shqipja dykrenare. Kjo tablo është botuar në organe të ndryshme të shtypit tonë të paraçlirimit si dhe në botime të huaja. Është kopjuar më vonë edhe nga piktorë të tjerë. Edhe një monument që është ngritur në Bruksel, sipas vizatimeve të Ibrahim Kodrës, është mbështetur në tablonë e S. Polarolit.

Simon Rrota, "Disa piktorë të vjetër shkoderanë", në buletin "Shkodra", nr. 1, 1961; "Scanderbeg", Paris, 1983.

### **POPOV, G.** (*G. Popov*)

Piktor bullgar i fillimit të shekullit tonë. Gjatë vitit 1937 qëndroi disa kohë në vendin tonë bashkë me skulptorin Pejev për të marrë pjesë në konkursin e monumentit të Skënderbeut. Pikturoi disa portrete dhe peizazhe me temë shqiptare. Sipas shënimeve të O.

Paskalit, ai hapi një ekspozitë të vogël me punimet që realizoi në Shqipëri. Disa vepra origjinale mbetën në Tiranë, të tjerat i mori me vete në Sofje. Bashkë me skulptorin Pejev ai realizoi një bocet për monument të Skënderbeut. Pasi u larguan nga vendi ynë, vajtën në Romë dhe morën pjesë në një konkurs për një statujë të Leonardos da Vinçit. Statuja e Leonardos në Romë është vepër e këtyre dy autorëve bullgarë. Vepra të Popovit gjenden në Galerinë Kombëtare të Arteve në Sofje.

"Kujtime" të O. Paskalit, dorëshkrim, Tiranë, 1979.

### **PRAVOTINCKI** (*Pravotinzky*).

Piktor austriak i fillimit të shekullit XX. Më 1918 bashkë me piktorin Horovitch dhe skulptorin Beshedes ka hapur ekspozitë me piktura për Shqipërinë në Shkodër. Qendroi disa muaj në vendin tonë dhe realizoi tablo të ndryshme, peizazhe dhe ndonjë portret. Nga veprat e tij janë çmuar peizazhet nga Pojani i Fierit.

"Ekspozicion pikturash në Shkodër" në gaz. "Posta e Shqypnis", Shkodër, 1918.

### **RISELBERG, Teo Van** (*Theo van Rysselberghs*).

Piktor, grafist pllakatist e dekorator i njohur belg (1862-1926). Ka udhëtuar në disa vende të Evropës. Me krijimet në gjininë e peizazhit futet në grupin e piktorëve të parë impresionistë. Nga fundi i jetës u intersua kryesisht në lëvrimin e gjinisë së pllakateve dhe të afisheve. Vitet e fundit punoi në Paris, pastaj u vendos përfundimisht në Provancë (krahinë e jugut të Francës).

Në vitin 1897 kaloi nga vendi ynë dhe, sipas një reviste të botuar në Bruksel, thuhet se Riselbergu bëri disa peizazhe nga Shqiperia dhe i paraqiti në ekspozitën e tij vetjake.

"Le paysage albanais dans une exposition d' art", rev. "Albania", Bruxelles, 1900.

### **SAND'HEM, H** (*Sandham*).

Piktor pak i njohur anglez i shekullit XIX. Ka udhëtuar në disa vende të Evropës me qëllim për të sjellë pamje të pikturuara për koleksionistë veprash arti në Londër.

Gjatë qëndrimit në Korfuz pikturoi edhe pamje nga Shqipëria. Më e njohur është tabloja *Shqipëria e parë nga Korfuzi*. Origjinali ruhet në Muzeun Viktoria dhe Albert në Londër, me shifrën 93, H.8.

### **SARZHEN, Xhovani** (*Giovani Sargent*).

Piktor dhe grafist i shekullit XIX. Gjatë udhëtimit në disa vende të Ballkanit, kryesisht në Greqi dhe Shqipëri, realizoi dhjetëra gravura që pasi u gdhendën në dru, u bo-



tuan në dy libra të ilustruar. Në njërin prej atyre librave është shënuar se autorët e gravurave janë piktorët më të mirë të Parisit dhe Londrës. Ndërsa vitet e fundit, botimi që cituam me lart është vlerësuar si një nga librat më të rëndësishëm të ilustruar, me temë nga vendet e Lindjes, i botuar në Perëndim. Aty janë ribotuar edhe disa gravura të Sarzhenit me temë nga vendi ynë. Më të njohurat janë. *Gjirokastra, Bregdeti i Vlorës, Tepelena, Shqiptarë, Kolonë dorike në Apoloni etj.*

"Greece, pictorial, descriptive and historical", London, 1840; "La Grece pittoresque et historique, ancienne et moderne", Paris, 1841; Leone Benedite, "Storia della pittura del secolo XIX", Roma, 1939; "Le livre illustree en Occident", Bruxelles, 1977.

### SELNER, Karel (*Karel Sellner*).

Autor çek. Me mbresat e udhëtimit në vitet 1917-18 botoi një libër mbi Shqipërinë. Bëri edhe disa vizatime nga vendi ynë, kryesisht peizazhe. Rreth pesëdhjetë prej tyre i botoi në libër. Nuk shquhen për vlera artistike, po kanë interes për mjediset e Shqipërisë Veriore. Selner në librin e tij botoi edhe 10 gravura me temë shqiptare të piktorit Rudolf Lovori.

Karel Sellner, "V Fajmne zemi Prihody zeskehovojka Albania 1917-18", Pragë, 1925.

### SKIAVONI, Felice (*Felice Schiavoni*).

Piktor venecian i shekullit XIX. Është bërë i njohur për temën historike. Ka patur miqësi me shkrimtarin dhe studiuesen me prejardhje shqiptare Elena Gjika, së cilës, në bashkëpunim me piktorin Adolfo Salmoni, i bëri një portret me ngjyrë vaji. Skiavoni ka bërë edhe një tablo me temë nga historia e popullit tonë. Më 29 dhjetor 1866, Elena Gjika i shkruan De Radës nga Venadiku: "Zoti Felice Skiavoni, piktori i shquar i Venedikut për subjekte nga historia, ka filluar sipas këshillimeve të mia, një tablo që simbolizon sprovat dhe përtëritjen e Shqipërisë".

Deri tani nuk kemi të dhëna të mëtejshme për fatin e kësaj pikturë. Ndoshta ndodhet në ndonjë muze ose koleksion privat të Venedikut.

Në krijimtarinë e tij bëjnë pjesë edhe disa litografi me motive shqiptare. Nga më të njohurat janë: *Oficer shqiptar Jeniçer shqiptar*.

O.M. Stackelberg, "Costume et usage des peuples de la Grece moderne", Paris, 1825; A. Gjergji, rev. "Kultura Popullore", nr. 1, Tiranë, 1980.

### SHTIMER, Tobias (*Tobias Stimmer*).

Piktor dhe grafist zvicerian (1539-1584). Ka qenë më i madhi i dymbëdhjetë fëmijëve të Kristofor Shtimerit, grafist i njohur i viteve 1540-1562. Tobiasi studioi për

pikturë në Zyrih te piktori Hans Asper. Krijimtaria e tij e gjerë përfshin piktura me ngjyra vaji, afreske për ndërtime me rëndësi, që sot janë në muze, dhe qindra gravura të gdhendura në metal, të cilat i paraqiti te botues të ndryshëm në Strasburg. Ndër krijimet më të mira të tij njihet seria e portreteve të disa njerëzve të shquar. Në këtë seri hyn edhe portreti që paraqet Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot - Skënderbeun. Ky portret është botuar në përkthimin gjermanisht të veprës së Paolo Jovit "Lëvdime për burrat e shquar".

Paolo Jovi, "Elogia Virorum bellica virtute illustrate", Venedik, 1561; H. Ulqini, "Pikturë të hershëm të Skënderbeut", gaz. "Zëri i Rinisë", Tiranë, 1985. Aleks Buda, "Shkrime historike", vëll. 1, Tiranë, 1987. Fondi De Rada, AQSH, Tiranë, Dosja nr. 338536.54/1; Vehbi Bala, "Jeta e Elena Gjikes", Tiranë 1967.

### SKOTI, M.I. (*M.I. Scotti*).

Piktor italian (1814-1861). Ka punuar në Venedik. Një nga tablotë e tij më të njohura titullohet *Karnavalet në Venedik*, realizuar në vitin 1839.. E vetmja figurë e plotë, në plan të parë, është ajo e një shqiptari me veshje kombëtare, e cila spikat me ngjyrat e kostumit dhe ornamentet. Kjo tablo ruhet në Galerinë e njohur Tretjakov të Moskës. Është riprodhuar në libra dhe revista arti, si dhe në kartolina.

M.I. Scotti, "Karnavalet në Venedik", kartolinë, Moskë, 1958.

### SKOTIN, G. (*G. Scotin*).

Piktor i shekullit XVIII. Është autor i disa gravurave me motive nga Evropa. Vepra më e rëndësishme e tij mbetet një album i botuar në vitin 1715, ku përmbledhi 100 gravura me figura të veshura me kostume kombëtare. Aty u riprodhuan edhe figura shqiptarësh. Njihen dy prej tyre, që janë ribotuar në revista të mëvonshme. Titullohen: *Ushtar i hershëm shqiptar*, dhe *Fshatar shqiptar*. Thuhet se G. Skotin ka realizuar edhe një portret të Skënderbeut.

"Explication des cents estampes qui representent differentes nations du Levant", Paris, 1715; "Le vie d' Italia", Romë, 1940.

### STAKELBERG, Oto fon (*Otto Magnus von Stackelberg*).

Piktor francez (1787-1837). Ka udhëtuar në disa vende të Ballkanit. Shfaqti interes për veshjet kombëtare dhe veçori të tjera karakteristike të popujve. Botoi albume me litografi me ngjyra.

### SHMALIR, Lalar (*Laller Schmalir*).

Grafist austriak. Udhëtoi në vendin tonë në vitet 1909-1910, bashkë me Paul Sieberk, autor i një libri për Shqipërinë. Disa nga vizatimet që bëri gjatë atij udhëtimit,

i botoi si ilustrim të librit të sapopërmendur. Kryesisht janë pamje nga Shkodra (*Ura e Mesit, Kështjella Rozafa*), figura malësorësh etj Shmalir është një nga autorët që ka vizatuar në prag të kryengritjeve të mëdha për pavarësinë, prandaj jehona e tyre ndihet në të gjitha vizatimet e tij. Në një vizatim paraqitet një grup burrash, që të jep përshtypjen e grumbullimit para fillimit të kryengritjes.


Paul Sieberk, "Albanien und die Albanesen", Vjenë, 1910.

## SHEFER, Hendrik (*Hendrik Scheffer*).

Piktor francez me origjinë holandeze (1798-1862). Mësimet e para për pikturë i mori nga i ati. Më vonë studioi në atelienë e njohur Geren në Paris bashkë me vëllanë e madh, piktorin e njohur Ari Shefer. Ka punuar në një stil të përafërt me të vëllanë. Realizoi disa tablo për kishat e Parisit dhe në sallën historike të Muzeut të Versajës pikturot *Hyrja e Zhan d' Arkës në Orleani*. I biri i tij, Arnoldi, u bë piktor i njohur. Bëri portrete dhe tablo historike. Vdiq në Venecie më 1873.

Për realizimin e punimeve me temë shqiptare mendojmë se është ndikuar nga vëllai i tij i madh, Ari Shefer, autori i tablosë së shquar *Gratë suljote* dhe i disa skicave, etydave e vizatimeve, që ruhen si vepra më vete. Deri tani nga Hendriku njohim tablonë *Haideja*. Është e njëjta figurë që realizoi edhe bashkëkohësi i tij, mjeshtri K. Koro.

Enciklopedia italiane Treccani, Romë, 1929.



## SHEFER, Ari (*Ary Scheffer*).

Piktor holandez (1799-1858). Mësimet e para i mori nga i ati, piktor me origjinë gjermane. Që në moshën

12-vjecare A. Shefer ekspozoi më Amsterdam një tablo me temë historike që tërhoqi vëmendjen e personaliteve më të shquara të kohës. Më vonë shkoi në Paris, aty ku mësuat dhe Zheriko, Dëlakrua dhe Dëlarosh, me të cilët lidhi miqësi të ngushtë. Në ndikimin e tyre ai u bë një nga përfaqësuesit më të shquar të romantizmit. Ka dhënë mësim për pikturë në Orlean. Pas vdekjes është konsideruar si kreu i shkollës romantike holandeze.

Më e shquara nga veprat e periudhës së pjekurisë së tij atistike është quajtur tabloja me motiv shqiptar *Gratë suljote*.

Ëstë relizuar në vitin 1827 dhe u ekspozua në Sallonin e Parisit. Po atë vit u ble nga shteti për Muzeun e Luksemburgut dhe më vonë u vendos në Muzeun e Luvrit ku ndodhet edhe sot. U ekspozua përsëri më 1859 ngë vit pas vdekjes së autorit, bashkë me pjesën më të madhe të krijimeve të tij. Katalogu me veprat kryesore, ku u botua *Gratë suljote*, brenda një kihe të shkurtër është ribotuar pesë herë në Paris. Kjo tablo është edhe grafurë e litografi. Për realizimin e pikturës autori bëri disa skica, vazatime dhe etyde, që kanë vlera artistike. Disa prej tyre ryhen në muze të Francës. Në Muzeun e Institutit Holandez të Parisit gjendet vizatimi i plotë i tablosë dhe një vizatim që paraqet më suljote me vajzën e saj, në castin që hidhet nga shkëmbi.

Nouveau Larousse illustré, Paris, vol. 7; La grande encyclopédie, Paris, vol. 9; "Storia della pittura del secolo XIX", de Léonce Beneite, Roma, 1939; Petit Larousse de la peinture, vol. 2, Paris, 1979; rev. "Shqiptarja e Re" nr. 10 1981.

## SHILA, Otakar.

Piktor çek i fillimit të shekullit XX. Në vitin 1929 erdhi në vendin tonë për të pikturuar pamje të natyrës dhe subjekte të jetës shqiptare. Realizoi tablo me ngjyra vaji. I ka paraqitur në Pragë, në ekspozita vetjake dhe të përbashkëta. Tani veprat me motive shqiptare ruhen në familjen e piktorit në Çeki. Nje nga këto punime origjinale gjendet në familjen. K. Myzyri në Tirnë, dhuruar prej vetë piktorit. Paraqet një djalosh nga Kërraba, të veshur me kostum popullor.

"Shënime të marra nga Kujtim Myzyri Tirnë 1985.

## URBAN Herman.

Piktor gjerman (1866-1946). Një nga nxënësit më të mirë të piktorit të shquar Arnold Bëklin. Punoi në Munih, në Itali, në Sicili dhe përfundimisht u vendos në Munih. Veprat e tij ruhen në muze dhe koleksione private në Gjermani dhe në Hyngari.

Para vitit 1900 ka unhëtuar në vendin tonë dhe pikturoi disa peizazhe me pamje nga natyra e zonës malore. Me ato krijime hapi një ekspozitë, në Munih, në vitin 1900.

"Le paysage albanais ä une exposition d' art a Munich", rev.  
"Albania" Bruxelles, 1900.

## UOLLKER, Meri A. (*Mary Adelaide Walker*).

Autore angleze e shekullit XIX. Ka shkruar libra me shënime undhëtimi të ilustruara me litografi, për disa vende të Ballkanit. Nga trajtimi artistik dhe koncepti i botimit, libri dhe litografitë e saj të kujtojnë Eduard Lirin, pro nuk arrijnë nivelin e tij artistik. Litografitë për Shqipërinë kanë vlerë historike dhe etnografike. Në njërin prej tyre janë vizatuar tri gra dhe një vajzë e vojël, të veshura me kostume kombëtare.

Mary Adelaide Walker, "Through Macedonia to the Albanian Lakes" London, 1864.

## UDVIL, Ketën R. (*Caton R. Woodville*).

Piktor amerikan (1856-1927). Studimet për pikturë i mbaroi në Dyseldorf (Gjermani), ku qëndroi përfundimisht. Nga Gjermania ai shëtit në disa vende. Në historinë e artit, Udvili është vlerësuar se një piktor që trajtoi me ndjenjë jetën e njërëzve të thjishtë.

Me motive të tilla edhe krijimet e tij për Shqipëri në. Pamjet na japin atmosferën e krogës dhe mjedisin ku jetonin e punonin njërëzit e thjeshtë. Udvili është gjithashtu autor i krijimeve më të bukiura për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit të cilat i realizoi i frymëzuar nga një udhëtim që bëri në vendin tonë, në ato vite dhe në ato zona, ku ishte ndezur zjarri i luftës për liri.

Disa nga veprat më të njohura të Udvilit janë *Në varrin e Skënderbeut në Lezhë, Mirditorë pranë Liqenit të Shkodrës, Grua nga qyteri, Roja kufitare, Roge në shërbim, Darkë në male, Hani buzë rrugës, Nik Leka udhëheqës i Kelmendëve, Hyrja në një fshat shqiptar, Të mos Kalojë armiku, Këngë për trimat, Në pazarin e Shkodrës, Hakmarrja, Drejt berejës etj.* Në pikturë *Kthimi i luftëtarit, Balonat, Këngë për luftëtarët e lirisë etj.*

Veprat origjinale ndodhen në muze dhe në koleksione private në Angli, në Gjermani dhe në Amerikë.

"Shribner's Monthly" Vol. XXI. New-York, 1881 rev.  
"Kultura Popullore" nr.1, Tiranë 1981; rev. "Opinga" nr. 2, Boulogne, 1920.

## UILLIAMS, H.U. (*H.W. Williams*).

Piktor anglez. (1773-1829). Në vitin 1819 bëri një udhëtim në Itali, Shqipëri dhe Greqi. Pas një viti botoi në Londër librin "Udhëtim në Itali, Greqi dhe në Ishujt jonianë", në dy vëllime, ku përshkruan se çfarë pa në këto vende. Që në konceptim, libri ndryshon nga ata të udhëtarëve të tjerë. Si piktor, Uilliamsi interesin më të madh e tregoi për veprat e artit. Po t'u hedhësh një sy titujve të kapitujve të shumtë të librit, do të lexosh kryesisht emra të monumenteve, galerive dhe muzeve të artit, të piktorëve dhe skulptorëve të njohur të Antikitetit dhe të Rilindjes.

Libri është ilustruar me gravura të vetë autorit dhe në vëllimin e dytë paraqitet edhe një luftëtar shqiptar me veshje kombëtare.

Pas nëntë vjetësh, Uilliamsi shprehu përshtypjet e këtij udhëtimi në një formë tjetër me gjuhën e pikturës. Më 1829 ai botoi përsëri në dy vëllime, një album me pamje të zgjedhura nga vendet që vizitoi. Nga më të bukurat janë tri peizazhe nga bregdeti i Vlorës.

Në faqet përballë gravurave me motive nga vendi ynë, Uilliamsi ka botuar vargje nga poema "Cajld Haroldi" e Bajronit, ku flitet për Shqipërinë dhe shqiptarët. Më 1822 Uilliamsi ekspozoi në Edinburg krijimet e tij të zgjedhura. Pjesa më e madhe e atyre veprave ruhet në Galerinë Kombëtare të Skocisë, në Edinburg.

H.W. Williams, "Trevels in Italy, Greece, and the Ionian Islands" Edinburgh, Vol.1 dhe 2, 1820; H.W. Williams, "Select views in Greece with classical illustrations" London 1829, vol.1 dhe 2; "Views in Greece, Italy, Sicily and the Ionian Islands, Painted in watercolours by H.W. Williams, Catalogue", Edinburgh 1822.

## VALERIO, Teodor (*Theodore Valerio*).

Piktor dhe grafist francez. (1819-1879). Në fillim nxënës pastaj mik me piktorin e njohur Sharle (Nicolas Charlet 1792-1845), autor i tablosë së njohur *Episod nga tërheqja prej Rusisë*, për të cilën Dëlakrua kishte shprehur admirim të vaçantë. Bashkë me mësuesin e tij, ai shëtit disa vende dhe realizoi dhjetëra tablo e grafika. Pas vitit 1852 e tërhoqi lufta në Ballkan. Me gjithë rreziqet e mëdha, ndërmoi disa udhëtime, pikërisht në zonat ku bëheshin luftimet. Gravurat e para i botoi te revista e ilustruar "La guerra d' Oriente".

Në atë revistë botoi edhe gravura me temë shqiptare. Sipas datave të shënuara poshtë grafikave, mësohet se Valerio ka qenë më se një herë në vendin tonë. Veprat më të njohura janë *Çift shqiptar nga Jugu (1875) Rrugës për në Shkodër (1877), Kapedan shqiptar (1885), Baresha*

shqiptare (1887). Me motivet e gravurave që realizoi në vendin tonë, T. Valerio kur u kthye në studion e tij në Paris pikturoi edhe disa tablo me ngjyra vaji.

"Le tour du monde" Paris, 1887; "La guerra d' Oriente", Milano 1876-78; gaz. "Liri e Shqipërisë" Sofje, 1911; rev. "Përparimi" New-York 1919.

### **VEBER Th. (Th. Weber).**

Grafist austriak i shekullit XIX. ka realizuar disa gravura me pamje nga vendet e Ballkanit. Përgjithësisht dallohet për frymën romantike në trajtimin e peizazheve. Zgjedh motive dhe këndvështrime tërheqëse, me pamje madhështore. E këtij Karakteri është dhe gravura Himara që është një punimet më të bukura mbi rivierën shqiptare. Realizuar në viter 70-të të shekullit të kaluar, u popullarizua shpejt, dhe u botua në dy revista të ilustruara nga më të njohurat e atyre viteve. "Tour du monde" dhe "La guerra d' oriente".

### **VERONEZE, Paolo (Paolo Veronese).**

Piktore italian. (1528-1588). Një nga mjeshtrit më të shquar të shkollës veneciane dhe të gjithë Rilindjes. Në fillim u ndikua nga tablotë e Ticianit, pastaj mësoi edhe nga mjeshtria e Rafaelit dhe Mikelanxhelos, duke riprodhuar vepra të tyre. Më 1555 u vendos përfundimisht në Venedik. Aty realizoi krijimet e tij më të bukura. Nga vepra në vepër shfaqet stili i tij karakteristik, i cili dallohet për arkitekturë në kompozim dhe për tonet e leta. Bashkë me Ticianin e Tintoretton, ai përbën, treshen kulmore të shkollës së pikturës veneciane. Virtuoziteti i tij në pikturimin dritës që penetron bukur midis figurave dhe objekteve, veçanërisht në tablotë e yogla që realizoi nga fundi i jetës, e bën atë po aq të madh sa dhe dy mjeshtrit e tjerë.

Në Venedik, ku jetoi e punoi Varoneze, vanonin edhe shumë familje shqiptare, që u shtuan pas vdekjes së Skënderbeut. Çdo qëndresë kundër osmanëve në Shqipëri festohej edhe atje së bashku me bashkëqytetarët, italianë, simptizantë të luftëtarëve tanë, që pengonin marshimin osman drejt Gadishullit italian. Është shkruar se qëndresa e Shkodrës (1479) ku mbetën të vrarë mijëra osmanë, u festua në Venedik me ngritjen e flamurit në bazilikën e shën-Markut. Si vazhdë e këtij manifestimi, vite më vonë Veroneze realizoi në pallatin e Dozhëve një pikturë murale. Aty jepet një aspekt nga beteja për mbrojtjen e Shkodrës.

"Skënderbegu mbas gojëdhanash", Shkodër, 1926; Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Album, Tiranë, 1968; A. Buda, "Shkrime Historike" vëll. I, Tiranë, 1987.

### **VIDAR, Frede (Frede Vidar).**

Piktore gjermane e fillimit të shekullit XX. Në një tablo të vetme paraqet disa objekte të kulturës sonë, si Urëne Mesit dhe monumente të tjere. Riprodhimi me ngjyra i kësaj vepre është botuar në një revistë të huaj të ilustruar, të vitit 1937.

### **VITA, Mario.**

Skulptor italian i fillimit të shekullit XX. Ka realizuar disa vepra në bronz dhe mermer, që ruhen në Romë. Ka bërë edhe gdhendje artistike me subjekte nga vendi ynë. Dy nga veprat më të njohura janë busti i Skënderbeut dhe një portret i Aleksandër Moisiut.

### **VLIET J.G.V.**

Piktore holandez i shekullit XVII. Një nga nxënësit e njohur të Rembrandit. Punoi në atelienë e mjeshtrit të madh të Delft dhe Lieden, që nga viti 1610 deri më 1635. Mësoi artin e pikturimit të portreteve, por luajti rol me rëndësi e dhe në përhapean dhe vlerësimin e veprave të Rembrandit, ashtu sic bënë edhe shumë nxënës të tjerë të shkollës së tij.

Në serinë e portreteve, që punoi nën drejtimin e Rembrandit, është vlerësuar edhe portreti që bëri për Heroin tonë Kombëtar, Skënderbeun. Njoftimin e parë për këtë vepër na e ka dhënë hulumtuesi kosovar Ismail Bytyçi në artikullin e botuar në Prishtinë "Edhe një portret i rrellë i Skënderbeut". Bytyçi e ka parë në ekspozitën e hapur në 1971 në qytetin Buchen (Buchen) të RF Gjermane, organizuar me rastin e 300-vjetorit të lindjes së Gotfrid Buselit, themeluesit të muzeut të këtij qyteti. Në koleksionin e pasur të muzeut, në numrin 51, në radhën e 137 punimeve, u vendos portreti i Heroit tonë Kombëtar.

Ismail Bytyçi, "Edhe një portret i rrellë i Skënderbeut", gaz. "Riindja", Prishtinë, 1982. Vehdi Bala, "Një portret i Skënderbeut" gaz. "Drita", Tiranë, 1982.

### **VOGAN, Robert (Robert Vogan).**

Piktore dhe grafist anglez (1600-1663-1678). Ka realizuar shumë gdhendje në bakër. Nga krijimet më të njohura janë cikli i portreteve të njerëzve më të shquar të historisë botërore, që u botua në një album të veçantë që më 1622, me shënime për secilën figurë. Vogan ka gdhendur edhe portretin e Skënderbeut. Gravurat e mësipërme u stampuan në botimin anglisht të veprës së poetit e shkrimtarit francez Xhorzh Skyderi (G. Scudery) "Curis Politae or the Apologies of Gervarull Prices". Gravura e Skënderbeut është shoqëruar me një biografi prej 12 faqesh.

K. Frashëri, "Skënderbeu i Vogenit" gaz. "Drita" 24.2.85;  
G. Scudery "Curis Politae or the Apologies of Gervarull  
Prices", London 1654.

## FOGEL Ludvig (*Ludvig Vogel*).

Piktor zviceran. 1788-1879). Autor i disa tablove me temë historike. Nga më të njohurt janë disa kompozime dhe litografi kushtuar Revolucionit Grek të vitit 1821. Në tablonë më të rëndësishme të tij, pikturoi edhe figura shqiptarësh. Sic është shkruar në dy botime të huaja, piktorit Vogel i ka pozuar edhe djali i Marko Boçarit, të cilin e takoi më 1830 në Zyrih.

"Neue Züricher Zeitung", 14.2.1944; F.M. Tsikagou, "La Grece retrouvée", Paris 1984.

## XHEL, Uiliam (*Gelli William*).

Autor anglez (1777-1836). Në fillim studioi në Kembrixh, pastaj mbaroi Akademinë Mbretërore të Londrës. Punoi si arkeolog. Vizitoi Trojën më 1801 dhe botoi më 1804 librin "Topografia e Trojës". Më vonë botoi libra të tjerë mbi Italinë, Greqnë dhe Morenë. Vitet e fundit të jetës (pas 1820-ës) i kaloi në Itali ku botoi vepra për Pompeun dhe topografinë e Romës.

Gjatë këtyre udhëtimeve, Xheli bëri shumë vizatime. Një pjesë të tyre i riprodhoi në librat e tij, ndërsa blloqet me vizatimet origjinale ruhen në Muzeun Britanik në Londër, Në atoblloqe ka vizatime me pamje nga vendi ynë. Sipas disa shenimeve dërguar nga Muzeu Britanik vizatimet me subjekte nga Shqipëria ruhen në Sektorin e Arkeologjisë Greke dhe Romake të Muzeut, nën shifrat LB II 209,13 (26a); LB II 186,(19); LB II 197,6 (55).

Catalogue of Drawings, by British Artists, Vol II D-H;  
"Shënime" dërguar nga Muzeu Britanik, Londër, 1985.

## ZUKI, Françesko (*Francesco Zucochi*)

(1692-1764) Pjesëtar i familjes së njohur të piktorëve e grafistëve italianë të shekullit XVIII. Lindi dhe jetoi në Venedik. Edhe dy fëmijët e tij, Karlo e Lorenco, u bënë të njohur. Po përqësuesi më i shquar i gjithë familjes Zuki u bë nipi i Françeskos, Xhuzepe Karlo. Françesko realizoi edhe një numër të madh gravurash të gdhendura në metal.

Në këtë teknikë ai ka realizuar një portret të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

G. Biemmi, "Istoria di Giorgio Castriote detto Scanderbegh..." In Brescia, 1742, 1756.

## ZHEFARI, H.

(-1753). I njohur si Zhefarov, herë - herë Zhefaroviç. Ka lindur në Dorjan të Maqedonisë (sot në Greqi). Thuhet se ishte vllah. Ai e quante veten bullgar. Bëri emër si piktor ikonograf në viset danubiane. Duket në krijimtarinë e tij

ndikimi perëndimor. Udhëtoi shpesh nëpër Evropën Qendrore, sidomos në Vjenë, në Budapest e gjetiu. Udhëtimin e tij të fundit e bëri më 1753 në Rusi dhe atë vit vdiq në Moskë. Kishte lindur përpara vitit 1689. Zhefari është bërë i njohur me librin stematologjik për Ballkanin, në të cilin përfaqësohen edhe stemat e familjeve të mëdha feudale shqiptare si Kastriotët dhe Dukagjinët (botuar më 1741). Ky libër e lidh me lëvizjen antiosmane për çlirimin e popujve të Ballkanit. Zhefari u njoh si grafist. Si i tillë ai botoi gravura të shumta, përgjithësisht me përmbajtje fetare. Me këto gravura lidhet ngushtë edhe me Shqipërinë. Ka përfytyruar në to qytetet e Voskopojës, të Elbasanit e të Beratit, por edhe Pogradecin edhe fshatrat pranë tij, Shën-Pandeleimon (Tushemisht), Peshkëpi, Shën-Naum etj. Nuk ka të dhëna që të ketë qenë në Shqipëri, por këto gravura që u përkasin viteve 40-41 të shekullit XVIII, janë bërë në bazë të një informimi të saktë mbi paraqitjen e vendeve. Artisti këtë informim mund ta ketë nge vendasit, por mund edhe të ketë udhëtuar në viset që ka vizatuar. Ka bërë gravurat mbi jetën e Shën-Jon Vladimirit të Elbasanit. Disa nga këto gravura kanë qenë riprodhuar edhe të ne.

Dh. S. Shuteriqi, "Shënime nga disa botime të huaja", Dorrëshkrim, Tiranë 1986; "Balcans Stary", Selanik, 1976, nr. 1.



## ZHEROM, Leon (*Leon Gérom*).

Piktor dhe skulptor francez (1824-1904). Nxënës i piktorit të njohur Pol Dëlarosh. U shqua edhe vetë si mjeshtër që në krijimet e para. Pas udhëtimit që bëri në Lindje, ku e tërhoqën ngjyrat dhe bukuria e kostumeve,

si dhe peizazhi plot dritë, ai e përqendroi krijimtarinë mbi këto motive. Realizoi shumë tablo dhe, sa herë që i ekspozonte, fitonte admirimin e shikuesve, të studiuesve dhe historianëve, që vazhdimisht shkruanin për "mjeshtërinë e këtij piktori, i cili sillte me vërtetësi skena nga Lindja". Tablotë e Zheromit, përgjithësisht në përmasa të vogla, janë vlerësuar si "mjaft piktorike", të kompozuar bukur dhe me një fakturë të pasur. Në vitin 1863 Zherom u bë profesor i pikturës në Shkollën e Arteve të Bukura në Paris dhe prej studios së tij kanë dalë disa piktorë të njohur.

Veprat me motive nga vendi ynë i realizoi gjatë udhëtimit në Lindje. Ato dallohen për realisimin me vërtetësi të tipareve dhe të mjedisit kombëtar.

Jo vetëm për numrin e tablove dhe rëndësinë e personalitetit të tij, por dhe për vlerat e trajtimit artistik, Zheromi bën pjesë midis autorëve më të shquar të temës shqiptare. Nëpërmjet veprave bindesh se ai e ka njohur mirë botën e shqiptarit të atyre viteve. Tabotë më të njohura janë *Shqiptarë duke kënduar*, *Shqiptarë që luajnë shah*, *Shqiptarë në shtëpinë e prijësit të tyre*, *Në çlodhje*, *Shqiptarë në Kajro*, *Luftëtarë shqiptarë*, *Shqiptarë me fustanellë*, *Shqiptarë duke pirë duhan*, *I burgosuri*. Pas betejës. Të gjitha janë pikturuar në ngjyrë vaji. Pjesa më e madhe e tyre, ashtu si tërë krijimtaria e këtij artisti, kanë perfunduar në muzetë dhe Geleritë e Amerikës. Vepra të veçanta ruhen në Francë dhe në Angli. Tablotë që përmendëm më lart janë ekspozuar herë pas here në disa vende dhe janë riprodhuar në albume dhe revista arti.

"Gerome", New - York, 1881, "Histoire générale de l' art", Paris, 1950; "Les Orientalistes Voyageurs 1828-1908", Paris, 1985; "D.A. Rosenthal, "Orientalism" New - York, 1982.



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



MUZE, GALERI  
DHE  
KOLEKSIONE TË HUAJA  
QË RUAJNË VEPRA  
ME TEMË SHQIPTARE

MUZEU I LUVRIT. PARIS

Ëzhen Dëlakrua. *Një grua dhe një luftëtar shqiptar* (vizatim)

Ëzhen Dëlakrua. *Kalorës shqiptar* (akuarel)

Ëzhen Dëlakrua. *Luftëtar shqiptar* (akuarel)

Ëzhen Dëlakrua. *Burrë me kostum suliot* (grafikë)

Ëzhen Dëlakrua. *Etyd për Boçarin* (vizatim)

Aleksandër Deka. *Valltarë shqiptarë* (vizatin)

Zhan Mile. *Luftëtarë shqiptarë*

Ari Shefer. *Gratë suljote* (vaj)

Kamil Koro. *Haideja* (vaj)

Ëzhen Dëlakrua. *Dy etyde me kostum suljot* (vaj)

Ëzhen Dëlakrua. *Suljotë që vallëzojnë* (vaj)

Teodor Alinji. *Luftëtar shqiptar* (vizatim)

MUZEU PETI PALE. PARIS

Aleksandër Deka. *Fshatar shqiptar* (akuarel)

BIBLIOTEKA KOMBËTARE. PARIS

Ferdinand Bol. *Portreti i Pirros* (vaj)

INSTITUTI HOLANDEZ. PARIS

Ari Shefer. *Gratë suljote* (vizatim)

Ari Shefer. *Gjrua suljote duke u hedhur nga shkëmbi* (vizatime)

KOLEKSIONI ZHAK DYPO. PARIS

Ëzhen Dëlakrua. *Kampi i Marco Boçarit* (ngjyra vaji)

KOLEKSIONI MARSEL GERIN. PARIS

Ëzhen Dëlakrua. *Etyd shqiptar 1* (akuarel)

Ëzhen Dëlakrua. *Etyd shqiptar 2* (akuarel)



MUZEU I BRESTIT. FRANCË

Aleksanër Deka. *Valltarët shqiptarë* (ngjyra vaji)

KËSHTJELLA BORGAR. FRANCË

Anonim. *Portret i Skënderbeut* (ngjyra vaji)

MUSEI I ARTEVE. NANTE. FRANCË

Leon Zherom. *I burgosuri* (ngjyra vaji)

MUSEU I ORLEANIT. FRANCË

Robert Ogyst. *Grua nga Lindja* (pastel)

MUZEU KANTINI. MARSEJË. FRANCË

Dominik Mago. *Grua shqiptare* (akuarel)

AKADEMIA MBRETËRORE E ARTEVE. LONDËR

Eduard Lir. *Litografi dhe akuarele me pamje nga Shqipëria*

GALERIA KOMBËTARE E PORTRETEVE. LONDËR

Xheni Baret. *Florensa Najntingen në Shkodër* (vizatim)

Tomias Filips. *Bajroni me kostum shqiptar* (ngjyra vaji)

MUZEU BRITANIK. LONDËR

Uiliam Xhel. *Tri vizatime nga Shqipëria*

Çarl Kokrell. *Vizatime nga Shqipëria*

MUZEU BANKFIELD, HALIFAKS. ANGLI

Edit Durham. *Dhjetëra akuarele dhe vizatime me aspekte nga jeta shqiptare në fillimin e shekullit XX*

MUZEU VIKTORIA DHE ALBERT. LONDËR

H. Sandhem. *Shqipëria e parë nga Korfuzi*

INSTITUTI MBRETËROR ANTROPOLOGIK. LONDËR

Edit Durham. *Dhjetëra akuarele, skica dhe vizatime me aspekte nga jeta shqiptare në fillimin e shekullit XX*

GALERIA KOMBËTARE. LONDËR

Pajo Jovanović. *Këngë për Skënderbeun* (ngjyra vaji)

MUZEU KOMBËTAR I DEVEVE. GRENUIÇ. ANGLI

Uiliam Pokok. *Porti i Durrësit* (grafikë)

#### KOLEKSIONI XHON MURAJ. LONDËR

Tomas Filips. *Bajroni me kostum shqiptar* (ngjyra vaji)

#### KOLEKSIONE PRIVATE. LONDËR

Eduard Lir. *Shqiptarë pranë ujëvarës* (akuarel)

Eduard Lir. *Mali i Tomorit, Shqipëri* (vaj)

Eduard Lir. *Qafa e Tiranës, Shqipëri* (akuarel)

Eduard Lir. *Krua në Tepelenë* (akuarel)

Eduard Lir. *Butrinti* (akuarel)

Leon Zherom. *Shqiptar duke pirë duhan* (vaj)

#### MUSEU I BRUKLINIT. NJU – JORK

Kamil Koro. *Shqiptarja* (ngjyra vaji)

#### MUZEU I UNIVERSITETIT TË HAVARDIT. SHBA

Eduard Lir. *Rrugë për në Elbasan* (akuarel)

Eduard Lir. *Elbasan* (akuarel)

Eduard Lir. *Ura e Bahçallëkut* (akuarel)

Eduard Lir. *Berati* (akuarel)

Eduard Lir. *Kudhës, Tepelenë* (akuarel)

Eduard Lir. *Vlora* (akuarel)

#### MUSEU IZABEL KARTNER. BOSTON

Karlo Kriveli. *Gjergj Shqiptari* (ngjyra vaji)

#### MUSEU I INSTITUTIT LUEL. BOSTON

Sharl Gler. *Bujkeshë shqiptare* (akuarel)

#### KOLEKSION PRIVAT NJU – XHERSI. SHBA

Eduard Lir. *Male të pamatura akrokeraune, Bregdeti i Shqipërisë* (ngjyra vaji)

#### KOLEKSIONI VALASE. SHBA

Leon Zherom. *Shqiptarë që luajnë shah*

Aleksandër Deka. *Kapadan shqiptar*

#### KOLEKSION PRIVAT. NJU – JORK

Aleksandër Deka. *Luftëtar shqiptar* (ngjyra vaji)

#### GALERIA UFICI. FIRENCE

Kristofano del' Altissimo. *Portreti i Skënderbeut* (ngjyra vaji)

**PALLATI I DOZHERVE. VENEDIK**

Paolo Veroneze. *Rrethimi i Shkodrës* (afresk)

**GALERIA E ARTIT MODERN. ROMË**

G. Laliç. *Vajzë shqiptare*

G. Laliç. *Treg shqiptar*

Bartolomeo Pineli. *Arbëreshë me veshje popullore kombëtare*

**MUZEU CIVIKO, TREVIZO. ITALI**

Ludovik Liparini. *Bajroni me kostum shqiptar behohet mbi varrin e Marco Boçarit* (ngjyra vaji)

**KOLEKSION I KONTIT LUTZOV. ITALI**

Filipo Agrikola. *Vajzë shqiptare që i shpëton ndjekjes së një turku* (ngjyra vaji)

**MUZEU BENAKI. ATHINË**

Karl Hag. *Shqiptar duke vrapuar* (ngjyra vaji)

Xhozef Kartrait. *Luftëtar shqiptar* (litografi)

Xhozef Kartrait. *Grua shqiptare* (litografi)

Anonim. *Bajroni me kostum shqiptar pranë Athinës* (ngjyra vaji)

**PINAKOTEKA KOMBËTARE. ATHINË**

Ëzhen Dëlakrua. *Luftëtar suljot* (ngjyra vaji)

**KOLEKSION I NJE INSTITUCIONI ANGLEZ.  
ATHINË**

Tomas Filips. *Bajroni me kostum shqiptar* (ngjyra vaji)

**KOLEKSION PRIVAT. ATHINË**

Ëzhen Dëlakrua. *Dy luftëtarë shqiptarë* (akuarel)

**KËSHTJELLA VALBURG. GJERMANI**

Anonim. *Skënderbeu* (Portret në ngjyra vaji)

**KOLEKSIONI VESTE KOBURG. GJERMANI**

Domenik Kustos. *Skënderbeu 1602*

Domenic Kustos. *Skënderbeu*

**MUZEU I ARTIT. HUMBURG**

Anonim. *Portret i Skënderbeut*

**KOLEKSION PRIVAT, KARLSRUHE. GJERMANI**

Karl Blohm. *Rreth 100 akuarele dhe vizatime me portrete dhe peizazhe nga Shqipëria e Veriut*

**MUZEU TRATJAKOV. MOSKË**

M.I. Skoti. *Shqiptar në Venedik* (ngjyra vaji)

**MUZEU I ARTIT. VIENË**

Anonim. *Portret i Skënderbeut* (vaj)

Pajo Jovanoviç. *Vallja me jataganë* (vaj)

**MUZEU I USHTRISË. VIENË**

Ludvig Heshaimer. *Shqiptari* (grafikë)

**KËSHTJELLA BYTÇA. ÇEKOSLLOVAKI**

Anonim. *Afresk për Skënderbeun*

**GALERIA KOMBËTARE E ARTEVE. PRAGË**

Jaroslav Çermak. *Robinat* (ngjyra vaji)

**KOLEKSION PRIVAT. PRAGË**

O. Shilo. *Portrete dhe peizazhe* (ngjyra vaji)

**KOLEKSIONI OSKAR REINHART. ZVICËR**

Ëzhen Dëlakrua. *Episod nga lufta me turqit* (ngjyra vaji)

**GDANSK – POLONI**

Anonim. *Reliev për Skënderbeun*

**MUZEU POPULLOR. BEOGRAD**

Pajo Jovanoviç. *Lufta e gjelave* (ngjyra vaji)

**GALERIA E ARTEVE. BUKURESHT**

Peter Matesku. *Shkrimtarja dhe studiuesja Elena Gjika* (vaj)

**ARKIVI QENDROR. PRAGË –**

Stanislav Nojman. *Disa akuarele dhe pasteleva me pamje nga Elbasani në vitin 1918.*

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας

## PASQYRA E LENDES

1. Dy fjalë
2. Parathënie nga Ismail Kadare
3. Sicur shohim Shqipërinë
4. Bashkëautorë
5. Vepra të herëshme
6. Skënderbeu në muze dhe kështjella evropiane
7. Figura të tjera të shquara
8. Krenar si një shqiptar
9. Bajroni piktorët dhe Shqipëria
10. Kostume të mrekullueshme, ornamentike e pasur
11. Vend i mrekullueshëm për artistët
12. Ndërtime të bukura me individualitë të qartë
13. Jehona në botime të huaja
14. Në botime shqiptare
15. Riprodhimet
16. Autorë të nuaj dhe vepra me temë shqiptare
17. Muze, galeri dhe koleksione të huaja që ruajnë vepra me temë shqiptare
18. Indeks

Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας



Δημόσια Κεντρική Βιβλιοθήκη Κόνιτσας